

ETIKA

Revistë edukative-kulturore

Shqipëri: 150 Lek

Kosovë: 1 Euro

Maqedoni: 60 Den

Europa: 2 Euro

Gusht 2010 • Numri: 29 • E përmuajshme



Singeriteti
NË DHURIM

EDITORIAL

Njërën nga miqtë e Allahut, Ebu Abbas Nihavendin, e pati pyetur në lidhje me zekatin një prej nxënësve të tij që merrej me tregti. Ebu Abbas Nihavendi i qe përgjigjur:

“Jepja atij që të thotë zemra!”

Pasi largohet nga mësuesi i tij, nxënësi takon në rrugë një lypsar të verbër. Meqenëse i vjen keq për të, nxjerr nga xhepi një qese me florinj dhe ia jep si zekat. Lypësi i verbër, pasi e kontrollon mirë qesen dhe bindet se ajo është plot e përplot, largohet gjithë gëzim prej aty. Të nesërmen e asaj dite, nxënësi në fjalë kalon në të njëjtën rrugë dhe sheh se i verbëri i djeshëm, të cilit i kishte dhënë zekatin ishte duke folur me një shok të tij, i cili ishte gjithashtu i verbër. Nga biseda që po bënin dy shokët e verbër, atij i zuri veshi këto fjali:

“Dje, një njeri fisnik më dhuroi një qese plot me florinj. Dhe unë shkova në mejhane dhe piva për qejfin tim...”

Kjo gjë e mërziti shumë nxënësin. Ai shkoi menjëherë tek Hazreti Ebu Abbasi. Sapo arriti atje, ende pa filluar t’ia sqarojë mësuesit të vet meselenë, Hazreti Ebu Abbasi kërkoi prej tij që t’i dhuronte personit të parë që do të haste në rrugë një shumë parash, të cilën e kish fituar nga shitja e një qylafi.

Nxënësi largohet menjëherë për të kryer detyrën që i la mësuesi. Ashtu siç qe porositur, shumë e parave ia dhuroi njeriut të parë që takoi në rrugë. Më pas u bë kurioz dhe filloi ta ndjekë atë nga pas. Burri në fjalë hyri në një rrënojë aty afër. Nxori nga rrobat e tij një thellënzë të ngordhur dhe e la aty. Teksa ai po largohej prej aty, nxënësi i doli përpara dhe e pyeti:

- O njeri! Më thuaj çfarë po ndodh, pashë hatrin e Zo-

tit! Çfarë është kjo thellënzë e ngordhur që sapo hodhe këtu?

Kur shikoi parballë njeriun, që pak më parë i kishte dhuruar shumë e parave, burri tha me zërin që i dridhej nga emocionet:

- Tash shtatë ditë nuk kam mundur të siguroj kurrfarë ushqimi për fëmijët e mi. Unë dhe gruaja po e duronim urinë, por fëmijët nuk ishin në gjendje të duronin më!.. Megjithatë, s’më bëhej të dilja për të lypur. Duke u sjellë andej këndeje me gjithë këtë shqetësim, gjeta në rrugë këtë thellënzë të ngordhur. Në pamundësi për të siguruar ndonjë ushqim tjetër, mendova ta çoja në shtëpi këtë shpend të ngordhur prej ditësh. Ndërkohë, po i lutesha Allahut me gjithë shpirt: *“O Zoti im, më ndihmo të dal nga kjo gjendje kaq e vështirë!”*. Pastaj, para syve të mi u shfaqte ti. Unë e falenderova Zotin me të gjithë forcën e shpirtit dhe e flaka atë shpend të ngordhur që do të hanim me pahir. Tani do të shkoj në Pazar dhe do t’i blej familjes diçka për të ngrënë me atë shumë parash që më dhurove ti ...

Shumë i çuditur nga kjo situatë, nxënësi vrapoi drejt mësuesit të tij shpirtëror. Kur nxënësi arriti te Hazreti Ebu Abbasi, ky i fundit nuk i dha fare kohë të shpjegohej, por i tha:

“O biri im! Nga e gjithë kjo histori, unë po kuptoj se gjatë punës tënde ti nuk paske treguar kujdes të veçantë ndaj gjërave të dyshimta ose gjërave haram. Kështu që, edhe pse ti u përpoqe të zgjidhje të varfërin, zakati yt shkoi për konsum vere. Gjërat, ashtu siç fitohen, po ashtu edhe largohen nga dora jonë. Urtësia, e cila bëri të mundur që ajo shumë parash të arrinte te i varfëri i vërtetë, qëndron në faktin se ato para ishin krejt hallall...”

Do të lexoni:



Ahmet Tashgetiren / 4

30 ditë dietë

Jetmir Selmani / 8

Sadakaja urë lidhëse mes të pasurit dhe nevojtarit

Nexhat Ibrahim / 10

Universi i Kuranit

Intervistë me Sejid H. Nasr / 14

Besimi dhe dialogu ndërfaqetar: nevoja, pengesat, mundësitë

Hamdi Nuhiju / 18

Murabaha
një organizim biznesi

Dr. Durak Pasmaz / 22

Disa urtësi në ajetin e Infakut

Harun Jahja / 26

Rrëfenja e Salihut (a.s.)
në Kuran

Mr. Abdulkadër Durguti / 28

Ramazani muaji i Kuranit
dhe devotshmërisë

/30 Një ajet

/31 Një hadith

Ahmet Tashgetiren /

30 ditë dietë



4

Nexhat Ibrahim /

Universi i Kuranit



10

Mr. Abdulkadër Durguti /

Ramazani muaji i Kuranit dhe devotshmërisë



28

Viti: V | Numri: 29 | Gusht 2010

Administrator i Progresi botime:

Shuaqip Bashhan

bashan43@hotmail.com

+355 69 20 76768

Drejtor & Kryeredaktor:

Alban Kali

albankali@yahoo.com

+355 69 24 23989

Përkthyesit:

Alban Kali / Evans Drishti

Fatmir Hadri / Fatmir Sulaj / Ilir Hoxha

Redaktor letrar:

Shpëtim Kelmendi

Redaktor gjuhësor:

Ma. Irida Hoti

Dizajn - Grafik:

Bledar Xama

bledar_xama@hotmail.com

Për artikuj

e-mail: revistaetika@progresibotime.com

e-mail: kosova@progresibotime.com

e-mail: maqedoni@progresibotime.com

Adresa:

L: Vasil Shanto / Rr: Çajupi

Gusht 2010

32

Osman Nuri Topbash /
Sinqeriteti në dhurim



Osman Nuri Topbash / 32

Mr. sci. Flamur Sofiu / 40

Sinqeriteti në dhurim

Dispozitat e agjërimit
në shariat

Ali Riza Temel / 44

Disiplina trup-shpirt
në Ramazan

Sadik Dana / 46

Ai që përkëdhel kokën
e një jetimi

Mexhid Yveysi / 47

Mirë se na vjen
muaji i Ramazanit

Mr. Artur Tagani / 48

Bejtu-l Hikme

Mag. Ermal Nurja / 50

Poeti osman me origjinë të
vjetër shqiptare:
Jahja Bej Dukagjini (?-1582)

Familja / 52

Më dhemb shpirti nënë...

Teknologji / 54

USB-ja më rezistuese në botë.

Shëndeti / 56

Gratë kanë kujtesë më të fortë
se burrat.

44

Ali Riza Temel /
Disiplina trup-shpirt në Ramazan



56

Sadik Dana /
Ai që përkëdhel kokën e një jetimi



30 ditë dietë

Ahmet Tashketiren

Jabib-i Kulub (Doktori i zemrave) thotë:

- Nëse besoni me gjithë zemër, dhe jeni të bindur se ky besim do t'ju shpëtojë me të vërtetë, nëse bëni një jetë me këtë besim, atëherë ju do të përjetoni një pastrim të vërtetë.

Për këtë arsye, kushti i parë është të kultivosh vullnetin dhe të fillosh udhëtimin me një disiplinë shpirtërore, duke besuar, me besim, besim...

Kjo është përbërja 30 ditore e zemrës.

Gjithashtu, duhet të jesh optimist. Të besosh se në fund të fundit kjo punë do të realizohet. Nëse unë do të pajisem me një disiplinë shpirtërore, rrugët do të më hapen. Zoti im do të ma lehtësojë ecjen në këtë rrugë. Ky besim duhet mbajtur gjallë gjithmonë, sepse gjallëri e besimit do të thotë të mos shkëputesh nga kjo disiplinë shpirtërore.

Kjo do të realizohet duke bërë kombinimin e përma-

save tona, të paktën për 30 ditë. Duke kombinuar mes tyre trupin, shpirtin dhe pasurinë... Gjatë këtyre 30 ditëve, uria, etja dhe pehrizi seksual duhet të arrihen me vetëdijen e një njeriu të devotshëm.

Jeta jonë i përket Atij, pra mirësisë së Krijuesit. Shpirti është mirësia e Tij ndaj nesh. Shëndeti është mirësia e Tij. Ngrënia, pirja dhe rregulli i riprodhimit janë mirësitë e Tij. Të gjitha këto nevoja dhe dëshira Ai i ka vendosur brenda njeriut. Dhe Ai thotë:

- Për një muaj do t'i kufizosh e do t'i kontrollosh prirjet e tua të natyrshme ndaj këtyre nevojave dhe këtë do ta bësh thjesht "Për kënaqësinë Time".

Ndjenja e vetëdijes që Allahu dëshiron t'i japë njeriut është:

- Pa të shohim, a je i vetëdijshëm për gjithë këto të mira? A je i vetëdijshëm se nga vijnë gjithë këto të mira?

- Pa të shohim nëse je i vetëdijshëm për ata që kanë të njëjtat nevoja, por që nuk kanë mundësi t'i përmbushin?

Mirëpo, më parë eja në këtë rrugëtim me një teube (pendim) gjithëpërfshirëse, me një llogari të thellë të egos..., sepse në këtë rrugë mund të hyhet vetëm me të. Por për të bërë një teube gjithëpërfshirëse duhet bërë edhe një skaner i tërësishëm i qenies.

A të është rritur zemra?

A të ka zënë dhjamë mëlçia?

A ka ndonjë anomali në qenien tënde ?...

Sinonimi i këtyre pyetjeve në fushën e karakterit janë:

A të është nxirë zemra, ose sa të është nxirë?

Sa pika të zeza të gjynaheve kanë rënë mbi të?

A ka devijime në logjikë?

Si e shikon botën, krijimin, vdekjen, pasvdekjen?

A e ruajnë sytë e tu pastërtinë që u ka falur Zoti?

Në ç'rrugë ecin këmbët e tua?

Me ç'zëra janë mbushur veshët e tu?

Në gjuhën tënde a fshihet shija e hallallit apo shija e haremit?

Në duart e tua ka pastërti të abdesit, apo papastërti nga prekja e haremit?

Gjërat duhet të shihen dhe të ndahen deri në detajet më të imta..., sepse po t'i hap krahët ndaj një jete të re...

Për këtë arsye duhet t'i hedhësh një sy kritik dosjes tënde të jetës dhe të bësh përzgjedhje. Bëj një teube të pastër. Pra, një teube që përfshin çdo pjesë të zemrës, që të paralajmëron se “Kufijtë e Allahut nuk duhen shkelur kurrë!”, që gdhend në mendjen tënde gjykimin se “Në botën tjetër nuk shkohet me hakun e të tjerëve”. Bëj teube për të mos kryer më veprime që nuk përshtaten me karakterin e një besimtari. Kërkoji falje të gjithë atyre që u ke bërë padrejtësi. Betohu me vendosmëri të palëkundur se nuk do t'i nëpërkëmbësh më “Kufijtë e Allahut” dhe se nuk do të shkelësh kurrë më mbi të drejtën e askujt.

Këto 30 ditë fillohen me sabah dhe syfyr. Qëndrohet përpara Allahut në namaz nate dhe ripërtërihet betimi që kemi bërë “Bela – Po, ti je Zoti ynë”.

Tashmë, duke filluar që nga zemra, ka filluar një periudhë kujdesi.

Zemra duhet të jetë në çdo çast së bashku me Allahun.

Ky është kushti i pazëvendësueshëm i kësaj diete.



Syri do të shikojë me kujdes.

Gjuha do të flasë me kujdes.

Dëshirat e egos do të mund të vihen në jetë vetëm duke bashkëpunuar me disiplinën shpirtërore.

Profeti Muhamed – sallallahu alejhi ve sellem – në frymën e fundit, thirri: “**Kujdes namazin, namazin...!**”.


Për 30 ditë rresht do t'u përgjigjesh thirrjeve të 5 kohëve të namazit, “Hajje ales-salah - Eja në namaz”. Si mundet të gjejë shpëtimin apo të arrijë tek “Hajje alel felah-Eja në shpëtim” ai që nuk ia vë veshin këtyre fjalëve?

Vrapo 5 herë në ditë për në xhami, i mbushur me emocion dhe qetësi shpirtërore...

Diçka tjetër që duhet thënë është:

Gjatë këtyre 30 ditëve merru sa më pak që të jetë e mundur me punët e kësaj bote. Lehtësoje ngarkesën, në mënyrë që të mund të gjesh fuqinë shpirtërore dhe trupore.

Duhet të gjesh kohë për xhaminë dhe xhematin. Pa e ndjerë fare, xhamia dhe xhemati shkaktojnë një atmosferë shpirtërore që bashkon zemrat e besimtarëve, dhe me bashkimin e zemrave të besimtarëve krijohet një



energji madhështore.

Çdo ditë e këtyre 30 ditëve gjatë Ramazanit mbaron me namazin e terapive, si një veprim i veçantë i Profetit tonë, i Doktorit të zemrave. Në dietën e këtyre 30 ditëve, namazi i Teravive është si një terapi qetësuese që përjetohet çdo natë në atmosferën emocionuese që bashkon besimtarët.

Një gjë shumë e rëndësishme në këtë dietë:

Gjatë gjithë 30 ditëve, kur të mbyllësh sytë në mbrëmje, mendo për pluset dhe minuset e asaj dite. Bëj një llogari.

A ka ndonjë mangësi në teuben tënde?

Në ç'gjendje janë sytë, gjuha dhe zemra jote?

A po bën ti po atë jetë që ka dëshiruar dhe jetuar personalisht Doktorit të Zemrave, Profeti ynë i dashur?

Bëje këtë çdo natë dhe në mënyrë të përmbledhur çdo 10 – 15 ditë, pra bëje gjithmonë kur sheh se ka devijim nga dieta. Pastaj, kur të hysh në 10-ditëshin e fundit të këtij muaji të shenjtë, bëji llogaritë më thellë. Këto janë ditë në të cilat Doktorit të Zemrave ka dëshiruar që të jemi

më të ndjeshëm, sepse në njërën prej këtyre 10 ditëve Krijuesi ka fshehur një mëshirë të veçantë. Pa mendo pak: Ajo ditë-natë është njëmijë muaj mëshirë. Është sikurse të kishe bërë njëmijë herë një dietë të tillë. Vallë, ç' është ajo gjë? Ç'lloj zgjimi dhe ngjallje zemre është kjo që meriton një shpërblim të tillë? Kujdes! Sidomos natën e 27 kujdes...! Ajo natë le të jetë në pëllëmbën e zemrës tënde, në brendësinë e shpirtit tënd. Le të jetë në mënyrë të atillë, sa që kur Pronari i saj të shohë në të, të gjejë Vetveten dhe të lëshojë mëshirën e Tij në të...

Siç u tha në fillim...

Kjo dietë realizohet duke kombinuar veprimet që ushqejnë njëri-tjetrin.

Trupi, zemra, pasuria...

- Allahu i ka blerë shpirtrat e besimtarëve në këmbim të xhenetit.

Kjo do të thotë se nëse lind nevoja, besimtarët duhet të jenë të gatshëm që të japin pasurinë dhe shpirtin për Allahun.

A mund t'ia sigurosh Krijuesit tënd këtë gjë? A është në gjendje të të orientojë drejt këtyre sakrificave Lidhja jote shpirtërore me Allahun?

Pronari i zemrës tënde e di këtë...Patjetër që e di dhe dëshiron që zemra jote të jetë në një gjendje të këfillë. Dëshiron që ti, me shpirtin dhe pasurinë tënde të jesh në rrugën e Tij.

- Ti ekziston o Zoti im, çdo gjë është e Jotja... Madje edhe vetë unë jam i Yti. As unë, as fëmijët dhe as pasuria ime nuk mund të hyjnë midis nesh. Më ndihmo të vi tek Ti me një zemër që i është të dorëzuar plotësisht dashurisë Tënde.

Ja pra, gjatë këtyre 30 ditëve ndihmoje vetveten që të meritosh ndihmën e Allahut.

Pasi këto ditë ece mirë, u kujdese për syrin dhe zemrën tënde, e ruajte gjuhën nga fjalët e ndyra. Tashmë ka ardhur koha ta shkëputësh loçkën tënde të zemrës, thënë më ndryshe zemrën e zemrës dhe t'ia dhurosh Atij që e meriton.

Kjo nuk është e lehtë. Çdo copë që shkëputet nga zemra, të duket sikur shkëputet prej trupit tënd...

Mirëpo, asgjë nuk është e jotja. As trupi yt nuk është i yti. E po ashtu as loçka e zemrës, as pasuria jote nuk janë tuat...

Deri tani u përpoqe të vendosësh trupin tënd brenda zonës së lejuar, e cila është e përcaktuar nga Krijuesi. Ndërsa tani do të bësh të njëjtën gjë me “furnizimet materiale që të ka dhuruar Ai”, duke i harxhuar në rrugë të Tij. Kryesorja këtu është shkëputja jote shpirtërore nga pasuria dhe përpjekja për ta orientuar të gjithë qenien nga Krijuesi yt. Ai që të krijoi ty dhe të tjerët, Ai që të jep ose jo mundësi ty dhe të tjerëve, po të sprovon ty me **“Të dhënit për hir të Allahut”**, teksa dikë tjetër e sprovon me **“Me varfëri”**. Kush e di?

A është më e vështirë të shkosh tek Allahu me pasuri apo varfëri?

Të japësh nga ajo që ke është stërvitje shpirtërore... Me dietë ose disiplinë shpirtërore, ne mund t’ia arrijmë edhe kësaj.

Zekati dhe sadakaja (lëmosha)...

Ah sikur çdo ditë të mund të jepnim sadaka...

Ah sikur përgjatë 30 ditëve të mund t’ia ndriçonim zemrën një të varfëri, qoftë edhe me diçka të vogël...për çdo ditë...

Kush e di se sa ndriçohet edhe zemra jonë !


Nëse brenda 10-20 ditëve arrijmë të fitojmë diçka në planin shpirtëror, kjo do të thotë se tashmë jemi gati të ndajmë me drejtësi në pasurinë tonë pjesën për të varfrit.

Hidhi një shikim pasurisë tënde dhe bëj një llogari, duke e ndjerë se Krijuesi po të shikon. Qëndro i qetë dhe mos të të shkojë mendja të gabosh në këtë llogari. Mos harro bujarinë e Dhënit. Mos harro se gjithçka të është dhënë si Risk (furnizim nga Allahu). Në këto ditë Doktor i Zemrave bëhej po aq bujar sa era që fryn. Merr shembull prej tij. Kujtoje atë. Mundohu të bëhesh si ai. Le të jenë këto 30 ditë më të veçantat e jetës tënde. Nëse nuk është ky Ramazan, cili Ramazan do të jetë? Ndaje pjesën e të varfrit prej pasurisë tënde dhe jepe atë me dëshirë.

Ah sikur t’i fusësh ato në zarfe të bukura... të trokasësh në derën e të varfërve dhe të hysh në zemrën e tyre me buzëqeshjen e shpirtit tënd ... Ah sikur të marrësh lutjet e tyre dhe t’ua kthesh me të njëjtat lutje. Ah sikur të ndjesh gjallërimin e çdo qelize të zemrës çdo herë që troket në ndonjë derë.

A u mbushën 30 ditë?

A qarkullon brenda nesh ndonjë ndjenjë përparimi drejt dyerve të xhenetit?



A e meritojmë ne Bajramin?

A gjallon në zemrat tona gëzimi se po takohemi me xhenetin?

Bekuar qoftë. Erdhët me begatinë e muajit Rexheb dhe Shaban, me mirësinë e Zotit arritët Ramazanin, për 30 ditë iu përshtatët një diete karakteri (personaliteti) dhe e rigjallëruat zemrën në dritën hyjnore.

Dhe tani është Bajram.

Një gëzim i madh na ka pushtuar. Erdhëm në këtë gëzim duke përfituar një disiplinë të re jetësore. Prandaj, këtej e tutje duhet të kemi kujdes nga ndotja e zemrave, nga çorientimi i logjikës dhe i mendjes, duke bërë kujdes që të gjitha aftësitë e dhuruara nga Allahu t’i përdorim për të bërë një jetë brenda kufijve të caktuar nga Allahu.

Tani është Bajram.

Gëzuar! Allahu na bashkoftë në atmosferën e Bajramit të xhenetit të Tij.

Amin!



Sadakaja

urë lidhëse

mes të pasurit dhe nevojtarit

Jetmir Selmani

Sلامي, përveçse ka vendosur rregulla për mirëmbajtjen e trupit dhe shpirtit, ka vendosur po ashtu rregulla edhe për mirëmbajtjen e shoqërisë.

Një ndër rregullat që luan rol të rëndësishëm në ruajtjen, ngritjen, zhvillimin, harmoninë dhe afërsinë ndërmjet pjesëtarëve të shoqërisë është edhe zekati apo sadakaja.

Njerëzit janë shumë të dhënë pas pasurisë së kësaj bote. Edhe po të jetë aq i pasur sa të ketë në dorë të gjitha pasuritë e botës, njeriu përsëri ka frikë se mos i harxhohen nëse e ndan një pjesë të asaj pasurie për nevojtarët. Ekziston mundësia që në përpjekjet për të arritur deri tek kamja, njeriut t'i shndërrohet në pasion dëshira e tepruar për pasuri. Kjo gjendje e shndërron njeriun deri në atë pikë, sa e bën të mos njohë askënd përreth tij dhe të mos vlerësojë asgjë tjetër përveç materiales. Disa njerëz bien në adhurim të pronës, të mallit apo të pasurisë dhe mendojnë se kamja që zotërojnë është e pafund, e përhershme. Ndërkohë, zekati apo sadakaja e shmang pasionin e pasurisë e robërinë që ajo shkakton, duke e orientuar njeriun drejt një adhurimi, që e afron jo vetëm me Allahun (xh.sh.), por edhe me njerëzit.

Shumë njerëz nuk japin sadaka ngaqë kanë frikë se mos u pakësohet pasuria, por në Kuranin Fisnik, Zoti i madhëruar na siguron se pasuria jo vetëm që nuk pakësohet, por madje shtohet edhe më tepër. Në Kuranin Famëlartë, Allahu thotë: ***“Djalli ju frikëson me skamje e varfëri dhe ju urdhëron të bëni vepra të pamoralshme, kurse Allahu ju premtan faljen dhe mirësinë e Tij.”*** (el-Bekare; 268)

“Kush do t'i japë Allahut një hua të bukur, që Ai t'ia kthejë shpërblimin shumëfish? Allahu e shtrëngon (riskun) dhe e liron; tek Ai do të ktheheni.” (el-Bekare; 245). Në këtë ajet, Zoti nuk thotë “jepni pasuri”, por thotë “i jepni Zotit hua”, me qëllim që njeriu të sigurohet se mallin që po jep, përpara se t'ia japë nevojtarit ia ka dhënë Zotit, i Cili do t'ia kthejë më pas të shumëfishuar. Në lidhje me këtë, Pejgamberi (s.a.v.s.) ka thënë: ***“Dhënia nuk e pakëson pasurinë”***. Po ashtu, ndodhi një herë që Aisheja (r.a.), para se të jepte sadaka, mori monedhën dhe e parfumosi. Kur e pyetën se përse veproi ashtu, ajo tha: ***“E bëj këtë, sepse kjo monedhë do të bjerë në dorë të Zotit para se të ketë rënë në dorë të nevojtarit.”***

Kush jep pasuri në rrugë të Zotit, Ai do t'ia kthejë atë pasuri deri në 700 fish e më tepër.

“Ata që shpenzojnë pasurinë e vet në rrugë të Allahut, i shëmbëllojnë atij që mbjell një kokërr nga e cila dalin shtatë kallinj, ku secili kalli ka nga njëqind kokrra. Allahu ia shton (shpërblimin) edhe më tepër kujt të dëshirojë; Allahu është Mirëbërës i madh dhe i Gjithëdijshëm.” (el-Bekare; 261)

Në një farë mënyre, zekati është urë lidhëse mes myslimanëve. Ai që ndihmon nevojtarët në një shoqëri, ka krijuar në të njëjtën kohë edhe lidhje të ngrohta me ta. Po ashtu, nëse u vjen në ndihmë edhe atyre që janë kapluar nga probleme të ndryshme, ai ka arritur të fitojë zemrat e tyre. Në lidhje me këtë po përmendim rastin e Safvan bin Umeje, i cili thotë: *“Muhamedin e urreja aq shumë, sa që nuk urreja tjetërkënd më shumë se atë, por ai vazhdonte të më jepte derisa fillova ta dua.”* Pra, le ta mësojmë edhe ne këtë mënyrë sjellje të Pejgamberit (a.s.) për t'i fituar njerëzit: nëse dikush të urren, jepi atij derisa ai të fillojë të të dojë. I Dërguari i Allahut thotë: *Bëjini dhurata njëri-tjetrit, që të mund t'ju shtohet dashuria.*

Sadakaja është një ndër treguesit më të qartë të ndarjes në Islam. Ai që jep sadakanë, në një farë mënyre ka dëshmuar ekzistencën e Allahut, si dhe ka forcuar lidhjet sociale. Sadakaja nuk është vetëm një adhurim i lidhur me pasurinë, por ekzistenca e saj përfshin çdo individ të shoqërisë e po ashtu është edhe pretekst i ekzistencës së jetës sociale. Ashtu si kujdesja për familjen, sadaka konsiderohet edhe ndihma që u ofrohet kafshëve e shpezëve. Po ashtu, sadaka konsiderohet edhe buzëqeshja drejtuar vëllezërve në fe.

MYSLIMANI NUK ËSHTË NJË INDIVID QË JETON VETËM PËR VETEN E TIJ...

Myslimani nuk është një individ që jeton vetëm për veten e tij, por një rob i Zotit që jeton për shoqërinë, aq sa ndan me ta si dhimbjet ashtu edhe gëzimet.

S'duhet harruar se dhënia e zekatit-sadakaja ka dobi të shumta, mes të cilave mund të rendisim ato ekonomike, politike e madje edhe edukative. Një gjë e tillë ndikon shumë në formimin, edukimin, karakterin, psikologjinë dhe në mënyrën e të menduarit. Një njeri i mirë tregon: *“Sa herë që shihja të varfër, më vinte në mendje babai me zarfet në dorë, duke shkruar emrat e nevojtarëve. Ditën e parë të Ramazanit ai hynte në shtëpi me zarfet, me regjistrin dhe të hollat në dorë. Të gjithë ne e ndihmonim në shkruarjen e emrave dhe në ndarjen e të hollave për çdo nevojtar.”*

Prof. Xhasim El-Mutava tregon: Një ditë, një grua nga Kuvajti më tregoi diçka të çuditshme. Ajo më tha: *“Kur isha e vogël, shtëpia jonë ishte prej qerpiçi. Unë dilja në oborr dhe*

luaja gjithë ditën. Një ditë, gjyshi hyri në oborr me një qese të mbushur në dorë dhe filloi të kërcente i gëzuar e i lumturuar. Unë mendova se mos ndoshta atë ditë mund të kishte fituar shumë para në tregtinë e tij, ose i kishte ardhur ndonjë lajm i gëzuar. Kur e pyeta në lidhje me shkakun e gëzimit, ai më tha: Sot është dita e parë në jetën time që m'u mundësua të jap zekatin e pasurisë!”

Kur Xhafer bin ebi Talibi vdiq, la pas tre vajza. I Dërguari (a.s.) i mori në krahë vajzat e tij dhe iu drejtua të pranishmëve: *“Kush do t'i përkrahë vajzat e Xhaferit?”. Pamë tre vetë që u ngritën menjëherë dhe thanë: unë, o i dërguari i Allahut, unë o i dërguari i Allahut. Të tre ishin njëri më i varfër se tjetri... kurse në ditët e sotme, na vdes vëllai prej nëne a prej babai dhe nuk duam t'ia dimë për fëmijët e tij. Mundet që fëmijët e tij të dalin e të lypin në rrugë, ndërsa ne na interesojnë vetëm fëmijët tanë. Pra, qoftë fshehtas apo haptas, sadakaja duhet të jepet. Gjëja e mirë e sadakasë së dhënë haptas është se në këtë mënyrë i nxit edhe njerëzit e tjerë për të ndihmuar nevojtarët. Kurse sadakaja e dhënë fshehtas është më e dashur te Zoti i Madhëruar, sepse sikundër thuhet edhe në një hadith *“Shtatë lloj njerëzish do të qëndrojnë nën hijen e Zotit, ditën kur nuk do të ketë hije tjetër përveç hijes së Tij... dhe një njeri, i cili jep sadaka ashtu që dora e majtë nuk e di se çfarë dha e djathta.”**

Duhet pasur parasysh se në qoftë se ti nuk do që të japësh, Zoti i Madhëruar do të ta marrë në një mënyrë tjetër. Të ndodh diçka për të cilën do të të duhet të shpenzosh më shumë nga sa do të mund të kishe dhënë me dëshirën tënde, ose të bëhet fëmija haram dhe t'i harxhon paratë në bixhoz apo në vende të ndyta! Po ashtu, në një hadith tjetër, Pejgamberi (a.s.) thotë: *“Sikur të kisha florinj sa kodra e Uhudit, do t'i kisha shpërndarë pa kaluar as tri ditë”, ndërsa ne, edhe pse mund t'i kemi garderobat të mbushura me rroba që nuk i përdorim, nuk na shkon ndërmend t'ua japim nevojtarëve!*

Në përfundim, një përkujtim për ata që vuajnë nga moshënia e sadakasë për arsye të ndryshme... Pejgamberi (a.s.) thotë: *“Në agim të çdo dite zbresin dy melekë, njëri prej të cilëve thotë: ‘O Zot, shtoja pasurinë atij që jep’, ndërsa tjetri thotë: ‘O Zot, shkatërroja pasurinë atij që nuk jep’.”*

Zoti na ruajtë nga çdo e keqe e mundshme! Na bëftë njerëz, që kanë mundësi të japin, na bëftë prej atyre që e kanë dorën vazhdimisht të shtrirë...

S'ka dyshim që sistemi i zekatit-sadakasë është një mrekulli sociale më vete. Nëse do ta zbatonim këtë sistem në shoqëritë tona ashtu siç kërkon dhe porositi vetë Zoti i Madhëruar, atëherë në asnjë shoqëri nuk do të qe e nevojshme të luftohej varfëria, vjedhja e anomali të tjera si këto, sepse gjithçka do të ishte e rregulluar më së miri dhe në harmoni.

Universi i Kur'anit



Nexhat Ibrahimi

PËRSIATJE HYRËSE

Kurani zë vendin qendror në islam. Ai është ligjërim i amshueshëm dhe Fjalë e amshueshme që iu shpall Pejgamberit Muhamed (a.s.), të cilin e zgjodhi për këtë detyrë vetë Allahu i madhërishtëm.

Kurani është shpallja e fundit e Zotit për njerëzimin, testamenti i fundit i Allahut për njeriun. Ai paralajmëron se rrugetimi njerëzor në Tokë dhe në këtë gjithësi nuk është i kotë, se veprat njerëzore nuk janë pa përgjegjësi e pa një synim më të lartë.

Edhe pse njeriu është dëbuar nga xheneti, ai nuk është braktisur nga udhëzimi i Providencës hyjnore. Nga Amshueshmëria e Tij - Leuhi Mahfudh, Allahu i lartësuar ia zbret njeriut Fjalën e Tij përmes felajmëruesve, siç ndodhi me suhufet, Tevratin, Zeburin, Inxhilin dhe Kurantin. Ky komunikim i vazhdueshëm ndodhi për shkak se njerëzimi fliste gjuhë të ndryshme, por edhe për shkak të zhvillimit e të pjekjes graduale të tij.

Islami na mëson se Kurani i njuh dhe i pranon të gjitha shpalljet pararendëse në formën e tyre origjinore, pa ndërhyrjen e historisë. Kurani është e gjithë shpallja, që nga fillimi e deri në fund, kurse Muhamedi (a.s.) është i gjithë cikli

pejgamberik, nga Ademi e deri te Isai (a.s.).

Kurani filloi të shpallet në muajin ramazan të vitit 610. Kjo shpallje e ardhur nga Zoti te Pejgamberi nëpërmjet melekut Xhibril, është objekt i krijimeve më të bukura si në shkencën e tefsirit ashtu edhe në gjinitë e tjera shkencore e letrare. Në përfundim të shpalljes filloi faza tjetër, ajo horizontale, pra futja e Kuranit nga amshueshmëria në kohë, në gjuhën arabe, në tokën arabe, destinuar për njerëzit e të gjitha gjuhëve, të të gjitha ngjyrave, të të gjitha diversiteteve. Shkronja e tij, fjala e tij, fenomeni i librit, i lapsit, i letrës, u prit me kujdesin dhe respektin më të lartë të mundshëm, madje u shndërrua në kult. Për këtë arsye, edhe sot e kësaj dite myslimani nuk e dëmton letrën, por e ruan atë dhe e ngre në lartësitë më të mëdha, për shkak se në të shkruhet edhe Fjala e Allahut... Në anën tjetër, Kurani ka bërë që nga faqet e tij të burojnë entuziazmi më i madh i mundshëm në histori. Aty janë faqet më të mira të kodekseve jetësore dhe të mirësjelljes, të kulturës së banimit dhe të veshmbathjes, të kuzhinës dhe pikëpamjeve të tjera jetësore. Shtëpitë e drejtuara nga dielli, minaret që futen thellë në qiell, shatërvanët dhe krojet si shenja xheneti, xhamitë dhe hamamet si manifestim i pastërtisë shpirtërore dhe fizike, bibliotekat dhe medresetë si mjete meditimi e mësimi, të gjitha këto janë manifestim i thesarit që myslima-

nët dhe bota i kanë para vetes, me ose pa vetëdije.

KURANI ËSHTË KOZMOS QË FLET, KOZMOSI ËSHTË KURAN QË HESHT! (IBN ARABIU)

Lexuesi i Kuranit që takohet me këtë libër, qoftë në origjinal ose në përkthim, sidomos lexuesi i papërgatitur për leximin e Kuranit, nuk do të ndihet mirë. Nga librat e tjerë ai është mësuar ta shohë fillimin, përpunimin dhe përfundimin logjik të temës, por këtë mënyrë nuk do ta gjejë në Kuran. Përse? Sepse, Kurani me pazakonshmërinë e tij u ngjan viseve të egra në natyrë, të cilat nuk janë të tematizuara, të sistematizuara; natyra e egër nuk është prekur dhe mbikëqyrur nga njeriu, në dallim nga vendet e gjelbëruara në jetën e njeriut. Në Kuran do të gjejmë shenja të shumta kozmike, të cilat i janë drejtuar qëllimisht veshit të njeriut, sikurse edhe shenjat kozmike që i janë drejtuar qëllimisht syrit të njeriut. Syri i atij njeriu që sheh rend e unitet në kozmos, do të gjejë rend e unitet edhe në Kuran.

Kurani përmend çdo gjë; në të ekziston çdo gjë. Por, si të zbulohen tërë ato thesare, si të shpjegohen tërë ato mistere, si të bëhen të dukshme tërë ato vlera!? Këtë detyrë të vështirë e kanë marrë mbi vete komentuesit e Kuranit. Prej shekujsh të tërë ata gjurmojnë, meditojnë, analizojnë dhe, mund të themi se, pak a shumë, e kanë kryer me sukses detyrën e tyre; nga mushkonja e milingona deri te njeriu, toka dhe qiejt në horizont. Kurani i përmend gjërat që shihen, por edhe ato që nuk shihen apo që s'do mund të shihen ndonjëherë (*Pasha ato që ju, krijesat, i shihni dhe ato që nuk i shihni*). Kurani pyet! Pyetjet e tij sfidojnë. Sfidat e tij nxisin, si lexuesin (syrin) ashtu edhe dëgjuesin (veshin).

Ja disa shembuj të mrekullueshëm:

“A e keni parë farën që e hidhni? A jeni ju që e krijoni atë apo jemi Ne krijuesit e saj? Ne e caktojmë vdekjen tuaj dhe askush nuk mund të na pengojë që t’ju ndryshojmë trajtën dhe t’ju rikrijojmë ashtu si nuk e dini (në Ditën e Ringjalljes). Sigurisht, ju e dini krijimin e parë (prej një pike fare), atëherë përse nuk mendoni?! A shihni atë që mbillni? Vallë, ju e bëni atë që të mbijë apo jemi Ne rritësit e saj? Nëse duam, Ne e lëmë fyçkë dhe ju do të çuditeni (e do të thoni): “Ne jemi të dëmtuar, madje jemi krejt të privuar (nga furnizimi)! A e shihni ujin që pini? Vallë, ju e zbrisni atë prej reve apo Ne e zbresim? Nëse duam, Ne e bëjmë atë të njelmët, andaj përse nuk jeni mirënjohës?! A e shihni zjarrin që e ndizni? Vallë, ju i keni bërë drutë për të apo Ne i kemi bërë?! Ne e kemi bërë atë përkujtues (të zjarrit të Xhehenemit) dhe, që t’u sjellë dobi nevojtarëve, prandaj lavdëroje emrin e Zotit tënd të Madhërishëm! Beto hem në çastin e perëndimit të yjeve, e ky është betim i madh, veç sikur ta dinit.” (El-Vakiah, 58-76).

Ky është Kurani, natyra në fjalë! Këtë mund ta kuptojë

vetëm ai që ka një njohje sa i takon unikalitetit të universit ose të kozmosit, sepse pikërisht kur ne mendojmë se e arritëm përgjigjen përfundimtare, që ajo, pra përgjigja na zbulohet pas perdes qiellore, Kurani na e kthen vëmendjen te njeriu dhe te eshtrat e tij të kalbura: ***“Vallë, pasi të vdesim e të bëhemi pluhur?”***. (Kaf, 3) Kjo na përkujton detyrën tonë njerëzore, që në çdo gjë ta shohim praninë e Zotit, shenjën e Zotit, gjurmët e Zotit dhe afërsinë e Zotit. Së këndejmi, është e domosdoshme që Kuranit t’i qasemi hapur dhe me synime të pastra, siç thotë babai i Muhamed Ikbali: ***“Sikur të na shpallet vetë neve”***.

NJERIU NË EPIQENDËR

Ndonëse edhe qiejt, edhe Toka, edhe bimët e kafshët janë të përshkuara nga mëshira e Allahut, njeriu, pikëpamja antropologjike dhe etike e tij mbetet pika qendrore e Kuranit. Të gjithë privilegjoohen me shpallje të drejtpërdrejtë, por vetëm njeriu është pranues i shpalljes së Allahut në formë fjale, flete apo libri. Ai është qenie e botës, qenie e alternativës, e lirisë, por edhe zëvendës (halif) i Allahut në Tokë. Për t’iu shmanhur rrëmujës, dhunës e mungesës së rendit, njeriu në aleancë (mithak) me Krijuesin kryen misionin e tij fisnik të ndërtuesit, të vlerave, të halifit, të të diturit (*ue al-leme Adem’el-esmae kul-leha...*). Njeriu nuk e zotëron gëzofin për ngrohje, por arrin ta thurë atë nga bota bimore e shtazore. Njeriu nuk ka kthetra e nuk ka dhëmbë shqyes, por këtë mangësi e kompenson me dije; vetëm njeriu udhëton larg, punon tokën, i shkruan ngjarjet e tij, ka varreza, krijon art, ka histori... Njeriu di për kohën, njeriu di ta njehsojë kohën, ditët, vitet dhe shekujt. Vetëm ai di ta llogarisë kohën, vetëm ai di edhe të besojë në amshueshmëri e të besojë në Zot. Kjo është arsyeja pse pati të dërguar (*rusul - enbija*) vetëm nga njerëzit, e jo edhe nga krijesat e tjera. Kjo na shtyn të besojmë se veprimet njerëzore përcillen nga “Lart” dhe për to jepet llogari, sepse veprat njerëzore nuk kanë si synim përfundimtar këtë botë, por botën tjetër. Kjo botë (*ed-dunja*) dhe ajo botë (*el-ahiret*) përbëjnë një tërësi që njeriu e mëson në dy etapa. Meqenëse njeriu është qenie harruese, Kurani është këtu që t’ia kujtojë detyrimet e tij ndaj Zotit, por edhe ndaj të tjerëve: njerëzve, shtazëve, bimëve, botëve të njohura dhe të panjohura.

LEXIMI I SHENJAVE (AJETEVE) NË GJITHËSI

Mbreti mesopotam ndërtoi një labirint madhështor. Pastaj ftoi mbretin beduin me qëllim që t’ia bënte të ditur aftësinë dhe fuqinë e tij. E futi në labirint dhe, pas shumë bredhesh e kërkimesh, beduini doli nga ai vend. Në shenjë dominimi dhe krenarie, ai e pyeti mbretin beduin nëse kishte ndonjë gjë në mbretërinë e tij që mund t’ia kalonte këtij labirinti. Beduini i tha se kishte dhe e ftoi ta vizitonte atë në shkretëtirë. Kështu, pas një kohe, mbreti mesopotam ia ktheu vizitën mbretit beduin. Pas pritjes dinjitoze që i bëri, beduini



“A e keni parë farën që e hidhni? A jeni ju që e krijoni atë apo jemi Ne krijuesit e saj? Ne e caktojmë vdekjen tuaj dhe askush nuk mund të na pengojë që t’ju ndryshojmë trajtën dhe t’ju rikrijojmë ashtu si nuk e dini (në Ditën e Ringjalljes). Sigurisht, ju e dini krijimin e parë (prej një pike fare), atëherë përse nuk mendoni?! A shihni atë që mbillni? Vallë, ju e bëni atë që të mbijë apo jemi Ne rritësit e saj? Nëse duam, Ne e lëmë fyçkë dhe ju do të çuditëni (e do të thoni): “Ne jemi të dëmtuar, madje jemi krejt të privuar (nga furnizmi)! A e shihni ujin që pini? Vallë, ju e zbrisni atë prej reve apo Ne e zbresim? Nëse duam, Ne e bëjmë atë të njelmët, andaj përse nuk jeni mirënjohës?! A e shihni zjarrin që e ndizni? Vallë, ju i keni bërë drutë për të apo Ne i kemi bërë?! Ne e kemi bërë atë përkujtues (të zjarrit të Xhehenemit) dhe, që t’u sjellë dobi nevojtarëve, prandaj lavdëroje emrin e Zotit tënd të Madhërishëm! Beto hem në çastin e perëndimit të yjeve, e ky është betim i madh, veç sikur ta dinit.”

(El-Vakiah, 58-76).

e shpuri mbretin mesopotamik në shkretëtirë dhe i tha: “Ja labirinti im!” “Gjeje rrugën nga ky vend dhe më thuaj se a ka ndonjë çudi mbi çudinë e Zotit!”

Por, në shkretëtirë çdo gjurmë fshihet shpejt nga era që fryn. Njeriu xhiron kudo që niset, kurse mbi të qëndron **horizonti**, **pafundësia**, që nuk është vepër e njeriut. Në këtë labirint të pafund njeriu kërkon udhërrëfyes, të cilin do ta gjejë në qiellin e yjzuar që ndodhet përmbi ne. Leximi i vendndodhjeve të trupave qiellorë do ta nxjerrë njeriun nga

pafundësia shkretinore, kurse njeriu do të tregohet si qenie e **orientimit** dhe gjurmues i **lindjes** (*east*) së kuptimit.

Sipas Kuranit, janë dy lloj Fjalësh të shpallura të Zotit:

- **Fjala e Zotit** në një prej librave të mëdha (fletët, Tevrati, Zeburi, Inxhili dhe Kurani)

dhe

- **Bota** si Fjalë e Zotit.

Edhe fjalitë në Kuran, edhe vetë natyra (fenomenet natyrore) në Kuran, quhen **shenja** (*ajete*) dhe paraqesin çudi të jashtëzakonshme. Para tyre mbeten të nemitura e të habitura edhe mendjet më të mëdha. Janë shkruar shumë komente dhe shpjegime, por as librat e deritanishëm nuk kanë arritur ta shpjegojnë tërësisht, dhe as librat e ardhshëm nuk do ta shpjegojnë atë deri në fund. Prandaj janë themeluar shumë shkenca mbi kozmosin. Por, as fizikat e deritanishme nuk e kanë shpjeguar kozmosin dhe as fizikat e ardhshme nuk do ta shterrojnë dijen mbi kozmosin. Nuk duhet harruar se mjetet për studimin e ajeteve janë sipas (syrit të) njeriut dhe jo sipas syrit të shpendëve, ndaj edhe rezultatet janë njerëzore e jo shpendore apo diçka tjetër. Sado që të shkruhen komente në lidhje me shenjat e Zotit, ato janë vetëm drita të thyera nëpër kristalet e shpirtit të njeriut.

Njeriu, si shpjegues i botës së Kuranit

Çdo gjë që njeriu ndërtoi, shkroi apo këndoi, është vetëm shpjegim i tij për botën. Këtë e shpjegon edhe mënyra e veshmbathjes së njeriut, e ndërtimitarisë, e kulinarisë etj. Madje, edhe pozicioni i njeriut është pozicion i komentimit (komentuesit?) të botës. Nëse njeriu nuk është në gjendje të bëjë diçka tjetër, ai ka mundësi ta komentojë botën e Kuranit dhe këtë e ka arritur, duke e bërë Kuranin, librin më të komentuar, por njëkohësisht edhe më të pakomentuar në botë. Përse është kjo gjendje? Sipas mendimit të një komentuesi (Ibn Arabiu), ne jo vetëm që nuk e njohim botën në tërësi, por as nuk e shohim në tërësi. Kjo gjendje është për arsye se vetëdija jonë zhytet çdo ditë *në gjumë*, kurse sytë zhyten çdo çast *në terr*! Për këtë shkak njeriu hamendëson, komenton.

Kurani e përshkruan veten me fjalën *dritë*. Në anën tjetër, njeriu nuk e shikon vetë dritën, por të ndriçuarën. Vetë drita është si xhevahiret në fund të detit. Për të depërtuar në thellësi të ujit e për t’i nxjerrë ato, duhen njohuri. Për ta shikuar vetë dritën, domethënë vetë thesaret e Kuranit, lexuesi duhet ta njohë artin e eksplorimit të tij, sepse nuk duhet harruar se Kurani është një det i thellë pa brigje, i cili i josh dhe fton të guximshmit, të diturit, më të mirët. Ky është Kurani, i cili na mëson që në mënyrë korrekte t’i lexojmë pulset e universit, si të syrit të vogël të njeriut, ashtu edhe të yllit të largët në horizontin e pafund.

KORNIZAT E NJERIUT, SI FISNIKËRIM

Edhe pse lexojmë se Kurani është burim ligjvënës, burim i kriterëve juridike dhe morale, prapëseprapë në Kuran janë të pakta tekstet me karakter të këtillë. Megjithatë, kjo nuk e liron njeriun në atë masë sa të bëhet i pavarur në veprimet e tij. Ai ka shumë kufizime, si të gjinisë, racës, gjuhës, kufizime kohore, kufizime për shkak të sëmundjes, vdekjes etj. Gjithsesi, këto kufizime nuk e pengojnë atë që të bëhet përfaqësues i Zotit në Tokë dhe zbatues i ligjit të Zotit, nuk e pengojnë për të qenë faktor në zbulimin e rrugëve më të frytshme për aplikimin dhe zbatimin e ligjeve të Zotit. Nga ana tjetër, në rrafshin historik mysliman, komentimet normative, juridike, zënë vend me rëndësi. Atje **çdo gjë** shpjegohet. Madje aty trajtohen hollësisht edhe mënyra e ngrënies dhe e pirjes, mënyra e prerjes së mustaqeve, gjatësia e tyre, rregullat martesore etj. Prandaj është i qëndrueshëm pohimi se pretendimi i këtyre komenteve është që ta kundrojnë jetën në *tërësi* dhe *tërësisht*, gjë e cila është në përputhje me kërkesat islame, që në një vend apo shoqëri të manifestohet Fuqia e Zotit në mënyrë të kufizuar. Përkundrazi, jeta e njeriut është mbirje, gjallëri, të cilën dispozitat kuranore përpiqen ta kultivojnë, e jo ta ngatërrojnë e ta kufizojnë.

ZOTI ËSHTË NJË I VETMI

Në komentimet e shumta të Kuranit, që na nxjerr përpara historia, gjejmë punë të vyeshme njerëzore. Çdo gjë është studiuar, por më shumë spikat forma më e pastër e mono-teizmit, **besimi në Një, të Vetmin Zot**; i pranuar me zemër dhe i komentuar me mendje. Edhe Kurani, nga ana e tij, me përkushtim dhe me devotshmëri, ka dëshiruar të zgjojë brenda nesh mendimin zanafillor mbi Zotin, mbi besimin në Zotin, mbi vetëdijen tonë për Zotin. Ky besim u bë botëror, global dhe në çdo sekondë përgjatë 24 orëve dëshmohej se Ai është Një, i Vetmi. Ai nuk ndryshohet, siç mund të ndryshohen shkollat besimtare e juridike ose sistemet politike.

Po ashtu, duke lexuar Kuranin, lexojmë se njeriu është **abd**, rob i Zotit. Ky përcaktim i njeriut në Kuran: të jesh me vetëdije rob i Zotit do të thotë të jesh qenia më e lirë ndër të gjitha krijesat, sepse, të jesh **rob** vetëm i Zotit, të Pavarur dhe të Gjithëmundshëm, i Cili nuk ka nevojë për asgjë, do të thotë të jesh mirëfilli **i lirë**.

KURANI DHE KOMENTIMET E TIJ, HISTORIA MË BESNIKE MYSLIMANE

Kurani, gjatë historisë së tij 14-shekullore, kurrë nuk ka qenë në gërshetim më të ngjeshur e më divergjent mes komentimesh e metodash. Mund të thuash se nuk ka sistem e metodë teologjike, letrare, politike e filozofike në Lindje e Perëndim, që të mos e ketë përqendruar vëmendjen në Kuran. Këtë e kushtëzon jo vetëm karakteri planetar i qytetëri-

mit modern, por edhe universaliteti dhe aktualiteti i porosisë kuranore. Rrënjët e kësaj gjendjeje do të duheshin kërkuar, ndër të tjera, qysh në zanafillën, në kohën kur porosia kuranore çau historinë dhe hyri në hapësirën tokësore, duke shënuar atë që i përket të shkuarës, të tanishmes dhe të ardhmes. Kjo logjikë na shtyn që interesimin për Kuranin ta kemi jo vetëm nga vetë myslimanët, por edhe nga jomyslimanët. Në fund të fundit, çdo komentim bashkëkohor i Kuranit do të ishte i cunguar pa përfilljen “e kritikës” judaiste, kristiane, manikeiste të Kuranit, si edhe pa “kritikën” myslimane të tij.

Myslimanët e hershëm gjetën në Kuran **“çdo gjë”** që u nevojitej: ata gjetën përgjigje për sfidat politike e ekonomike, por edhe për sfidat filozofike e religjioze greke, persiane, hinduse etj.


Por, a mund të jetojmë ne myslimanët e sotëm duke u ushqyer me lavdinë e brezave të hershëm?! A do të ishte e ndershme e dinjitoze të mburremi me ta, teksa ne vetë të lavdërohemi me përtacinë konstante?! Natyrisht jo! Para brezit tonë qëndron një punë shumë serioze, e lodhshme: leximi i serishëm i Kuranit, përkthimi i serishëm i Fjalës së Allahut.

Koha, në të cilën dominon shkencë, karakterizohet si kohë e terrorit shkencor. Andaj shtrohet pyetja: a është shkencë moderne shkencë e përgjegjshme, dhe a çan kokën kjo shkencë për dijen drejt së cilës synon? Gjatë një periudhe të gjatë që po kalon kjo shkencë, ne nuk vërejmë përhapje të dashurisë, të kujdesit, të mëshirës e të ndihmës së ndërsjellë. Sot, për fat të keq, ne po shohim vetëm shtrirje të urrejtjes, tmerrit e dhunës. Për herë të parë në histori shtrirja e kufijve të dijes shkon drejt **të panjohurës së rrezikshme**, por vetëm si rezultat i dijes pa Zot, e jo i dijes së fesë, duke mos e pasur atë nën kontroll dhe në dobi të njeriut. **E panjohura e fesë ka nxitur artin, kurse e panjohura e shkencës nxit frikën dhe tmerrin!**

Njerëzimin, e sidomos myslimanët, i pret leximi i ri i Kuranit. Çdo periudhë që pati qasje aktive dhe të sinqertë ndaj Kuranit, u shpërblye me dhuratat të çmueshme. Varësisht nga angazhimi në këtë detyrë, do të pasojë edhe pjesëmarrja dinjitoze në jetën e botës aktuale. Rrjedhat aktuale në botë nuk duhen të neglizhohen, as të anatemohen, sepse një qasje e tillë do të na kushtonte shumë.

Kurani është shpallje përfundimtare, por perceptimi dhe shpjegimi i tij nuk është përfundimtar, ashtu sikundër çdo shi bie në Tokë si rezultat i kushteve gjithnjë të ndryshme, edhe pse teksa bie nga qielli duket gjithnjë i njëjtë.

(Teksti paraqet interpolim dhe interpretim personal të tekstit të gjatë të akademikut Enes Kariq, Universi Kuranor, në: Kuran sa prijëvodom na bosanski jezik, preveo Enes Karić, Sarajevo, 1995, fq. 1229-1269. E falënderoj sinqerisht autorin për këtë tekst të shkëlqyeshëm).



Besimi dhe dialogu ndërfeetar: nevoja, pengesat, mundësitë

Intervistë me Sejid Husein Nasr

...vijon nga numri i kaluar

7. Çfarë do t'u thonit myslimanëve që janë të rezervuar ndaj dialogut ndërfeetar?

Ajo që po them lidhet me një grup të madh myslimanësh, të cilët në të vërtetë janë rritur në numër së fundmi, për shkak të trysnive të jashtme që kanë kërcënuar vetë cohën e jetës myslimane, duke i bërë më përjashtues në vetëmbrojtje. Kur një krijesë kërcënohet nga jashtë, ajo zakonisht tërhiqet te vetja. Kam bindjen se një shekull më parë myslimanët e zakonshëm që faleshin bashkë në xhami ishin shumë më universalistë sesa nipat e tyre. Këshilla ime ndaj tyre është që të ndërgjegjësohen më tepër rreth këtij realiteti dhe ta studiojnë më shumë Islamin e ushtruar nga paraardhësit e tyre tradicionalë. Megjithatë, sot në botën islame ka shumë besimtarë që po ndërgjegjësohen për rëndësinë e dialogut ndërfeetar, përfshirë një sërë dijetarësh formalë të fesë ('ulemā') si myftinj, teologë etj. Kur shihni që thërret për dialog ndërfeetar edhe Mbreti i Arabisë Saudite, një vend që në interpretimin e tij të gjërave është Eëhhābī më përjashtuesja dhe e ngurta e të gjitha shkollave islame të

mendimit ndaj feve të tjera, e kuptoni menjëherë se në të vërtetë kjo është një nevojë shumë e thellë e botës islame.


Për më tepër, ajo që do t'u thoja myslimanëve të kursyer ndaj dialogut ndërfeetar është se ai përbën atë që në arabisht quhet *fard kifājah*, pra detyrë kolektive për krejt bashkësinë, jo për çdo individ të saj, ndryshe nga falja e namazit që është e detyrueshme për çdo person, *fard 'ajn*. Kryerja e dialogut fetar sot është si studimi i shkencës së hadithit, që është një gjë e detyrueshme për bashkësinë islame si tërësi, jo për çdo individ të saj. Disa nuk e kuptojnë; disa nuk ndihen rehat me të. Bukur. Allahu Teala nuk e pret këtë prej gjithkujt, ndërsa në rastin e atyre njerëzve, do t'u thoja se duhet ta lënë gjykimin e feve të tjera në Duart e Zotit e jo të përpiqen të para gjykojnë me dijen e tyre të paplotë, atë që do ta gjykojë përfundimisht Zoti. Ata duhet të kenë qëndrimin e moskundërvënies agresive ndaj feve të tjera dhe dialogut ndërfeetar vetëm pse nuk ndihen rehat të merren me to. Ata duhet ta ndjekin Islamin me sinqeritet e t'i dorëzohen Zotit, duke ua lënë gjykimin e feve të tjera Duarve të Tij. Siç thotë Kurani, *lekum dīnukum ēālī dīn*, pra "juve fenë tuaj, mua timen." Sa për grupet e tjera të

njerëzve që e kanë aftësinë për të marrë pjesë në mënyrë kuptimplote në dialog dhe mund të joshen apo edhe të shndërrohen nga dialogu ndërfeetar, ata duhet të kuptojnë përse është kaq i rëndësishëm dialogu fetar, përse ai ka të bëjë me vetë mbijetimin e fesë në të ardhmen, përse – nëse fëmijët e tyre ndjekin një universitet modern, qoftë në botën islame apo në Perëndim – dialogu ndërfeetar është garancia më e mirë që ata të mbeten të interesuar në fe e jo t’ia kthejnë shpinën plotësisht. Ka shumë çështje të tilla që mund të shpjegohen dhe shumë argumente që duhen shtruar.

Në këtë lëm nevojitet edhe kurajo. Njerëzit e përkushtuar ndaj dialogut ndërfeetar duhet të kenë kurajon t’i durojnë kritikën që do t’u bëhen. Këtë e kam përjetuar shumë herë në jetën time dhe flas nga përvoja. Duhet të kesh kurajon për të qëndruar në pozicionin tënd, për të qenë i ndershëm, i sigurt dhe për të mbetur i përkushtuar, në mënyrë që dialogu ndërfeetar të mos të ta hollojë devotshmërinë ndaj besimit tënd. Kjo është ajo që cilës i druhen shumë njerëz në botën islame, ashtu sikurse në botën e krishterë dhe çifuten. Ka shumë çifutë besimdrejtë që refuzojnë të kenë dialog; ka shumë katolikë e protestantë që refuzojnë të dialogojnë. Kjo dukuri nuk është unike për myslimanët dhe është ndër rrjedhojat të cilës i druhen të gjithë. Prandaj, është shumë e rëndësishme që ata të cilët kryejnë dialogun ndërfeetar ta bëjnë këtë fetarisht e jo thjesht si studiues sekularë në një universitet, në mënyrë që t’u tregojnë bashkëfetarëve të tyre, qofshin myslimanë apo të tjerë, se nuk janë bërë më pak të devotshëm pas zhvillimit të dialogut ndërfeetar e bisedimit me ndjekës të besimeve të tjera për të arritur një të kuptuar më të thellë e dhembshuri për tjetrin.


8. Cilat janë pengesat kryesore për bashkëveprim fetar në botën myslimane dhe në Perëndim?

Në botën islame, pengesat kryesore janë jo vetëm teologjike por edhe politike, sepse në disa vende myslimane këto dialogje zakonisht mbikëqyren me kujdes nga autoritetet politike dhe disa lloje inkurajohen, ndërsa të tjerat shkurajohen. Ekzistojnë gjithashtu pengesat e ardhura nga të ashtuquajturat grupe “fundamentaliste” – nuk e pëlqejnë këtë term – por gjithsesi nga grupe përjashtuese, njerëzit të kapur fort vetëm pas mesimeve, formave dhe aspekteve të jashtme, sipërfaqësore, ekzotrike të feve të tyre pa vështruar të brendshmen, shpirtëroren, ezoteriken, ku mund të gjendet të kuptuarit e



vërtetë e tjetrit. Siç mund ta shihni, ata i ngrenë pengesa bashkëveprimit ndërfeetar në shumë pjesë të botës islame, madje duke i shkurajuar individët nga veprimtari të tilla. Kjo bie në sy në Egjipt, por edhe në një vend shumë të ndryshëm nga Egjipti, sikurse Arabia Saudite, në Pakistan, në disa raste edhe në Iran ... në mbarë botën islame.

Por një kundërvënie e tillë nuk është e njëjtë kudo. Ka shumë vende islame, në rendin shoqëror e politik të të cilave nuk ekzistojnë pengesa të pakalueshme. Përkundrazi, pengesat vijnë nga brenda si dhe nga fakti se deri tani shumica e myslimanëve nuk e kanë ndjerë nevojën për bashkëveprim ndërfeetar. Të mos harrojmë përvojën myslimane të sistemit osman, në të cilin të krishterët dhe çifutët jetonin në paqe në bashkësi, me ligjet e tyre, por në ndërveprim me shumicën myslimane. Sigurisht, ky është një bashkëveprim i ndryshëm me “tjetrin” nga ai për të cilin po flasim tani, kur ekziston mundësia e një dialogu ndërfeetar që duhet mbështetur në diskutimin e çështjeve teologjike dhe depërtimin në njëfarë shkalle tek bota intelektuale dhe shpirtërore e palës tjetër. Por



kujtimi historik i një situate të tillë mbetet dhe ai bën që shumë myslimanë të ndjejnë se prania e feve të tjera nuk është risi e kësaj nuk kanë nevojë për dialog ndërfaqar. Është e vërtetë se ky [dialog] nuk ka qenë i nevojshëm në kohë tradicionale, me pak përjashtime të përmendura më lart, por tani po bëhet gjithnjë e më i domosdoshëm. Në shumë vende, përvoja të tilla historike, kujtimi i të cilave mbetet akoma, janë ndër pengesat kryesore. Por kemi edhe faktin se disa njerëz ndjejnë se ekziston një pengesë që vjen nga njëfarë inercie ose mungese e nevojës për dialog, e cila rezulton nga historia e mëhershme e familjes apo e qytetit të tyre, ose historia intelektuale që ata ndjekin. Ka njerëz madje që mendojnë se dialogu ndërfaqar është pjesë e axhendës së krishterë, me të cilën myslimanët s'kanë pse merren. E përsëris, nuk mendoj se dialogu serioz dhe i thellë fetar është i përshtatshëm për t'u kryer nga çdo ndjekës i Islamit apo i feve të tjera. Një pohim i tillë do të ishte absurd. E rëndësishme është të kultivohet një ndjesi respekti për tjetrin, mbështetur në mësimet e atyre që mund të ofrojnë çelësa për të kuptuarit e tjetrit, njerëz të cilët, falë virtytit dhe dijes mbi traditën e tyre, mund të jenë zë i respektuar dhe i besuar brenda bashkësisë përkatëse.

Ndërsa në Perëndim pengesat janë shumë të ndryshme. Aty nuk ekziston asnjë pengesë e drejtpërdrejtë politike ndaj dialogut ose bashkëveprimit ndërfaqar. Ose më saktë, nuk ka pengesa politike përveçse në disa qarqe fundamentaliste në Amerikë. Ekzistojnë shtrëngesa fetare me një përmasë politike brenda bashkësive të krishtera, që do të përkonin me ca grupe përjashtuese në botën islame – disa fundamentalistë protestantë, ose grupe të caktuara katolike që i kundërvihen tejet fuqimisht dialogut ndërfaqar me besimet e tjera, sidomos Islamin, por madje edhe Judaizmin. Gjithashtu, brenda Judaizmit, ka shumë grupe ortodokse dhe serioze çifute që i kundërvihen dialogut, por në Perëndim përgjithësisht nuk ekziston kundërvënie politike ndaj dialogut serioz. Pengesa shumë më e hollë që ekziston në Perëndim është se atje është zhvilluar disiplina njëshekullore e studimit të fesë dhe të feve, e quajtur *Religion swissen schaft* nga gjermanët, e cila bazohet në studimin jofetar e madje antifetar dhe sekularist të fesë. Kjo qasje akademike ndaj studimit të fesë mbështetet në historicizëm ose në një fenomenologji që s'u kushton vëmendje fenomeneve, pra realitetit të brendshëm të gjërave. Ajo i ka mbizotëruar studimet fetare në Perëndim, veçanërisht në universitete të fundmi. Ja përse shumë prej dialogjeve ndërfaqare të kryera janë kombinuar gjithashtu me një hollim ose flakje të formulimeve tradicionale të feve të ndryshme. Kjo është një pengesë shumë serioze, sepse do të shpjerë përfundimisht ose në idenë e emëruesit më të vogël të përbashkët të synimit të dialogut fetar, e cila po qarkullon atëherë sot, ose në shpërbërjen e idesë së sakrale, e cila sigurisht ndodhet në zemrën e të gjitha feve.

9. Ne njerëzit modernë priremi ta shohim të kaluarën në një mënyrë disi stereotipe, si epoka përjashtimi dhe intolerance, ndërkohë që ekzistojnë precedentë historikë për bashkëveprim ndërfaqar, nga të cilat mund të mësojmë.

Jo vetëm që ekzistojnë mësimet ose precedentë historikë nga të cilat mund të mësojmë, por do të shtoja se dikur kishte shumë më pak ekskluzivizëm dhe intolerancë sesa sot, nëse merret parasysh sasia e dijes që dispononin njerëzit për "tjetrin". Ndërkohë që mund të mos ketë qenë e vërtetë për shumicën e Krishterimit Perëndimor, kjo ka qenë me siguri e vërtetë për botën islame, e cila ndodhet në mes të globit dhe në të cilën ka shumë më tepër njohuri për Krishterimin e Judaizmin

nga njëra anë dhe Hinduizmin e Budizmin nga tjetra, me Zoroastrianizmin e Manikeizmin në mes, sesa ajo që shohim në Perëndimin paramodern për fetë e tjera. Madje edhe sot, një fshatar i thjeshtë pranë Shirazit në Iran ka më shumë njohuri dhe vetëdije për fetë e tjera sesa shumë njerëz në pjesë të caktuara të Shteteve të Bashkuara. Këtë e di nga përvoja. Kështu që po, ekziston me siguri një stereotipizim tejet fatkeq i epokave të shkuara.

Por krahas kësaj, kemi raste të spikatura të interesimit më të thellë për bashkëveprim ndërfaqetor përpara kohëve moderne, që mund të na shërbejnë si modele. Më lejoni të përmend vetëm disa. I pari – të fillojmë me Perëndimin – është ai i Andaluzisë. Në Gadishullin Iberik, por veçanërisht në Andaluzi, ku të krishterët, çifutët e myslimanët jetonin krah për krah, kishte aq ndërveprime, që janë tepër të shumta për t'u numëruar, por të cilat prodhuan, nga njëra anë figura të tilla si Muhjīd-Dīn Ibn 'Arabīu, i cili është një nga shtjelluesit më të mëdhenj të metafizikës së larmisë fetare, veçanërisht në librin e tij *Fusūsu'l-hikem* ("Rruazat e urtisë"). Nga ana tjetër ajo çoi në shfaqjen e një personi si Shën Gjoni i Kryqit në anën e krishterë, i cili edhe pse ishte shenjtor kristian, u ndikua thellësisht nga poezia sufiste. Këtë të vërtetë mund ta vërejmë kur e studiojmë më plotësisht raportin e tij me Islamin.

Pastaj kemi shumë shembuj në botën osmane të këtij bashkëveprimi të harmonishëm mes feve, të paktën abrahamikeve. Në Iran ka qenë kështu gjithmonë me shtimin e Zoroastrianizmit në listën e feve pakica që jetojnë në një bashkësi islame. Mes botës iraniane e turke kemi figurën e Xhelāl ed-Dīn Rūmīut, i cili sigurisht jetoi përpara vendosjes së Perandorisë Osmane, por në atë që u bë zemra e botës osmane, pra Turqia. Në shkriimet e Rūmīut kemi disa nga shtjellimet më të mëdha e më të bukura të asaj që Schuon e ka quajtur "uniteti transhendent i feve", doktrinës se të gjitha fetë autentike vijnë nga Zoti dhe se dallimet mes tyre mbështeten në ndryshime të perspektivës dhe rendit formal, si dhe mënyrën sesi çdonjëra prej tyre e sheh Realitetin e vetëm Hyjnor, mbi të cilin mbështeten të gjitha. Ç'është e vërteta, krejt literatura dhe tradita sufiste, duke u kthyer deri te Halāxhi e sidomos letërsia sufiste në Persisht, është e mbarsur dhe përplot me referime ndaj këtij uniteti transhendent, që nga Bābā Tāhir 'Uryāni tek Sana'iu tek Xhelāl ed-Dīn Rūmīu dhe shumë të tjerë, çdonjëri



nga të cilët flasin për unitetin e esencës së feve dhe larminë e formës fetare.

Pastaj kemi shembullin e Indisë, ku shohim takime të shumta ndërmjet sufive dhe jogive hindu, me diskutimet e tyre ndërfaqetare. Pikërisht në Indi ndodhi një ngjarje madhore rreth katër shekuj më parë: përkthimi i *Upanishadeve* nga sanskritishtja në persisht, çka më në fund e solli këtë tekst në Europë përmes Anquetil-Duperron, kur ai e përktheu tekstin persisht në latinisht dhe ia paraqiti Napoleonit më 1804, e së andejmi *Upanishadet* u bënë të njohura në Evropë. Ka shumë raste të tilla që nuk janë studiuar plotësisht. Në studimin tim modest të traditave filozofike e mistike në Islam, ndesh raste të mahnitshme të këtij bashkëveprimi ndërfaqetor - të mos flasim për gjithë ato diskutime teologjike të mbajtura në Islam, por në kontekstin e shumë feve, sikurse në librin *el-Milel we'n-nihel* të Shahrestāniut, etj. Me siguri, të parët tanë na kanë lënë shumë precedentë historikë, teologjikë dhe metafizikë të një rëndësie sipërore, të cilat mund të na shërbejnë si udhërrëfyes e model në kërkimin tonë për dialog dhe mirëkuptim serioz ndërfaqetor.

Shqipëroi: Edin Q. Lohja
Washington DC, 13.04.2010.



MURABAHA

një organizim biznesi

Hamdi Nuhiju

NEVOJA PËR NJË ORGANIZIM BIZNESI

Sot jetojmë pothuajse në një sistem të kompjuterizuar. Në çdo fushë të jetës vihet re një kompjuterizim shumë i shpejtë. Në veprimtaritë e tyre ekonomike, njerëzit janë të detyruar të punojnë çdo ditë e më tepër për të përballuar nevojat e tyre jetike.¹

Në kushtet e tranzicionit, si edhe të krizës financiare botërore, nevoja për një organizim biznesi rritet përherë e më shumë në mënyrë të dukshme. Kjo nevojë reflekton në të gjitha sferat e jetës së njeriut, sidomos të qytetarit të thjeshtë të vendeve të Gadishullit Ballkanik. Në kushte të tilla, ku ndodh zhvlerësimi i parasë dhe rrezikohet mbajtja e parave në rezerva shtetërore, investimi është diçka e domosdoshme.

Çdo ditë, nëpër gazeta të ndryshme lexojmë për grabitjet e ndërmjetësuesve dhe të financiarëve në mes të ditës, për largim të punëtorëve nga puna, për padrejtësi ndaj pu-

nëtorëve, abuzim me mjete financiare, rritje të çmimeve të ndryshme të rrymës elektrike dhe shpenzime të tjera jetësore.

Islami urdhëron që çdo person në shoqërinë myslimane të punojë, në mënyrë që të ketë mundësi të kujdeset për vete dhe për pjesëtarët e familjes që varen prej tij, e të mos mbështetet në sigurimin shoqëror, përveç rasteve kur nuk ka mundësi të punojë.²

Islami e njeh të drejtën e nevojës për ndihmë. Kurani e konfirmon të drejtën e çdo njeriu për të kërkuar ndihmë nga myslimanët, por ai gjithashtu thekson se, në qoftë se myslimani merr vesh se ndonjë njeriu të caktuar i mungojnë nevojat jetike, atëherë, pa marrë parasysh nëse ai njeri kërkon ndihmë apo jo, myslimani është i detyruar t'ia ofrojë tërë ndihmën që mundet.³

Fillimisht duhet të qartësojmë se është koncept i gabuar mendimi që flet për një jetë shoqërore, ku pjesëtarët e saj

1. Universiteti i padukshëm, Prof.dr.Ersin Nazif Gurdogan, Tiranë, 2004, fq62.

2. Shoqëria ideale, Dr.Muhammed Ali el Hashimi, Prishtinë, 2009, f.173.

3. Të drejtat e njeriut në Islam, Mevdudi, Shkup, 1992, f.44.

janë absolutisht të barabartë. Një gjë e tillë bie ndesh me realitetin jetësor. Njerëzit janë krijuar me dallime organike, psikike dhe kulturore. Ky dallim reflektohet edhe në veprimtarinë e tyre ekonomike. Është shumë normale që të ketë njerëz të pasur. Është jonormale që dallimi në të ardhurat ekonomike të jetë shkak i privilegjeve politike dhe juridike.⁴ Por individët janë ato që përbëjnë shoqërinë, ndërsa kapitali është shtylla e drejtësisë midis individëve dhe shoqërisë moderne. Njeriu ka një numër detyrash si anëtar i shoqërisë apo i shtetit në të cilin bën pjesë.⁵

Islami nuk e mohon jetën e kësaj bote, duke sugjeruar që njerëzit të jetojnë të varfër e të mos organizohen në përfitime materiale. Ai kujdeset për anën shpirtërore të besimtarit, por edhe për anën materiale të tij. Përmes anës materiale d.m.th. përmes dynjasë, ai arrin të realizojë urdhrat e Allahut (xh.sh.) për t'u shpërblyer në ahiret.


Gjatë ecurisë së zhvillimit të vet, njerëzimi i ka ndarë këto dy rrugë me pretekstin se për shkak të ahiretit duhet përmbajtur nga dynjaja, duke qenë se puna për dynja merr kohën e nevojshme për ahiret. Kjo ndarje është ngulitur thellë tek njerëzit, duke mos u kufizuar vetëm në këtë marrëdhënie, por duke u shtrirë e përfshirë të gjitha sferat e tjera të ekzistencës së njeriut:

- kjo dhe bota tjetër janë dy realitete të ndara,
- trupi dhe shpirti janë dy botë të ndara,
- bota materiale është e ndarë nga ajo jomateriale,
- bota fizike është e ndarë nga ajo metafizike,
- jeta praktike është e ndarë nga ajo ideo-etike.

Nuk ekziston ndonjë rrugë e ahiretit, e quajtur ibadet, siç nuk ekziston as ndonjë rrugë e dynjasë, që do të quhej punë, veprim. Kjo është e njëjta rrugë, e cila fillon në dynja e përfundon në ahiret, rrugë në të cilën puna nuk ndahet nga ibadeti, e as ibadeti nuk ndahet nga puna.⁶

Islami e çmon rëndësinë e nevojave materiale, por pa i mëshuar me tepri rolit të tyre në mirëqenien e përgjithshme të njeriut, arsye për të cilën në Islam njeriu është qenie fizike e shpirtërore.⁷

Koncepti islam mbi shoqërinë dhe individin ndërtohet mbi parimet e qarta kuranore të formimit të individit të shëndoshë, por edhe të shoqërisë së shëndoshë në të cilën të gjitha elementet e saj do të jenë të barabartë dhe



unike në çdo segment jetësor.⁸

Ne kemi thënë vetëm se Islami tregohet një udhëheqës efikas në planin material të jetës së njeriut, ashtu si dhe në planin shpirtëror.⁹

Sistemi i ekonomisë islame është ngritur si alternativë ndaj kapitalizmit perëndimor që gjoja adhuron autonominë e individit dhe ekonominë e planifikuar të socializmit lindor, i cili përmes një entuziazmi të verbër i përulet shtetit kolektivisht.¹⁰

Sistemi islam e merr njeriun nën mbrojtje në të gjitha pikëpamjet dhe e rregullon jetën e bashkësisë tërësisht e jo pjesërisht.¹¹

Po të analizojmë sistemet ekonomike, atë socialist dhe këtë kapitalist, do të verënim se dallimi midis tyre qëndron në sferën e pronësisë. Sistemi socialist është kategorik për pronën shtetërore, ndërsa sistemi kapitalist i jep përmasa të tepruara pronës private.

4. Koncepte dhe sisteme bashkëkohore, Ali Bullaç, Shkup 2005, f. 305.

5. Hyrje në Islam, Dr.Muhammed Hamidullah, Shkup, 1985, f.158.

6. Sa jemi mysliman?, Muhamed Kutub, Shkup, 1999, f.37.

7. Islami dhe paqja universale, Prof.Sejjid Kutub, Tetovë 2005, f.145.

8. Solidariteti Islam, Bashkim Aliu, Shkup, 2003, f.3.

9. Uvod u Islam, Dr.Muhammed Hamidullah, Sarajevo, 1982, f.145.

10. Islami si alternativë, Dr.Murad Hofman, Shkup, 2000, f.131.

11. Kamata në këndvështrimin kuranor, Sejjid Kutub, Shkup, 2002, f.64.

Edhe pse Islami e pranon pronësinë private, shoqëria e re islame duhet të deklarohet qartë se të gjitha burimet e mëdha të pasurisë shoqërore, e sidomos burimet natyrore, do të duhet të jenë patjetër në pronësi të bashkësisë dhe t'u shërbejnë të mirave të të gjithë anëtarëve të saj. Mbikëqyrja shoqërore e burimeve të pasurisë është e domosdoshme, sepse nga njëra anë pengon pasurimin e pabazë dhe fuqizimin e individëve, kurse nga ana tjetër siguron bazën materiale për sendërtimin e programit të zhvillimit në sferat e ndryshme të jetës, të cilat mund t'i ndërmarrë bashkësia në përputhje me rolin gjithnjë e më të madh të shoqërisë së organizuar në jetën e popujve.¹²

Në mënyrë të përmbledhur do të mundohemi të qartësojmë modelin ose alternativën e një biznesi të organizuar sipas pikëpamjeve islame.

HYRJE

Kemi vendosur të shkruajmë për Murabahan, një instrument financiar islam, por edhe një formë organizimi të biznesit. Ekzistojnë përkufizime të shumta në lidhje me të. Ne do të mundohemi të përmbledhim vetëm disa prej tyre, me qëllim që të qartësojmë qasjen tonë në këtë punim.

Në ekonominë islame, murabah nuk njihet si formë e organizimit të biznesit, por si një lloj tregtie.

Shitja murabaha është një nga format e shitjeve të lejuara sipas Islamit, ku klienti i kërkon bankës blerjen e një malli në interes të tij, mbi bazën e cilësimit që ai i bën mallit, e më pas bëhet marrja e premtimit nga ndërmjetësuesi financiar, me anën e të cilit përcaktohet ky mall do t'i shitet atij me një fitim të deklaruar me këste, sipas mundësisë.¹³

Murabah përkufizohet si shitje në bazë të urdhrat ku kemi të bëjmë me një transaksion financiar, i cili bazohet në marrëdhëniet shitje-blerje, ku blihet malli dhe shitet me një provizion të caktuar për përfitim të ndërmjetësit a bankës (në këtë rast).¹⁴

Murabaha, është ajo formë e shitblerjes, në të cilën klienti kërkon nga ndërmjetësuesi financiar të blejë një produkt të përshkruar, duke i premtuar se do ta blejë prej tij. Këtu ndërmjetësuesi financiar paguan çmimin në para të gatshme (e blen produktin në emër të tij pastaj ia shet klientit në një kontratë të re, me një çmim më të lartë e me

këste, duke mos qenë premtimi detyrues nga dy anët.¹⁵

“Shitja “El Murabaha”, ka qenë shembulli më i mirë i zgjedhur në lidhje me shitjen e pjesëve aksionare, duke pasur parasysh se pas përmbushjes së kontratës në shitjen “murabaha”, është plotësisht e mundur njohja e fitimit dhe afati i meritimit të tij, por përderisa vetë borxhet nuk lejohen të shiten, veçse me të njëjtën vlerë, nëse këto borxhe janë pjesë të disponueshmeve të përziera me të hollat dhe objektet, atëherë ato bëhen të vlefshme për shitje; kështu, sipas këtij përfundimi ato lejohen.”¹⁶

Murabaha është një financim kostoje plus fitimin. Përgjithësisht, murabah është një teknikë e përdorur për të lehtësuar veprimtaritë financiare tregtare të institucioneve financiare islame. Institucioni financiar blen mallra të nevojshme nga një palë e tretë për klientin e tij. Pastaj, ato mallra ia shet me këste klientit, duke përfshirë kështu edhe fitimin me cesion. Të gjitha kontratat e mësipërme janë ndërmarrë sipas kërkesës së konsumatorit dhe të gjitha kushtet e nevojshme janë të vendosura në kontratë. Marrëveshje të tilla nuk konsiderohen në kundërshtim me sheriatin, pasi ndërmjetësuesi financiar merr përsipër të gjitha rreziqet e këtij transaksioni, çmimi caktohet në kontratë, ndërsa klienti nuk rrezikohet nga luhatjet e kreditimit, duke qenë se çmimi është fiks.¹⁷

Murabaha është një strukturë islame e financimit, mbi bazën e së cilës një blerës blen një pronë përmes ndërmjetësit, me një çmim të caktuar në këste e me një fitim të përshkruar sipas marrëveshjes.¹⁸

Marrëveshjet murabaha janë përdorur kryesisht për të blerë makina dhe shtëpi. Por, njëkohësisht ata janë përdorur edhe për të financuar bizneset e importit.

Murabaha është një marrëveshje, sipas të cilës një shitës mund të blejë mallra me kërkesën e një blerësi. Për mallra, të cilat nuk ka mundësi t'i sigurojë në rrugë tjetër, blerësi mund të paguajë me këste kur shuma është e madhe, ose edhe në kesh.¹⁹

Në kuptimin e saj origjinal, murabaha është vetëm një shitje. Vetëm se funksioni i saj dallon prej llojeve tjera të shitjes, ngaqë këtu dihen edhe kostoja edhe fitimi nga shitja.²⁰

12. Deklarata islame, Alija Izetbegović, Prishtinë, 1999, f.38.

13. Kamata, lufta me Allahun, Shejh Utjeimin, Tiranë, 2004, f.61.

14. http://sq.wikipedia.org/wiki/Ndërmjetësuesi_financiar_islam.

15. http://albislam.org/meso/hulumtime_studime/fikh/3209.html.

16. <http://www.rrugetepages.net/tematemeparshme/tema16.html>.

17. <http://www.encyclo.co.uk/define/Murabaha>.

18. <http://www.investopedia.com/terms/m/murabaha.asp>.

19. <http://www.mortgages.co.uk/islamic-mortgages/forms-of-islamic-finance.html>.

20. <http://www.kantakji.com/fiqh/Files/Finance/Murabaha.htm>

DISA KARAKTERISTIKA TË KËSAJ MARRËVESHJEJE

Kjo formë e shitblerjes ose kjo marrëveshje bazohet mbi:

1. Premtimin e blerjes nga klienti ose garantimin e blerjes së saj me garanci.
2. Premtimin e bankës për shitje.
3. Lidhjen e kontratës së shitblerjes Murabaha, pasi ndërmjetësuesi financiar ta ketë kaluar mallin në pronësinë e tij.
4. Në këtë rast vërejmë se ndërmjetësuesi financiar e kalon mallin e blerë në pronësi të tij dhe mban përgjegjësi të plotë për amortizimin e mallit; më pas ky mall i shitet klientit me një përqindje fitimi hallall dhe nuk përmban asnjë lloj dyshimi për kamatë.²¹

TANI LE TË SHOHIM VEPRIMTARINË E REALIZIMIT TË KËSAJ MARRËVESHJEJE

- Klienti e informon ndërmjetësuesin financiar në lidhje me kërkesat e dokumentit të tij të kredisë për blerje, importim të mallrave, gjë që në këtë mënyrë tregon se ai duhet të ketë dëshirë të blejë mallrat nga ndërmjetësuesi financiar sipas parimit të el murabah (kosto plus ose ngritje çmimi).

- Ndërmjetësuesi financiar harton dokumentin e kredisë dhe paguan procedurat për negociatat me bankën, duke shfrytëzuar fondet e saj.

- Ndërmjetësuesi financiar i shet mallrat për klientin me një çmim që përfshin një teprice të fitimit, sipas parimit të el murabah për pagesë me para në dorë ose përmes një afati me kusht.²²

DISA NGA SPECIFIKAT E KËSAJ MARRËVESHJEJE

1. Murabah është një lloj i veçantë shitjeje, në të cilën shitësi deklaron shprehimisht koston e mallrave të shitura dhe e shet atë për klientin duke i shtuar vetëm pak në çmim.

2. Fitimi i Murabah mund të përcaktohet nga pëlqimi i dy palëve për një çmim mbi koston

3. Të gjitha shpenzimet e shitësit në blerjen e mallrave përfshihen në çmimin e koston, ndërsa shpenzimet shtesë



administrative nuk mund të përfshihen në çmimin e koston, ngaqë ato llogariten tek pjesa e fitimit mbi koston.

4. Murabah është i vlefshëm vetëm nëse bëhet konstatimi i saktë i koston. Përndryshe, nëse ky konstatim i saktë nuk bëhet, murabah nuk mund të jetë i vlefshëm.²³

PËRFUNDIM

Ne u munduam ta qartësojmë konceptin e murabaha-së në mënyrë të përmblodhur, si një formë mjaft efektive të organizimit të biznesit. Në ditët e sotme është mëse e nevojshme që në transaksionet tregtare dhe financiare të ekzistojë një ujdë ose marrëveshje, e cila nuk do të cënojë interesat e asnjërës palë. Murabaha u mundëson të rinjve që ta lehtësojnë jetën e tyre; gjithashtu ajo ndihmon edhe ata që kanë ide biznesi, që të mund të gjejnë një mënyrë të përshtatshme për të financuar projekte të ndryshme, por edhe për të arritur një fitim të caktuar. Shpresojmë se këto parime të financimit islam do të mund të gjejnë shumë shpejt mundësi për t'u përdorur edhe në popullsinë tonë.

21. Kamata lufta me Allahun, Shejh Uthejmin, Tiranë, 2004, f.61-62

22. Grup autorësh, *Hyrje në ekonominë dhe financat islame*, Prishtinë, 2008, f.309.

23. <http://www.kantakji.com/fiqh/Files/Finance/Murabaha.htm>.

Disa urtësi në ajetin

e infakut



Dr. Durak Pismaz

Sinfak do të thotë të shpenzosh dhe të harxhosh pasurinë në rrugë të hajrit për hir të Allahut dhe jo të shpenzuarit e saj në mënyrë të pakujdesshme dhe të pamenduar.

Siç shprehet edhe Pejgamberi ynë i nderuar, një prej veçorive të muajit të Ramazanit është “shehru’l-muvasat”, që do të thotë muaji i ndihmës reciproke. Në përgjithësi, besimtarët e japin zekatin gjatë këtij muaji. Gjithashtu, edhe sadakatu’l-fitri jepet në këtë muaj. Ata që kanë mundësi u shpërndajnë ushqime të varfërve. Veçanërisht në këtë muaj, ftohen njerëzit për yftar. Në të vërtetë, të gjitha këto janë gjëra të bukura dhe përmbajnë shumë sevap. Kur këto bëhen në muajin e shenjtë të Ramazanit, besimtarëve u shumëfishohen sevapet. Në fenë tonë emri i përgjithshëm i ndihmës reciproke është infak. Libri ynë i Lartë, Kurani fisnik flet shumë për infakun.

Në ajetet e para të sures Bekare, Allahu i Lartmëdhuar përcakton disa nga cilësitë e njerëzve të de-

votshëm, duke thënë: **“Ata besojnë në të fshehtë, e falin namazin dhe japin nga ajo që u kemi dhënë Ne”**.¹

Siç shihet, në ajetin e mësipërm bëhet fjalë për tri cilësitë kryesore të njerëzve të devotshëm:

a- Ata i besojnë gajbit (të fshehtave); të vërtetave që nuk mund të perceptohen me organet shqisore, por rreth të cilave informohemi me anë të shpalljes hyjnore. Në rrethin e të fshehtave, pra të gajbit përfshihen Allahu, xheneti, xhehenemi, engjëjt si dhe të ngjashme me to.

b- Ata falin namazet duke i respektuar rregullat dhe kushtet e tij.

c- Ata japin (i dhurojnë njerëzve në nevojë) nga gjërat që Allahu u ka dhënë atyre.

Në këtë shkrim, mes këtyre tri cilësive të njerëzve të devotshëm, ne dëshirojmë të trajtojmë vetëm in-

1. Surja el-Bekare, 2/3.

fakun.

Sipas fjalorit, fjala infak do të thotë nxjerrja e pasurisë dhe harxhimi i saj, ndërsa si një term fetar do të thotë ta shpenzosh dhe ta harxhosh pasurinë në rrugë të hajrit për hir të Allahut dhe jo ta shpenzosh me pakujdesi dhe në mënyrë të pamenduar.

VEÇANËSITË QË TËRHEQIN VËMENDJEN TONË

Në ajetin e mësipërm ka disa pika që tërheqin vëmendjen tonë, pika të cilat dëshirojmë t'i shtjellojmë shkurtimisht.

1- Në ajet njoftohet se të devotshmit nuk e japin të gjithë pasurinë, por një pjesë të saj. Këtë e shpreh shkronja 'min', e cila kalon në pjesën e ajetit 'min ma razeknahum'. 'Min' shpreh pjesshmëri, domethënë "ata japin një pjesë të pasurisë së tyre". Pra, për shkak të mëshirës që ka ndaj nesh dhe për shkak se e di mirë dobësinë tonë ndaj pasurisë, Allahu i Lartësuar nuk dëshiron që ne të japim të gjithë pasurinë tonë, por vetëm një pjesë të saj. Kjo specifikë shprehet edhe në ajete të tjera. Në një ajet fisnik, duke iu drejtuar Pejgamberit tonë të Nderuar, Allahu i madhëruar thotë: "Nëse të pyesin se çfarë duhet të japin si lëmoshë. Thuaju: 'Tepricën!'."²

2-Po ashtu, shprehja 'min', e cila gjendet në ajet e që shpreh pjesshmëri, tregon largimin nga shpenzimi i tepërt qoftë edhe në infak. Besimtari është njeri i ekuilibruar. Në çdo sjellje të tij, konkretisht në infak, nuk është koprac, por as nuk tepron. Në Kuranin Fisnik, kur flitet për cilësitë e robërve të devotshëm të Allahut, lavdërohen ata që u përmbahen rrugës së mesme në infak: "Ata, kur shpenzojnë, nuk janë as dorëshpuar dhe as dorështrënguar, por i përmbahen së mesmes"³. Kjo specifikë ceket edhe në një ajet tjetër: "Jepuni të afërmve, varfërve dhe udhëtarëve të drejtën e tyre, por mos bëni shpenzime të tepruara. Dorëshpuarit janë me të vërtetë vëllezërit e djallit dhe djalli është mosmirënjohës ndaj Zotit të tij."⁴

3- Në ajetin fisnik është shumë interesant fakti se nga Allahu nuk përdoret forma urdhërore, siç mund



të jetë për shembull "jepni", por thuhet "ata japin", sepse "njerëzit e devotshëm nuk kanë nevojë të urdhërohen për të dhënë." Meqenëse janë njerëz bamirës dhe bujarë, ata japin vetvetiu dhe ndiejnë kënaqësi duke u dhënë të varfërve prej pasurisë së tyre dhe duke e ndarë atë me të tjerët.

4- Pjesa e ajetit "...japin nga ajo që u kemi dhënë Ne" ka për qëllim të shprehë se ata nuk presin ndonjë mirënjohje e as nuk e përmendin mirësinë që i bëjnë dikujt, meqenëse janë të vetëdijshtëm se zotëruesi i vërtetë i pasurisë së tyre është Allahu i Lartmadhëruar, teksa ata vetë janë thjesht ruajtës të përkohshëm të pasurisë dhe të pronës që u ka dhënë Ai. Ata janë të vetëdijshtëm se nuk po japin nga pasuria e tyre, por nga pasuria që Allahu u ka falur e dhuruar.

5- Në pjesën e ajetit ku thuhet "...razeknahum / ajo që u dhamë Ne" ceket edhe fakti se të devotshmit nuk druhen se mund t'u pakësohet pasuria nga shkak i dhurimit. Kjo, sepse dhënësi i vërtetë i riskut është vetëm Allahu i Lartmadhëruar. Aja çfarë na përket

2. Surja el-Bekare, 2/219.

3. Surja el-Furkan, 25/67.

4. Surja el-Isra, 17/26-27.



neve është përpjekja për ta kërkuar atë (riskun). Kjo e vërtetë shprehet në ajetin, “S’ka asnjë gjallesë në tokë që Allahu të mos ia ketë garantuar riskun”.⁵

Kur njeriu bie në vështirësi, ai hap duart dhe bën dua, i lutet e i përgjerohet Zotit të Lartësuar për ta ndihmuar në zgjidhjen e problemit që ka. Kjo është diçka e mirë dhe buron nga besimi i fortë dhe i pafund që ai ka tek Allahu. Për të merituar ndihmën e Allahut kur jemi në vështirësi, duhet që së pari të ndihmojmë të tjerët kur jemi në kohë bollëku. Për këtë arsye, Pejgamberi ynë i Nderuar na njofton nëpërmjet një hadithi kudsi se Allahu i Lartësuar ka thënë: “O biri i Ademit, jep në mënyrë që edhe unë të të jap ty”.⁶

Në disa hadithe të tjera, i Nderuari ynë ka thënë: “Allahu, i Shumëmëshirshmi, mëshiron ata që mëshirojnë. Mëshironi ata që janë në tokë, që t’ju mëshirojnë ata që janë në qiell.”⁷ “Mëshironi të tjerët, ashtu që të mëshi-

roheni. Falni gabimet e të tjerëve, ashtu që edhe Allahu t’ju falë juve.”⁸

6- Fjala infak dhe nafakë vijnë nga e njëjta rrënjë. Nafakë do të thotë ushqime, ose para e nevojshme me të cilën njeriu mund të sigurojë jetesën e tij. Edhe paratë që u jepen jetimëve ose grave të divorcuara për të siguruar jetesën, quhen nafakë. Në ajet shprehet se ata të cilëve u jepet infaku, nuk e përdorin atë për qejf e zbavitje, por për të kryer nevojat e tyre të domosdoshme, ose thënë ndryshe për të siguruar nevojat themelore të jetesës.

NJË TRAJTESË E GJERË

Ka mendime të ndryshme sipas të cilëve me infak kuptohet zekati i cili është farz, apo sadakaja e cila është nafile. Faktikisht fjala infak është një fjalë me kuptim shumë të gjerë dhe përbën emërtimin e përgjithshëm të ndihmës reciproke, të solidarizimit dhe të dhënies për hir të Allahut, ndërsa zekati dhe sadakaja nuk janë aq përfshirës sa infaku. Me një shprehje tjetër, zekat quajmë dhënien për hir të Allahut e cila është farz, asaj që është nafile i themi sadaka, ndërsa të gjitha këto së bashku i quajmë infak. Infaku përfshin edhe atë që është farz edhe atë që është nafile. Infaku farz është disa llojesh.

I pari, është zekati. Në ajetin: “Ata që grumbullojnë ar e argjend dhe nuk e shpenzojnë për hir të Allahut, paralajmëroji me dënim të dhimbshëm.”⁹ Me fjalën infak synohet zekati, i cili është farz.

I dyti, përfshin shpenzimet që njeriu bën për vete e për ata ndaj të cilëve është përgjegjës në lidhje me sigurimin e jetesës. Në një hadith fisnik i cili transmetohet nga Ebu Hurejre (r.a.), Pejgamberi ynë i Nderuar thotë: “Dinari që ka më shumë sevape nga dinari që ke harxhuar në rrugë të Allahut, nga dinari që e ke harxhuar për të liruar një rob, nga dinari që ia ke dhënë sadaka një të varfëri dhe nga dinari që e ke harxhuar për të afërmit, është ai që ke harxhuar për pjesëtarët e familjes.”

I treti, përmban shpenzimet që bëhen për të luftuar në rrugë të Allahut dhe për të mbrojtur atdheun nga armiku. Për këtë çështje flitet në ajetin “Shpenzoheni

5. Surja Hûd, 11/6.

6. Muslim, Zekat, 36.

7. Ahmed, Musned, II, 160.

8. Ahmed, Musned, II, 165, 219.

9. Surja et-Teube, 9/34.

pasurinë në rrugën e Allahut dhe mos e çoni veten tuaj në shkatërrim, por bëni të mira; Allahu me të vërtetë i do bamirësit.”¹⁰, si dhe në ajete të ngjashme me këtë.

Siç e përmendëm më sipër, edhe ato që jepen si nafile quhen infak, sepse Zoti i madhëruar thotë: “Jepni prej atyre mirësive që ju kam dhënë Unë, para se t’i vijë vdekja ndonjërit, e ai të thotë: “O Zoti im, sikur të më kishe lënë edhe një kohë të shkurtër në jetë, do të kisha dhënë lëmoshë dhe do të bëhesha ndër të mirët!”¹¹ Siç shihet, infaku dhe sadakaja përmenden bashkë në ajet.

Faktikisht, infaku është një formë ndihme që jepet jo vetëm me para, por edhe nëpërmjet çdo mirësie prej së cilës përfitojnë edhe të tjerët. Kjo është edhe arsyeja për të cilën ajetin: “Japin nga ato që u kemi dhënë Ne”, disa dijetarë e komentojnë në formën: “Ata u mësojnë të tjerëve nga ato që u kemi mësuar Ne”.¹²


DOBITË E INFAKUT

a- Sido që të jetë, infaku e shpëton njeriun nga koprracia dhe e shpie atë drejt bujarisë. Koprracët nuk i do askush, ndërsa njerëzit bujarë i do edhe Allahu edhe njerëzit.

b- Infaku zhvillon ndjenjën e ndihmës reciproke në shoqëri, ndjenjën e solidaritetit, të vëllazërisë, të dashurisë dhe të respektit.

c- Infaku mundëson lindjen dhe aktivizimin e shumë shërbimeve të ndryshme në dobi të shoqërisë, siguron gjithashtu vazhdimësinë e ekzistencës së institucioneve dhe shërbimeve të ndryshme publike si xhami, shkolla, spitale, rrugë, ujësjellësa etj. Po ashtu ndihmon organizimin e shërbimeve shëndetësore, sociale dhe kulturore, të cilat shteti nuk mund t’i bëjë apo të arrijë t’i bëjë.

d- Infaku është domosdoshmëria e falënderimit për mirësinë. Edhe ndaj mirësisë së pasurisë ekziston një lloj falënderimi, i cili është i detyrueshëm. Ky falënderim realizohet me infak, pra duke e harxhuar pasurinë në rrugë të hajrit, sepse falënderimi për çdo mirësi bëhet duke e përdorur atë siç ka urdhëruar Allahu i madhëruar.



e- Dhënia është cilësi e të devotshmëve dhe e robërve të mirë të Allahut. (shih. El-Bekare, 3) Robërit e mirë të Allahut janë ata që përpiqen të plotësojnë nevojat e njerëzve dhe të zgjidhin hallet e tyre. Pejgamberi ynë i dashur ka thënë: “Kur Allahu dëshiron të mirën e një robi, e bën atë të aftë për të ndihmuar njerëzit në zgjidhjen e halleve të tyre.”¹³

f- Së fundi, mund të themi se çdo gjë që ne japim në vende dhe shërbime të dobishme, është e jona, ndërsa ajo gjë që nuk mund ta japim nuk është e jona, sepse gjërat që do të na sigurojnë shpëtimin në jetën e amshueshme janë veprat e mira dhe mirësitë që kemi bërë në këtë jetë. Njeriu mund të japë vetëm atë që ka, ndërsa atë që nuk e ka nuk mund ta japë. Nëse nuk mund të japim atë që kemi, atëherë duhet të dimë se ne nuk jemi pronarët dhe administruesit e pasurisë, por thjesht të sunduar prej saj. Kjo do të thotë se nuk jemi ne ata që e sundojmë pasurinë, por është ajo që na sundon neve. Le t’i kërkojmë mbrojtje Allahut për të mos rënë në një gjendje të tillë.

10. Surja Bakare, 2/195.

11. Surja el-Munafikun, 63/10.

12. Kurtubi, I, 179.

13. Nebhani, el-Fet’hu’l-Kebir, I, 76.



Harun Jahja

RRËFENJA E SALIHUT (A.S.) NË KURAN

SALIHU (A.S.) ISHTE DËRGUAR PEJGAMBER TEK POPULLI I THEMUDIT

Ne i dërguam fisit të Themudit, vëllanë e tij Salihun. Ai tha: “Adhuroni Allahun!” Por ata u ndanë në dy grupe, që grindeshin midis tyre. (Neml, 45)

Ndërsa fisit Themud Ne i dërguam vëllanë e tyre, Salihun... (A'rafë, 73)

THIRRJA NË BESIMIN E ALLAHUT

Ndërsa fisit Themud Ne i dërguam vëllanë e tyre, Salihun. Ai tha: “O populli im! Adhuroni Allahun, ju nuk keni zot tjetër përveç Tij. Në të vërtetë, juve ju është dhënë një shenjë e qartë nga Zoti juaj: kjo deve e Allahut për ju është një mrekulli. Lëre-ni të kullojë në tokën e Allahut dhe mos i bëni ndonjë të keqe, se ju pret ndëshkimi i ashpër!” (A'rafë, 73)

Fisit Themud (Ne i dërguam) vëllanë e tij, Salihun. “O populli im”, - u tha ai - “adhuroni vetëm Allahun. Ju s'keni zot tjetër përveç Atij! Ai ju krijoi nga toka dhe ju vuri të jetoni në të; andaj, kërkon falje nga Ai dhe kthehuni me pendim tek Ai! Pa dyshim, Zoti im është afër dhe u përgjigjet (lutjeve).” (Hudë, 61)

Dhe sillni në mend, kur Ai ju bëri zëvendës pas fisit Ad dhe ju dhuroi vendbanime në Tokë; në rrafshinat e saj po ngrini pallate e në kodrina po gdhendni shtëpi. Kujtoni të mirat e Allahut dhe mos bëni çrregullime në tokë!” (A'rafë, 74)

Në të vërtetë, Zoti yt është i Plotfuqishëm dhe Mëshirëplotë. Edhe fisi Themud i quante gënjeshtarë të dërguarit. Kujto kur vëllai i tyre, Salihu, u tha: “Vallë, a nuk i frikësoheni ju Allahut? Pa dyshim, unë jam një i dërguar i besuar për ju, andaj, frikësojuni Allahut dhe bindmuni mua! Për këtë, unë nuk kërkoj nga ju kurrfarë shpërblimi, mua do të më shpërblejë vetëm Zoti i botëve. Vallë, a mendoni ju, se do të mbeteni këtu të sigurt, në kopshtije e pranë burimeve, në ara më të lashta dhe palma hurmash me fruta të shijshme? Ju i gdhendni shtëpitë në male me mjeshtri të rrallë, andaj, frikësojuni Allahut dhe bindmuni mua.” (Shuaraë, 140-150)

POPULLI I THEMUDIT E PËRGËNJESHTRON THIRRJEN E SALIHUT (A.S.)

Fisi i Themudit, nga shfrenimi i vet - përgënjeshtroi. (Shems, 11)

Ata thanë: “O Salih! Ti ke qenë i nderuar mes nesh dhe shpre-

sa jonë para kësaj (fjale). A mos vallë po na ndalon ta adhurojmë ato që i kanë adhuruar prindërit tanë? Vërtet, ne jemi në mëdyshje për thirrjen tënde.” (**Hudë, 62**)

Por paria arrogante e popullit të tij u tha të shtypurve në radhët atyre që kishin besuar: “A e pranoni që Salihu është i dërguar nga Zoti i tij?” Ata thanë: “Sigurisht që ne besojmë në gjithçka që i është shpallur atij”. Ata që ishin kryelartë, thanë: “Ne nuk besojmë në atë që besoni ju”. (**A'rafë, 75-76**)

Edhe fisi Themud i përgënjeshtroi paralajmërimet Tona. Ata (themudasit) thanë: “Vallë, a të ndjekim një njeri nga mesi ynë? Atëherë do të ishim vërtet në rrugë të humbur dhe të çmendur. Pra, nën mbikqyrjen dhe kujdesin Tonë. Përmbytjen e popullit të Nuhut. Vallë, vetëm atij mes nesh t'i dërgohet Shpallja? Jo, ai është gënjeshtar mendjemadh!” (Të dërguarit iu tha): “Nesër do ta marrin vesh ata se, kush është gënjeshtari mendjemadh!” (**Kamer, 23-26**)

SPROVIMI I POPULLIT TË SALIHUT (A.S.) ME DEVE

Ai tha: “O populli im, mendoni pak! Nëse Zoti im më ka dhënë provë të qartë nga Vetja dhe mëshirë, kush do të më mbrojë nga dënimi i Allahut, nëse nuk e dëgjoj?! Ju (me këtë) mua do të më shtonit vetëm humbjen. O populli im! Kjo është deveja e Allahut,* shenjë e qartë për ju, prandaj lëreni të kullosë në tokën e Allahut dhe mos i bëni ndonjë të keqe, se ju godet ndëshkimi menjëherë.” (**Hudë, 63-64**)

Ai tha: “Ja, kjo është një deve. Ajo do të ketë radhën e saj për të pirë, ashtu si edhe ju, në ditë të caktuara. Mos i bëni kurrfarë të keqeje asaj, se do t'ju godasë dënimi i një Dite të madhe!” (**Shuaraë, 155-156**)

Ne po u dërgojmë devenë* për t'i sprovuar, andaj ti (o Salih) priti ata dhe bëhu i durueshëm! Dhe lajmëroji ata se uji do të ndahet ndërmjet tyre e devesë dhe çdo vakt do të shihet me rend!” Por ata thirrën shokun e tyre, i cili e mori dhe e theri. (**Kamer, 27-29**)

Kur u ngrit më i keqi i tij (për të therur devenë). I dërguari i Allahut (Salihu), u tha atyre: “Kjo është deveja e Allahut! Lëreni atë të pijë pjesën e vet!” (**Shems, 12-13**)

MBYTJA E DEVESË NGA ANA E POPULLIT

Por ata nuk i besuan atij dhe e therën atë. Prandaj Zoti i tyre i shkatërroi të gjithë për gjynahet e tyre, nga i pari tek i fundit. (**Shems, 14**)

E megjithatë, ata e therën atë, e ai (Salihu) ju tha: “Përjetoni në vendin tuaj tri ditë, ky është caktim jo i rrejshëm!” (**Hudë, 65**)

Por ata e therën e pastaj u erdhi keq. (**Shuaraë, 157**)

(Salihu) tha: “O populli im, përse ju e dëshironi të keqen para

së mirës?! Përse nuk kërkonin nga Allahu falje (të gjynaheve) që të mund të mëshiroheni?!” Ata thanë: “Ne kemi ogur të keq prej teje dhe atyre që janë me ty”. Ai u tha: “E mira dhe e keqja është prej Allahut. Në të vërtetë, ju jeni popull i vënë në sprovë”. (**Neml, 46-47**)

KRYELARTËSIA E POPULLIT

Në qytet kishin qenë nëntë vetë që bënë ngatërresa e nuk vinin rregull. Ata i thanë (njëri-tjetrit): “Betohuni në Allahun se natën do ta vrasim atë me gjithë familjen e tij. Pastaj do t'u themi të afërmeve të tij se ne nuk kemi qenë të pranishëm në zhdukjen e familjes së tij dhe se po themi të vërtetën.” (**Neml, 48-49**)

Kështu, ata e therën devenë pa e përfillur urdhrin e Zotit të tyre dhe thanë: “O Salih, sillna atë që na ke premtuar, nëse je vërtet i dërguar!” Për këtë arsye ata i goditi një tërmet i rëndë në mëngjes dhe mbetën të vdekur në shtëpitë e tyre. Ai u largua prej tyre dhe tha: “O populli im! Unë ju solla mesazhin e Zotit tim dhe ju këshillova, por ju nuk i donit ata që këshillojnë”. (**A'rafë, 77-79**)

SHKATËRRIMI I POPULLIT TË THEMUDIT

Por ata thirrën shokun e tyre, i cili e mori dhe e theri. Eh, sa i tmerrshëm qe dënimi Im pas paralajmërimeve të Mia! Ne dërguam mbi ta një ulurimë të vetme e ata u bënë si sana e copëtuat në pleme. (**Kamer, 29-31**)

Sikur nuk kishin jetuar kurrë në to. Me të vërtetë, fisi Themud mohoi Zotin e tij. Qoftë larguar (nga mëshira e Zotit) fisi Themud! (**Hudë, 68**)

Por edhe ata në agim i goditi zëri i tmerrshëm. (**Hixhr, 83**)

Dhe kështu, ata i goditi dënimi. Njëmend, në këtë ka këshillë, por shumica e njerëzve nuk janë besimtarë. (**Shuaraë, 158**)

Tani shiko se si ka qenë fundi i ngatërresave të tyre. Ne i shkatërroam ata të gjithë dhe popullin e tyre. Ja shtëpitë e tyre të rrënuara, për shkak të këqijave që bënë. Sigurisht që këtu ka këshillë për njerëzit që dinë. (**Neml, 51-52**)

Dhe nuk patën aspak dobi nga ajo që patën ndërtuar. (**Hixhr, 84**)

Por ata nuk i besuan atij dhe e therën atë. Prandaj Zoti i tyre

i shkatërroi të gjithë për gjynahet e tyre, nga i pari tek i fundit. (**Shems, 14**)

Ja shtëpitë e tyre të rrënuara, për shkak të këqijave që bënë. Sigurisht që këtu ka këshillë për njerëzit që dinë. Ndërsa, ata që kishin besuar dhe (i) frikësoheshin (Allahut), Ne i shpëtuam. (**Neml, 52-53**)

Ramazani

muaji i Kuranit

dhe i devotshmërisë

Mr. Abdulkader Durguti

Allahu (xh.sh.) në Kuran i dalloi në mënyrë të posaçme disa vende dhe kohëra, duke i cilësuar si më të shenjtë nga të tjerat. Ky vlerësim është bërë për shkak të shenjtërisë që Allahu u dhuroi këtyre kohërave dhe vendeve. Pas ndonjë ngjarje historike, vendi apo koha fitojnë këtë shenjtëri nga Allahu, që më pas vlen të përkujtohet në agjendën tonë. Këto lloj vlerësimesh dhe dallimesh, Allahu i përmend në suren Kasas, ajeti 68, kur thotë: **“Zoti yt krijon ç’të dojë dhe zgjedh lirisht, ndërsa ata (idhujt) nuk mund të zgjedhin”**.

Allahu dërgoi peygamberët duke i bërë të dalluar nga njerëzit e tjerë.¹ Edhe vendet ku filloi shpallja i vlerëson si të shenjtë dhe të dalluara nga vendet e tjera.² Po ashtu, Allahu (xh.sh.) i dalloi disa netë nga disa të tjera për shkak të ngjarjeve që ndodhën, për përgjigjen e lutjeve dhe zbritjen e mëshirës e të bekimit të Allahut në ato netë, siç është për shembull Nata e Kadrit, për të cilën Allahu thotë **“Nata e Kadrit është më e mirë se njëmijë muaj”**.³

RAMAZANI MUAJI I SHENJTË

E drejta absolute e shenjtërisë i takon vetëm Allahut (xh.sh.). Prandaj Allahu e shenjtëroi muajin e Ramazanit me vlerën e zbritjes së Kuranit, duke e përkufizuar këtë muaj kështu: **“Muaji i Ramazanit është ai, në të cilin ka zbritur Kurani, që është udhërrëfyes për**

njerëzit, plot me shenja të qarta për rrugën e drejtë dhe dallues (i së mirës nga e keqja)”.⁴

Fakt është se Ramazani është muaji i lindjes së Kuranit, ndërsa ditëlindja e tij është Nata e Kadri, e cila është brenda këtij muajit të shenjtë. Kjo vërehet haptas në ajetin e lartpërmendur dhe në ajetin e parë të sures Kadr, **“Ne e kemi zbritur (Kuranin) në Natën e Kadrit.”**⁵, por gjithashtu edhe në suren Duhan ku thotë: **“Ne e zbritëm Kuranin në një natë të bekuar.”**⁶ Kjo do të thotë se po të mos ishte Nata e Kadrit në Ramazan, as muaji i Ramazanit nuk do ta përfitonte shenjtërinë, mëshirën edhe bekimin e Allahut. Prandaj Ramazani quhet muaji i Kuranit dhe ka lidhje të ngushtë me të, duke qenë se është edhe muaji i lindjes së Kuranit.

Për ta vërtetuar vlerën absolute të natës së fillimit të shpalljes, Kurani e bën atë më të vlefshme se edhe njëmijë muaj, vite apo dekada, kohëzgjatje, të cilën njeriu nuk mund ta përjetojë gjatë tërë jetës së tij. Ky vlerësim i mrekullueshëm, na bën të kuptojmë se **“Nata e fillimit të shpalljes së Kuranit është e vlefshme sa një jetë; në qoftë se zbret në jetën time, çdo ditë e jetës sime është e vlefshme sa një jetë”**. Pra, shkak i shenjtërisë dhe i bekimit nuk është koha, por shpallja. Me fillimin e shpalljes së Kuranit fillon edhe shenjtëria e Ramazanit.

1. Ali Imran, 2/33, Araf, 7/144.

2. Taha, 20/11-13.

3. Kadr, 97/3.

4. Bekare, 2/185.

5. Kadr, 97/1.


6. Duhan, 44/3.

QËLLIMI FINAL I AGJËRIMIT: DEVOTSHMËRIA

Në rendin e parë të karakteristikave të muajit Ramazan vjen agjërimi, i cili vijon gjatë tërë këtij muajit. ***“O ju që besuat, agjërimi u është bërë obligim sikurse ishte obligim edhe i atyre që ishin para jush, kështu që të bëheni të devotshëm.”***⁷ Veçori tjetër e muajit të Ramazanit është se, me udhëzimin e Kuranit ky muaj është udhërrëfyes në rrugën e shpëtimit, dallues nga të mirat dhe të këqijat.⁸

Sipas konceptit të ajetit të lartpërmendur nënkuptojmë se agjërimi është një prej adhurimeve që në mënyrë të mirëfilltë e shpie njeriun nga udhëzimi apo përmirësimi i vlerave morale. Po ashtu, agjërimi është mjet sipëror, i cili ndikon që njeriu ta rrit devotshmërinë e tij. Është fakt se njeriu e fiton dashurinë dhe bekimin e Allahut me agjërim, sepse gjatë agjëritit zemra e njeriu është e mbyllur ndaj kryengritjes, apo së paku zvogëlohen mundësitë për të kundërshtuar apo për të bërë kryengritje ndaj urdhrave të Allahut. Si rrjedhojë, ndjenjat fillojnë ta përfitojnë devotshmërinë. Njeriu, pasi të fitojë udhëzimin dhe dashurinë e këtij muaji, mund të përfitojë dhe të shijojë dashurinë për gjithë jetën, mund të fitojë forcë për t’u përballur me rreziqet që mund t’i kanosen gjatë jetës, sepse në krahasim me muajt e tjerë, në këtë muaj zemra e njeriut gjendet në pozitën e devotshmërisë më të lartë. Në këtë muaj rritet devotshmëria, ndërsa zemra freskohet dhe merr vlerë sublimë.

Gjatë këtij muaji besimtari e mbron shpirtin, duke e mbajtur larg preokupimeve të kësaj bote. Ai ndihet i vetëdijshëm se është i obliguar me një adhurim specifik dhe dobisë e këtij adhurimi janë të shumta e të jashtëzakonshme. Sa për ilustrim, mund të marrim shembullin e përpjekjeve të një njeriu të devotshëm. Duke e filluar dhe mbaruar agjërimin me emrin e Allahut, ai nuk bën gjë tjetër përveç asaj që Allahu ka urdhëruar, duke i mbrojtur gjymtyrët e tij nga ndonjë zhytje e ndaluar e të papëlqyer nga Allahu. Ai vazhdon të ushqyerit e shpirtit gjatë ditës me agjërim, ndërsa gjatë natës me adhurime të ndryshme, si me namaz të teravis, namaz nate, me këndim të Kuranit etj. Duke vazhduar kështu deri në përfundim të muajit të bekuar, ai shijon freskinë e zemrës dhe ndien rritjen e devotshmërisë së tij. Sepse qëllimi i agjëritit është edukimi shpirtëror dhe një metodë e arritjes së devotshmërisë së lartë njerëzore. Ashtu siç është për-



mendur edhe më lart në ajetin ***që të bëheni të devotshëm***, i cili nënkupton përkushtim të plotë moral për arritjen e devotshmërisë shpirtërore.

Ashtu siç u cek edhe në ajetin e më sipërm, sipas të cilit agjërimi është obligim specifik që u është kështuar besimtarëve vetëm e vetëm që ata të rrisin devotshmërinë e tyre, sepse çdo lloj adhurimi i është caktuar masa më e ulët dhe masa më e lartë e shpërblimeve, përveç agjëritit që ka kulmin e shpërblimeve, sepse agjërimi është për Allahun, kështu që vetëm Allahu mund ta shpërblejë besimtarin për meritën e tij. Kjo është një prej karakteristikave kryesore të agjëritit, ngase ky është një adhurim që nuk ka vend për hipokrizi dhe shtirje⁹, kurse tek adhurimet e tjera njeriu mund të tregojë shtirje dhe hipokrizi. Prandaj, gjatë tërë historisë nuk dihet që idhujtarët të kenë agjëruar ndonjë herë për t’iu afruar zotave të tyre. Idhujtarët nuk i kanë adhuruar asnjëherë me agjërim zotat e tyre. Ky adhurim ishte obligim edhe gjatë historisë, vetëm e vetëm që njeriu t’i afrohet Allahut e të arrijë pëlqimin e Tij.

7. Bekare, 2/183.

8. Bekare, 2/185.

9. Buhari, *Savm*, 9; Muslim *Siyam*, 163.



Një Ajet

Me emrin e Allahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirplotit!

O besimtarë! Ju është urdhëruar agjërimi, ashtu si u ishte urdhëruar atyre para jush, që të mund të ruheni nga të këqijat. Agjërimi zgjat disa ditë, por nëse ndonjëri prej jush është i sëmurë ose duke udhëtuar, le të agjërojë aq ditë sa i ka prishur në ditët e tjera pas. Ata që kanë vështirësi për të agjëruar, duhet të ushqejnë si shpagim nga një të varfër për çdo ditë agjërimi. E, nëse ndonjëri jep më shumë se kaq, kjo është edhe më mirë për të. Por, agjërimi juaj është më i dobishëm, në qoftë se e dini.

Muaji i Ramazanit është ai, në të cilin ka zbritur Kurani, që është udhërrëfyes për njerëzit, plot me shenja të qarta për rrugën e drejtë dhe dallues (i së mirës nga e keqja). Pra, kushdo nga ju që dëshmon këtë muaj, le të agjërojë! Sa i përket atij që është i sëmurë ose gjendet në udhëtim e sipër (le të agjërojë më vonë) aq ditë sa nuk i ka agjëruar. Allahu dëshiron që t'jua lehtësojë dhe jo që t'jua vështirësojë. Ai dëshiron që të plotësoni numrin e ditëve të agjërimin dhe që ta madhëroni Allahun (në fund të agjërimin), për shkak se ju ka drejtuar në rrugë të drejtë e që ta falënderoni Atë. (El Bekare 183-185)

Agjërimi është një ndër shtyllat themelore të fesë Islame. Ai edhe pse në forma dhe kohë të ndryshme i është bërë obligim edhe popujve të mëparshëm. Agjërimi është një urdhër hyjnor që ka shumë dobi, por që e lodhë dhe e bën të vuajë shumë egon e njeriut. Kjo është edhe arsyeja që në fillim është bërë obligim adhurimi më i lehtë namazi, pastaj zekati, si një adhurim i një vështirësie të mesme, e pastaj adhurimi më i vështirë, agjërimi. Kështu njeriu, që ka hyrë në moshën e pjekurisë, mësohet me adhurimet në mënyrë graduale, nga ai më i lehti e deri tek ai më i vështiri.

Agjërimi është bërë farz një vit e gjysëm pas hixhretit, emigrimit për në Medine, në muajin Shaban. Në ajetin e mësipërm theksohet fakti se agjërimi si një adhurim i vështirë nuk i është bërë farz vetëm myslimanëve, por edhe popujve të tjerë që kanë ardhur më përpara, gjithashtu theksohet fakti se agjërimi është një adhurim, obligueshmëria e të cilit ka burim hyjnor. Fjala agjërim sipas kuptimeve të saj në fjalor do të thotë të mbash veten larg prirjeve të natyrshme të egos, pra të përmbahesh. Kurse kuptimi i kësaj fjale sipas terminologjisë islame është të përmbahesh gjatë tërës së ditës nga pirja, ngrënia dhe marrëdhëniet seksuale. Pjesa e ajetit “...që të mund të ruheni.” është në kuptimin që të mund të fitoni aftësinë e ushtrimit të kontrollit mbi egon tuaj e duke u vetëpërmbajtur nga gjynahet të arrini devotshmërinë.

Urtësia e të bërit farz të agjërimin është të përluritur para urdhërit të Allahut e kështu të shijuarit e kënaqësisë që të jep robnia vetëm ndaj Tij gjithashtu të luftosh me egon tënde, t'ia dorëzosh Allahut qënien tënde duke e rritur sinqeritetin ndaj Tij dhe duke u pastruar nga sëmundjet shpirtërore të hipokrizisë dhe dëshirës për t'u dukur.

Agjërimi mbahet në muajin e shenjtë të Ramazanit. Ramazani është muaji në të cilin filloi të zbrisë udhërrëfyesi i jetës sonë, Kurani i madhërueshëm. Ditët që i janë përcaktuar muajit të Ramazanit janë pikërisht këto ditë të përndritura. Ai që i arrin këto ditë duke qenë mirë me shëndet dhe duke mos qenë udhëtarë duhet të agjërojë. Të sëmurëve dhe udhëtarëve, ditët që nuk i agjërojnë dot gjatë këtij muaji u është dhënë privilegji për t'i zëvendësuar ato gjatë muajve të tjerë në vazhdim. Kjo, sepse Zoti dëshiron për ne më të lehtën dhe jo të vështirën...

Një Hadith



Transmetohet nga Ebu Hurejra radijallahu se

Resulullaku sallallahu alejhi ve sellem dhe i kanë thënë:

Allahu i Lartmadhëruar ka thënë: “Çdo vepër e besimtarit përveç agjërimit është për veten e tij. Agjërimi është për Mua, dhe shpërblimin do ta jap vetëm Unë.”

“Agjërimi është mburojë. Secili prej jush kur të jetë agjërueshëm të mos thotë asnjë fjalë të keqe dhe të mos grindet me askënd. Në qoftë se dikush e fyen apo e provokon për të shkaktuar grindje le t’i thotë: ‘Unë jam agjërueshëm’.”

“Betohem në Allahun, në dorën e të Cilit është shpirti i Muhamedit, se tek Allahu era e gojës së besimtarit është më e mirë se era e miskut.”

“Agjëruesi ka dy çaste të forta lumturie: I pari është në kohën e yftarit, ndërsa tjetri çast është ai i të dalurit të tij para Allahut me sevabin e e agjërimit.” (Buhariu, Savm 9; Muslim, Sijam 163)

Një transmetim tjetër i Buhariut është kështu: Allahu ka thënë: “Agjëruesi braktis për hatrin Tim ushqyerjen, pirjen dhe dëshirat e tij seksuale. Agjërimi është një adhurim që bëhet vetëm për Mua. Për mirësitë e tjera shpërblimi dhjetëfishohet ndërsa shpërblimin e agjërimit do ta jap Unë aq sa të dëshiroj.”

Sipas një transmetimi të Muslimit Pejgamberi (a.s.) është shprehur kështu:

“Për çdo vepër të mirë ka shumë sevape. Për çdo vepër të mirë shpërblimi në lidhje me të fillon nga dhjetë e deri në shtatëqind sevape. Allahu ka thënë: Për agjërimin çështja ndryshon. Ai është për Mua, dhe shpërblimin do ta jap vetëm Unë. Agjëruesi e braktis epshin dhe të ushqyerin e tij për hatrin Tim.”

“Për agjëruesin ka dy lumturi: Njëra është lumturia e yftarit dhe tjetra lumturia e të dalurit para Allahut me sevapet e agjërimit. Sigurisht që për Allahun era e gojës së agjëruesit është më e mirë sesa era e miskut.”

Mësimet që nxjerrim nga hadithi:

1. Agjërimi është i vetmi adhurim për të cilin Allahu i Lartmadhëruar është shprehur “Shpërblimin e agjërimit do ta jap vetëm Unë”.
2. Asnjë sakrificë apo vepër që bëhet për Allahun nuk do të mbesë pa u shpërblyer.
3. Agjëruesi është një besimtarë i pajisur me veshje mbrojtëse kundër gjynaheve dhe zjarrit të xhehenemit. Kjo sepse “Agjërimi është mburojë”.

SINQERITETI NË DHURIM

Shlasi është sinqeriteti në robëri dhe pastërtia në qëllim. Takvaja dhe Ihlas janë dy anët e fshehta të robërisë, të cilat nuk ndahen nga njëra tjetra, ashtu si dy forma të ndryshme shprehjeje që synojnë të përcjellin të njëjtin mendim. Ih-lasi është takimi i njeriut në zemrën e tij me Krijuesin, ose thënë ndryshe shpërfaqja në zemër e cilësive të bukura të Allahut, si: mëshira, dhembshuria, falja, qetësia shpirtërore, si dhe e cilësive tjera të bukura. Ih-lasi është të kërkuarit e pëlqimit të Allahut në çdo gjendje, në çdo veprim, madje në çdo frymëmarrje.

Kur zemra e njeriut zhvishet nga sinqeriteti, atëherë njeriu i dorëzohet tërësisht interesave të egos së tij. Fundi i këtij udhëtimi nëpër shtigjet e interesave të egos përbën të robëruarit ndaj diçkaje tjetër përveç Zotit, të paktën me zemër. Në një ajet kuranor thuhet:

“A e ke parë ti atë, që epshin e vet e ka marrë për zot? A do t’i bëhesh mbrojtës atij?” (el-Furkan, 25/ 43)

Në lidhje me mungesën e ihlasit në veprimet e njeriut, Hazreti Pejgamberi (s.a.v.s.) shprehet:

“Më shumë, në lidhje me umetin tim, më frikëson shirk-u. Me fjalën shirk nuk nënkuptoj adhurimin e hënës, të diellit apo adhurimin e idhujve, por kam parasysh çdo veprë që bëhet për çdo qëllim tjetër përveçse për të fituar kënaqësinë e Allahut, dhe egon e fshehtë (dëshira për t’u shfaqur e dukur).” (Ibn Maxhe, Zuhd, 21)

Për këtë arsye, të gjitha adhurimet që nuk kryhen për të fituar kënaqësinë e Zotit, por për servilizëm e për t’u dukur, ngjajnë me një gjeometri të thatë e të zbrazur, janë vepra, mirësia e të cilave është shkatërruar. Jo më kot në një hadith profetik thuhet:

“Veprat shpërblehen sipas qëllimit...” (Buhari, Iman, 41)

Kështu, Sinqeriteti në Dhurim është dhënia vetëm e vetëm për hir të Allahut, duke pasur si qëllim vetëm kënaqësinë e Tij, duke menduar se je duke ia blatur këtë dhuratë Lartmadhërisë së Tij.

Hazreti Pejgamberi (s.a.v.s.) ka thënë:

“Çdo sadaka (lëmoshë) që jepet nga malli hallall, është Allahu i Gjithëmëshirshëm që e merr me dorën e tij duke e pranuar.”

“S’ka asnjë dyshim që sadakaja (lëmosha) kalon në dorën e Allahut pa kaluar ende në dorën e nevojtarit.” (Munavi, Kunudhul Hakaik, fq. 34)

Gjatë aktit të dhurimit ne kemi të bëjmë drejtpërsëdrejti me Allahun e Lartmadhëruar, arsye për të cilën duhet të tregohemi të kujdesshëm dhe të jemi në një gjendje të lartë shpirtërore. Duhet të arrijmë të japim e të dhu-

**"Çdo sadaka (lëmoshë)
që jepet nga malli hallall,
është Allahu i Gjithëmëshirshëm
që e merr me dorën e tij
duke e pranuar."**

rojmë, duke thënë "O zoti im, vetëm e vetëm për Ty", pa pritur asnjë lloj komplimenti apo urimi nga qeniet e përkohshme (njerëzit), duke qëndruar larg dëshirës për t'u dukur, larg dëshirës për famë, pa u pushtuar nga nefsia dhe pa pasur kurrfarë qëllimi tjetër tokësor. Kjo përbën gjënë më thelbësore në ihsasin e dhurimit.

SHENJA E IHLASIT: TË MUND TË GJESH NEVOJTARIN E VËRTETË

Të përpiqesh t'i japësh sadakanë atij që e meriton, është një kusht i rëndësishëm i dhurimit. Pra, ideja nuk është të jepet në mënyrë të pakujdesshme duke neglizhuar interesimin se kujt i jepet zekati. Në ajetin kuranor: **"Ata që bëjnë përpjekje për të dhënë zekatin"** theksohet rëndësia që ka dhënia e zekatit me vetëdijen e adhurimit, gjithnjë duke u përpjekur të gjejmë personin që e meriton atë ndihmë.

Ashtu siç tregohemi të kujdesshëm në rastin kur dëshirojmë të blejmë diçka për vete, të njëjtin interesim duhet të shfaqim edhe në lidhje me kujdesin që amane-ti i të Madhit të shkojë tek i zoti, duke treguar përkushtim kohor dhe energji. Dhurimi është tregti shpirtërore nëpërmjet së cilës, duke dhënë një pjesë nga begatitë e kësaj jete të përkohshme, të cilat edhe ato janë dhuruar nga Allahu, të mund të blejmë mirësitë e botës tjetër, që është e përhershme. Përmbytja e kësaj tregtie në mënyrën sa më të mirë të mundshme lidhet në mënyrë të drejtpërdrejtë me kërkimin dhe gjetjen e nevojtarit të vërtetë. Gjithashtu, kjo tregon edhe nivelin e lartë të ihsanit që ka në zemër ai që dëshiron të dhurojë diçka për hir të Allahut.

Në një ajet kuranor thuhet:

"(Lëmosha) u takon të varfërve, të cilët kanë hyrë në rrugën e Zotit e nuk janë në gjendje të udhëtojnë (për

të fituar). Kush nuk i njeh ata, kujton se janë të kamur, për shkak se ata nuk lypin. Do t'i njohësh nga pamja e tyre..." (surja el-Bekare, 2/273)

Kur lëmosha është e sinqertë, tek njeriu lind dhe zhvillohet një aftësi shpirtërore për ta njohur në fytyrë nevojtarin që e meriton shumën që i është lënë amanet për t'ia dhënë atij.

Në një hadith, Hazreti Pejgamberi (s.a.v.s.) ka thënë:


"I varfër i vërtetë është ai, i cili edhe pse nuk zotëron të ardhurat të mjaftueshme për të mbuluar nevojat e tij të domosdoshme, edhe pse nuk e ndihmon askush nga ata që ia dinë hallin, prapëseprapë nuk del të lypë e të kërkojë nga njerëzit e tjerë." (Buhari, Zekat, 53)

Duke u frymëzuar nga këto të vërteta, Hazreti Emir Kylali e këshillon kë-shtu nxënësin e tij, Hazreti Bahaiddin Nakshibendiun:

Shiko të lumturosh ndonjë zemër, bëju hyzmeqar i të dobtëve! Mbroji të dobtit dhe ata që e kanë zemrën e thyer! Ata janë njerëz të atillë, që edhe pse nuk kanë asnjë të ardhur nga populli, prapëseprapë e shtyjnë jetën me qetësi shpirtërore, me modesti dhe shqetësim. Kërkoji dhe gjeji ata!

Ja pra, virtyti i vërtetë është të mund të mbash në dorën tënde një nevojtar të tillë. Në ajetin e mësipërm, Allahu urdhëron që t'i gjejmë këta besimtarë të devotshëm të cilët e fshehin nga turpi gjendjen e tyre të keqe ekonomike; gjithashtu, na urdhëron ta kultivojmë zemrën deri në atë masë sa të arrijmë t'i njohim këto njerëz që nga pamja e jashtme. Sigurisht, ky nivel shpirtëror arrihet nëpërmjet fitimit hallall të të ardhurave dhe nga sinqeriteti që ke në zemër.

Dhurimi i bërë me gjithë shpirt, duke pasur si qëllim



vetëm fitimin e kënaqësisë së Allahut nga pasuria hallall, me ndihmën e Zotit nuk shkon dëm por arrin tek nevojtarët e vërtetë.

Ndërsa kur ndihmohet një person që i është përkushtuar rrugës së Allahut, kjo është më e vlefshme se ndihma që mund t'i bëhet njëqind personave. Me përkushtimin që ka ndaj Allahut, ai nuk do të shpenzojë kot as edhe një qindarkë.

Hazreti Pejgamberi (s.a.v.s.) shfaqte interesim të veçantë ndaj "as'habu suffe", duke i nxitur sahabet e tjerë të kamur që të kontribuonin me mundësitë e tyre ekonomike për plotësimin e nevojave të domosdoshme të "ashab-i suffe", të cilët i ishin përkushtuar tërësisht njohjes së Islamit.

Gjithashtu, sa i takon rëndësisë që ka kujdesi që duhet të tregojmë në lidhje me gjetjen e nevojtarit të vërtetë e për t'i dhënë atë që është e tij, amanet, i cili na është lënë nga Allahu, Hazreti Mevlana shprehet: *"Çfarë është drejtësia? Është të ujisësh pemë frutore. Çfarë është padrejtësia? Është të ujisësh gjembat..."*

Është e rëndësishme të tregojmë kujdes ndaj infakut, që të mund ta dimë nëse do të gjelbërojnë kopshtet tona të shpirtit apo gjembat e egos e të nefsit tonë.

Vlera e dhurimit (infakut) është në raport të drejtë me masën e hallallit të mallit tonë. Me ndihmën e Zotit, mirësitë që bëhen me mallin hallall shkojnë tek ai që e meriton më shumë atë. Nga ky këndvështrim, infaku është skaneri (rontgeni) shpirtëror i fitimeve (të ardhurave) tona.

Njërin nga miqtë e Allahut, Ebu Abbas Nihavendin, e pati pyetur në lidhje me zekatin një prej nxën-



nësve të tij që merrej me tregti. Ebu Abbas Nihavendi i qe përgjigjur:

"Jepja atij që të thotë zemra!"

Pasi largohet nga mësuesi i tij, nxënësi takon në rrugë një lypsar të verbër. Meqenëse i vjen keq për të, nxjerr nga xhepi një qese me florinj dhe ia jep si zekat. Lypsi i verbër, pasi e kontrollon mirë qesen dhe bindet se ajo është plot e përplot, largohet gjithë gëzim prej aty. Të nesërmen e asaj dite, nxënësi në fjalë kalon në të njëjtën rrugë dhe sheh se i verbëri i djeshëm, të cilit i kishte dhënë zekatin ishte duke folur me një shok të tij, i cili ishte gjithashtu i verbër. Nga biseda që po bënin dy shokët e verbër, atij i zuri veshi këto fjali:

"Dje, një njeri fisnik më dhuroi një qese plot me florinj. Dhe unë shkova në mejhane dhe piva për qejfin tim..."

Kjo gjë e mërzi shumë nxënësin. Ai shkoi menjëherë tek Hazreti Ebu Abbasi. Sapo arriti atje, ende pa filluar t'ia sqarojë mësuesit të vet meselenë, Hazreti Ebu Abbasi kërkoi prej tij që t'i dhuronte personit të parë që do të haste në rrugë një shumë parash, të cilën e kish fituar nga shitja e një qylafi.

Nxënësi largohet menjëherë për të kryer detyrën që i la mësuesi. Ashtu siç qe porositur, shumë e parave ia dhuroi njeriut të parë që takoi në rrugë. Më pas u bë kurioz dhe filloi ta ndjekë atë nga pas. Burri në fjalë hyri në një rrënojë aty afër. Nxori nga rrobat e tij një thellënzë të ngordhur dhe e la aty. Teksa ai po largohej prej aty, nxënësi i doli përpara dhe e pyeti:

- O njeri! Më thuaj çfarë po ndodh, pashë hatrin e Zotit! Çfarë është kjo thellënzë e ngordhur që sapo hodhe këtu?

Kur shikoi parballë njeriun, që pak më parë i kishte

**“Çfarë është drejtësia?
Është të ujisësh pemë frutore.
Çfarë është padrejtësia?
Është të ujisësh gjembat...”**

dhuruar shumë e parave, burri tha me zërin që i dri- dhej nga emocionet:

- Tash shtatë ditë nuk kam mundur të siguroj kurrfarë ushqimi për fëmijët e mi. Unë dhe gruaja po e duronim urinë, por fëmijët nuk ishin në gjendje të duronin më!.. Megjithatë, s'më bëhej të dilja për të lypur. Duke u sjellë andej këndeje me gjithë këtë shqetësim, gjeta në rrugë këtë thëllënzë të ngordhur. Në pamundësi për të siguruar ndonjë ushqim tjetër, mendova ta çoja në shtëpi këtë shpend të ngordhur prej ditësh. Ndërkohë, po i lutesha Allahut me gjithë shpirt: *“O Zoti im, më ndihmo të dal nga kjo gjendje kaq e vështirë!”*. Pastaj, para syve të mi u shfaqe ti. Unë e falenderova Zotin me të gjithë forcën e shpirtit dhe e flaka atë shpend të ngordhur që do të hanim me pahir. Tani do të shkoj në Pazar dhe do t'i blej familjes diçka për të ngrënë me atë shumë parash që më dhurove ti ...

Shumë i çuditur nga kjo situatë, nxënësi vrapoi drejt mësuesit të tij shpirtëror. Kur nxënësi arriti te Hazreti Ebu Abbasi, ky i fundit nuk i dha fare kohë të shpjegohej, por i tha:

“O biri im! Nga e gjithë kjo histori, unë po kuptoj se gjatë punës tënde ti nuk paske treguar kujdes të veçantë ndaj gjërave të dyshimta ose gjërave haram. Kështu që, edhe pse ti u përpoqe të zgjidhje të varfërin, zakati yt shkoi për konsum vere. Gjërat, ashtu siç fitohen, po ashtu edhe largohen nga dora jonë. Urtësia, e cila bëri të mundur që ajo shumë parash të arrinte te i varfëri i vërtetë, qëndron në faktin se ato para ishin krejt hallall...”

Mundësia e arritjes së sadakasë tek ai që e meriton lidhet direkt me mënyrën se si ajo është fituar. Mund të themi se tek paraja ekziston ligji i tërheqjes së ngjash-

mërive, pra paraja hallall tërheq njeriun hallall, ndërsa ajo haram tërheq njeriun që është po ashtu haram. Paraja është si gjarpëri: del nga po ajo vrimë që hyn. Fitimi hallall bëhet shkak për punë të mira dhe të hajrit, ndërsa fitimi haram humbet në rrugë të mëkatit. Parë nga ky aspekt, qenia e një malli hallall apo haram mund të vërtetohet duke parë se nga shkon kjo pasuri, pra ku dhe si harxhohet.

Pozita shpirtërore e infakut mund të vërehet lehtësisht. Kur ajo çka dhurohet fal kënaqësi dhe qetësi shpirtërore, atëherë mund të dëshmojmë për hallallin e fitimit të asaj pasurie.

Feja jonë nxit dhënien apo dhurimin në çdo situatë. Në qoftë se ky detyrim kryhet me ihlas (sinqeritet), atëherë Allahu bën të mbijnë prej saj mirësi të veçanta. Madje, edhe atëherë kur duket se ajo që dhurohet nuk ka shkuar tek personi i duhur, mundet që në një të ardhme ajo ta zgjojë përfituesin nga gjumi i indiferencës dhe të bëjë që në zemrën e tij të fillojnë të çelin filizat e prirjeve të natyrshme drejt mirësisë.

Në lidhje me këtë të vërtetë, Hazreti Pejgamberi (s.a.v.s.) është shprehur:

Dikur një burrë bëri nijet të jepte sadaka dhe në terr të natës ia dha sadakanë një hajduti. Natën e dytë ia dha një prostitute, ndërsa natën e tretën ia dha sadakanë një të pasuri. Me ta marrë vesh këtë, populli e kritikoi me shprehje fyese e denigruese, por personi në fjalë, si rezultat i sinqeritetit të tij, tregoi se gjatë gjumit atë natë u bë dëshmitarë i këtyre shpjegimeve:

“Sadakaja që i ke dhënë hajdutit ndoshta do ta bëjë atë të turpërohet dhe të heqë dorë nga ky

ves i shëmtuar. Mbase prostituta do të bëhet pishman e do t'i kthehet një jete të pastër e të ndershme. Kurse i pasuri mund të marrë mësim, dhe në të ardhmen mund të dhurojë sadaka nga pasuria që i ka dhuruar Allahu atij. (Shih. Buhariu, Zekat, 14; Muslim, Zekat, 78)

Një shembull të ngjashëm me atë të mësipërmin e shohim edhe në jetën e njërit prej miqve të Zotit Sami Efendiut (k.s.).

Në një udhëtim drejt Anadollit, në Yrgyp, një udhëtar kërkon nga Shejh Sami Efendiut një shumë lekësh për të blerë duhan.

Edhe pse shumica e atyre me të cilët po udhëtonte Shejhu nuk ishin dakord, duke shprehur kundërshti dhe habi, Sami Efendiut ia dha fakirit shumën e parave të kërkuara, duke thënë: *“Meqë i kërkon paratë, duhet t’ia japim”*. Pasi i mori me gëzim ato para, po në atë çast dhe në mënyrë të pavetëdijshme i varfëri ndërroi njetin dhe ndër-sa po largohej tha: *“Me këtë shumë parash po shkoj të marr pak bukë”*.

Ja pra ndikimet pozitive që mund të bëjë sadakaja tek marrësi, kur dhurohet me sinqeritet e vetëm për hatër të Zotit!

Për këtë arsye, Shejh Saadiu na tërheq vëmendjen:

“Mirësinë mos e hidh në një qese e mandej t’ia mbyllësh grykën! Mos e kurse mirësinë tënde ndaj asnjërit! Mos thuaj ky është hipokrit e ky tjetri hileqar! Ata le të jenë si të duan, çfarë po të intereson ty kjo!?”

NË QOFTË SE E KE QËLLIMIN E PASTËR ALLAHU E SHTON MIRËSINË

Allahu ia shton bereqetin, një personi që është i sinqertë në njetin e tij. E shpërblen me shumë sevape për një vepër të mirë që ka bërë, qoftë ajo edhe

“Mirësinë mos e hidh në një qese e mandej t’ia mbyllësh grykën! Mos e kurse mirësinë tënde ndaj asnjërit! Mos thuaj ky është hipokrit e ky tjetri hileqar! Ata le të jenë si të duan, çfarë po të intereson ty kjo!?”

e vogël. Një dirhem i dhuruar me gjithë shpirt vlen më shumë se një mijë dirhem të dhëna pa shpirt. Nuk është e rëndësishme sasia e shumës së dhuruar, por është e rëndësishme të dihet raporti që ekziston mes pasurisë që zotërojmë dhe shumës së dhuruar, si dhe me sa shpirt dhurohet kjo shumë.

Në një hadith, profeti Muhamed (s.a.v.s.) ka thënë: ***“Nijeti i besimtarit është më me vlerë se vepra e tij.”*** (Sujuti, Xhamiu’s – Sagir, II, 194)

Parë nga ky këndvështrim, një vepër e mirë, sado e vogël që të jetë, rritet kur bëhet me sinqeritet. Dhurimet materiale që kryhen me shpirt, i bëhen kefaret gjynaheve.

I Dërguari i Allahut (s.a.v.s.) na bën të ditur se një grua gjynahqare fitoi xhenetin vetëm duke treguar mëshirë ndaj një qeni të etur, të cilit i dha ujë për të pirë në mes të shkretëtirës. Nga ana tjetër, një grua e përkushtuar në jetën adhuremore dënohet me hyrje në xhehenem vetëm për shkak të keqtrajtimit të maces së saj, pra vetëm për shkak të mungesës së mëshirës ndaj maces së saj. (Shih. Muslim, Selam, 151-153)

Kështu, mund të themi se për t’u përsosur si besimtarë duhet të bëjmë përpjekje serioze e me plot sinqeritet në rrugën e fitimit të kënaqësisë së Allahut, duhet të tregohemi të gatshëm e të etur për të bërë punë të mira, pa shikuar nëse ajo punë është e vogël apo e madhe. Koncepti ynë i dhurimit duhet të shtrihet edhe përtej dhurimeve që u bëjmë njerëzve, pra duhet të përfshijë edhe kafshët, gjë që do të thotë se duhet të përvetësojmë shikimin mëshirues që Krijuesi ka ndaj krijesave.

Një nga shfaqjet shumë të rëndësishme të mirësisë që derdh Allahu i Lartmadhëruar kur sheh se tek njeriu



gjendet sinqeriteti në dhurim, është edhe jetëgjatësia e shërbimit të institucioneve që ndërtohen për hir të Allahut. Institucionet që ndërtohen me sinqeritet dhe nëpërmjet pasurisë hallall, e sigurojnë vazhdimësinë e tyre për aq kohë sa të jetë i pranishëm plani shpirtëror.

Historia islame është e mbushur me shembuj që li-dhen me këtë temë. Ne po përmendim vetëm njërin prej tyre, atë të kompleksit Sulejmanije që ka furnizuar Stambollin me energji shpirtërore për vite me radhë. Kanuni Sulltan Sulejmani, i cili e ndërtoi këtë kompleks, ishte një njeri që i frikësohej hakut të njerëzve, e që gjithashtu ishte një halife që përpiquej të ishte i drejtë. Kur përfundoi së ndërtuari kompleksi, gurin e themel-it të së cilit e vendosi Shejhulislam Ebussuud Efendiu, Kanuni i mblodhi të gjithë, që nga arkitektët e deri tek punëtorët e thjeshtë, të cilët kishin kontribuar në ndërtimin e kësaj vepre madhështore. Pasi falënderoi Allahun ai u tha:

“O vëllezërit e mi të fesë, ndërtimi i kësaj xhamije me ndihmën e Zotit përfundoi. Në qoftë se gabimisht ose për shkak të harresës dikush nga ju nuk është paguar (pra nuk ka marrë pagën ose shpërblimin) ose i është ngrënë haku, le të vijë këtu e ta marrë tani atë çfarë i takon. Mundet që ndonjëri të mos jetë i pranishëm tani. I lutem atyre që ndodhen këtu, që t’ua përcjellin këto fjalë atyre që mungojnë.”

Madje edhe për kafshët që do të përdoreshin aty për të punuar, kishte një program të veçantë. Kishte orare të veçanta pushimi dhe ushqyerjeje për kuajt, gomerët dhe mushkat. Siç shihet, është treguar një kujdes i veçantë edhe ndaj të drejtave të kafshëve. Mbase kujdesi i treguar ndaj të drejtave të njeriut dhe të kafshëve gjatë ndërtimit të kësaj faltoreje mund të jetë një nga

arsyet themelore të rrezatimit shpirtëror të kësaj faltoreje.

Ndërtimin e kësaj faltoreje madhështore e ka realizuar gjeniu dhe njeriu me personalitet të lartë, arkitekt Sinani. Madje gjatë ndërtimit të faltores, ky njeri me grada të larta shpirtërore ka bërë kujdes që edhe gurët të mos të preken pa abdest. Fjalët që qarkullojnë në popull janë tërësisht të vërteta:

“Pronari i Sulejmanijes është Sulltan Sulejmani, ndërsa imani dhe besimi i saj është arkitekt Sinani...”

Në ceremoninë e inagurimit të xhamisë në fjalë, në shenjë mirënjohjeje Kanuni tha:

- Këtë faltore të shenjtë le ta hapë Sinani! Ai ka punuar më shumë!

Ndërsa Sinani i tha përzemërsisht Padishahut:

- Mbreti im! Hattati¹ Karahisari humbi dritën e syve duke bërë shkrimet e kësaj xhamije. Le t’ia dhurojmë atij këtë nder.

E kështu, pas gjithë këtyre sjelljeve të virtytshme, kjo faltore e shenjtë u hap nga hattati Karahisar.

Në arkitekturën e xhamisë Sulejmanije ndihet kudo atmosfera shpirtërore e adhurimit. Kjo e emocionon besimtarin dhe e shpie në një gjendje të thellë shpirtërore. Në atë xhami ka fituar kuptim jo vetëm guri, por edhe dheu. Kjo faltore është pasqyrimi i islamit në materie, në mënyrën më të shenjtë. Kjo faltore është si një njeri që hesht, por që me heshtjen e tij flet shumë.

Atmosfera shpirtërore e brendësisë së xhamisë ndikon shumë në shpirtin e njeriut. Kjo është diçka që vihet re shumë qartë. Madje edhe turistët që i përka-

1. Piktori që bën shkrimet e brendshme të xhamisë.

sin feve të tjera, pohojnë se u qetësohet shpirti e zemra nga atmosfera shpirtërore që përmban kjo faltore monumentale.

Ja pra, kjo është mirësia e dhurimit me sinqeritet. Që prej pesë shekujsh, kjo vepër madhështore vazhdon të qëndrojë krenare në këmbë edhe pas disa temeteve të rëna kohët e fundit. Ajo e mbron popullin me bukurinë e artit islam, por gjithashtu zbukuron qiejt me zërin e ezaneve. Sigurisht, jetëgjatësia e kësaj faltoreje është një mirësi, që Allahu ia dhuroi sinqeritetit...

ATË ÇFARË JEP DORA E DJATHTË TË MOS E DIJË DORA E MAJTË

Veprat e mira që bëhen nga shpirtërat e mbetur pa sinqeritet, pra që bëhen të nxitura nga hipokrizia dhe dëshira për tu dukur, nuk kanë asnjë vlerë. Në këtë pikë, rreziku më i madh qëndron në faktin se personi që bën një dhurim, mund ta bëjë këtë për ndonjë përfitim vetjak apo për ndonjë interes material që lidhet me këtë botë. Një ndër rrugët më të efektshme për të shpëtuar nga kjo sëmundje e zemrës, e cila asgjëson sevapet dhe shkatërron sinqeritetin, është aplikimi i dhurimit në fshehtësi.

Në një ajet kuranor thuhet:

“T’i jepni lëmoshat haptazi është gjë e mirë, por t’ua jepni ato të varfërve fshehurazi, është edhe më mirë dhe ju shlyen disa nga gjynahet tuaja. Allahu e njej mirë çdo vepër që ju bëni.” (surja el – Bekare, 271)

Pra, atij që dhuron diçka në mënyrë të fshehtë, Allahu ia mbulon të metat dhe gabimet. Një dhurim i tillë, ashtu siç i bëhet kefaret gjynaheve, i bëhet pengesë prirjes së mendjemadhësisë apo nevojës që ka njeriu për tu dukur, duke mos lejuar shkatërrimin e sevape-



ve.

Në një hadith thuhet:

“Allahu i Lartmadhëruar ia shkruan të fshehtë shpërblimin një robi që e kryen atë në mënyrë të fshehtë. Nëqoftëse ky njeri e bën në mënyrë të hapur këtë vepër, atëherë Allahu i Lartmadhëruar e regjistron atë tek veprat publike. Nëqoftëse veprën që ai ka bërë e tregon, atëherë Allahu ia shkruan atë në fletoren e hipokrizisë.” (Ihja, I 595)

Sipas ajetit të mësipërm, ata që e fshehin infakun e tyre, do të jenë të lumtur në botën tjetër nën hijen e arshit, në tmerrin e Ditës së gjykimit. (Shih. El- Bekare 271; Buhari, Ezan, 36)

Por, ngadonjëherë, është mirë që infaku të bëhet në mënyrë të hapur. Kështu, nxiten edhe të tjerët për të dhuruar. Në lidhje me ajetin: ***“T’i jepni lëmoshat haptazi, është gjë e mirë, por t’ua jepni ato të varfërve fshehurazi, është edhe më mirë dhe ju shlyen disa nga gjynahet tuaja. Allahu e njej mirë çdo vepër që ju bëni.”*** (surja el – Bekare, 271), mufesirët kanë thënë se zekati duhet dhënë haptazi, në mënyrë që të nxiten edhe të tjerët në dhënien e tij, ndërsa sadakaja dhe mirësitë e tjera të ngjashme me të duhen bërë fshehtas.

Si përfundim, mund të themi se punët e mira duhen bërë fshehtazi apo haptazi në varësi të kushteve dhe situatave. Nëse ruhet pastërtia e njetit të zemrës, nuk ka asnjë të keqe që dhurimi material të bëhet publikisht, sepse kjo do të nxisë edhe njerëzit e tjerë të bëjnë të mira, madje, në raste të veçanta duhet të jepet haptazi. Në të dy rastet e dhurimit të infakut, në dhënien e diçkaje fshehurazi apo haptazi, thelbësore mbetet ruajtja e zemrës nga hipokrizia dhe nga dëshira për t’u dukur, pra ruajtja e devotshmërisë dhe e sinqeritetit.



**“T’i jepni lëmoshat haptazi
është gjë e mirë, por t’ua jepni
ato të varfërve fshehurazi,
është edhe më mirë dhe ju
shlyen disa nga gjynahet tuaja.
Allahu e njeh mirë çdo vepër që
ju bëni.”**

Te disa njerëz dhënia e sadakasë haptazi mund të sjellë zhvillimin e paturpësisë; mospasja turp, tek disa njerëz mund të sjellë për pasojë pritshmëri të larta nga ti, por kjo nuk duhet të bëhet shkak të humbasë përpjekja dhe puna e bërë për t’iu gjendur afër njerëzve në nevojë nëpërmjet infakut. Gjithashtu, dhënia publikisht e infakut mund të sjellë zhvillimin e krenarisë, të mendjemadhësisë dhe të vetëkënaqësisë tek personi që e jep. Gjithashtu, mund të lëndohet edhe individi, të cilit i jepet infaku. Në raste të tilla, si këto që përmendëm më sipër, është më e preferuar të dhurosh diçka në mënyrë të fshehtë, jo publike.

Hazreti Omeri (r.a.), gjatë netëve merrte mbi shpinë thasë me miell dhe endej lagjeve të varfra, pa u parë prej askujt, që të gëzonte zemrat e fukarenjve.

Nipi i Hz. Aliut, Hz. Imam Zejnelabidini mbante netëve mbi shpinë thasë me ushqime, të cilat i linte fshehurazi në dyert e shtëpive të nevojtarëve të Medinës.

Një mënges ata vërejtën që nuk kishin më thasë me ushqime pas dyerve të tyre. Atë ditë u hap lajmi që Hz. Imam Zejnelabidini, nipi i Hz. Aliut kishte ndërruar jetë. Trishtimi i asaj dite u përjetua nga të gjithë.

Kur po lanin trupin e pajetë të Hz. Imam Zejnelabidinit, vërejtën që në shpinën e tij kishte disa plagë. Pasi u pyetën të afërmit për arsyen e kësaj, u kuptua që plagët ishin shkaktuar nga pesha e rëndë e thasëve të ushqimeve që ai u shpërndante të varfërve.²

Ja pra, këto janë rrezatimet e sinqeritetit të një zemre besimtare të mbushur me mëshirë, e gjithashtu ky është kujdesi që shfaq ky lloj besimtari i sinqertë ndaj **aparencialitetit** dhe ndaj përkëdheljeve të krenarisë

nga të tjerët.

Të parët tanë kanë qenë shumë të kujdesshëm në këtë pikë. Ata janë modele shembullore për t’u ndjekur. Fatih Sulltan Mehmet Han, në një nga pikat e rregullores së një shoqate bamirësie shprehet kështu:

“Unë, ngadhënjyesi i Stambollit, një rob nevojtar i Zotit, Fatih Sulltan Mehmeti, 136 dyqanet e mija të fituara me djersën e ballit ia dhuroj këtij vakëfi, sipas kushteve të mëposhtme: Në vendin e gatimit që unë kam ndërtuar në kompleksin tim, të gatuhet ushqim për gratë e shehitëve, për jetimët dhe të varfërit e Stambollit! Të sëmurëve që nuk mund të vinë e të marrin ushqimin apo të ushqehen këtu, t’u dërgohet ushqimi në enë të mbyllura, në të errur të ditës, në mënyrë që të mos shihet nga askush.”

Siç e shohim, në rregulloren e kësaj shoqate bamirësie, Fatih Sulltan Mehmet Hani ka vendosur rregulla në mbrojtje të individëve nevojtarë dhe të dobët të shoqërisë.

Të parët tanë e kishin traditë që ta fusnin zekatin në zarf dhe ta vendosnin nën disa gurë të posaçëm që gjendeshin në xhamitë e vendit; kështu, ai që e jepte zekatin nuk e shihte atë që e merrte dhe e anasjellta. Në këtë mënyrë, personi që merrte zekatin nuk vihej në siklet, por njëkohësisht as tek dhënësi nuk mund të lindte ndjenja e epërsisë dhe mendjemadhësisë.

Allahu e bëftë bashkësinë tonë prej asaj bashkësie që bën çmos në ruajtjen e sinqeritetit, dhe na bëftë prej vepërmirëve që i kryejnë veprat me sinqeritet! Allahu përcjelltë tek ne copëza nga gjendjet e bukura shpirtërore të evlijave dhe të të parëve tanë!

Amin!

2. Shih. Ibn-I Kesir, el-Bidaye, IX, 112, 122; Ebu Nuajm, Hilje, III, 136.





DISPOZITAT e agjërimit në sheriat

Mr. sci. Flamur Sofu

Me falën agjërimit në aspektin etimologjik kuptohet abstenimi, largimi, të përmbajturit në kryerjen e diçkaje, ndërsa në terminologjinë e jurisprudencës islame me këtë shprehje nënkuptohet: "Largimi-abstenimi nga e gjithë ajo që e prish atë (si f.v. ushqimi, pijet, marrëdhëniet intime bashkëshortore e të ngjashme me këto) në kohën para lindjes së diellit e deri në përfundim të tij."

Ky lloj ibadeti është i mbështetur në Kuran, Sunnet dhe Ixhma (vendim kompakt i dijetarëve islamë). Në kaptinën el-Bekare, Allahu (xh.sh.) thotë: **"O ju që besuat, agjërimiti u është bërë obligim siç ishte obligim edhe i atyre që ishin para jush, kështu që të bëheni të devotshëm."**

"E kush e përjeton prej jush këtë muaj, le të agjërojë..."

Po ashtu, Pejgamberi (s.a.v.s.) ka thënë: **"Islami mbështetet mbi pesë shtylla: shehadeti- dëshmi me të cilën dëshmojmë se nuk ka zot tjetër përveç Allahut, falja e namazit, dhënia e zekatit, agjërimiti i muajit të Ramazanit dhe Haxhi".**

Obligueshmëria e agjërimit është vërtetuar edhe me ixhma. Myslimanët në përgjithësi, kudo që janë në botë, janë të një mendimi se agjërimiti është një prej shtyllave të islamit dhe se ai që mohon obligueshmërinë e agjërimit të ramazanit konsiderohet i dalë prej besimit.

Ky lloj ibadeti është bërë obligim në vitin e dytë të hixhrit.

KUSHTET E VLEFSHMËRISË SË AGJËRIMIT

Agjërimiti përbëhet prej këtyre kushteve:

1. Nijeti (qëllimi). Nijeti nuk është kusht që të shqiptohet me gjuhë, ai është i vlefshëm edhe nëse kryhet vetëm me zemër.

mër.

2. Largimi nga të gjitha ato gjëra që e prishin agjërimitin që nga agimi e deri pas përfundimit të diellit.

3. Femra të mos jetë në kohën e hajzit (menstruacioneve) dhe nifasit (koha pas lindjes).

KUSHTET E AGJËRUESIT

Agjëruesi duhet të plotësojë këto kushte:

1. **Të jetë mysliman.** Ai, i cili nuk është mysliman nuk obligohet me këtë ibadet, sepse një njeri i tillë nuk ka besim në Allahun (xh.sh.).

2. **Të jetë i mençur.** Personi, i cili është i aftë mendërisht e ka për obligim zbatimin e këtij ibadeti, ndërsa ai që është i çmendur nuk obligohet për të agjëruar.

3. **Të ketë hyrë në moshë madhore.** Personi që e ka detyrim të agjërojë duhet të ketë hyrë në moshën madhore, gjë që nënkupton se mashkulli hyn në moshën madhore qysh në kohën kur i paraqitet polucionit, ndërsa femra hyn në moshën madhore kur i paraqiten menstruacionet.

Nëse ndodh që fëmija të agjërojë ende pa hyrë në moshën madhore, atij i lejohet të agjërojë, gjë për të cilën do të ketë shpërblimin e Allahut (xh.sh.).

SUNETET E AGJËRIMIT

1. **Të zgjuarit në syfyr.** Të zgjuarit për të ngrënë konsiderohet si një prej suneteve të agjërimit, duke u bazuar në fjalët e Pejgamberit (s.a.v.s.):

"Ngrihuni në syfyr, sepse syfyri është bereqet. Hani syfyr qoftë

edhe gjysëm hurme". (Muslimi).

2. Nxitimi për të bërë yftar. Sapo të mbërrijë koha e yftarit, agjërimi duhet prishur, qoftë edhe me një gotë ujë. Është e këshilluar (mustehab) që çdo agjëruar të nxitohet në kryerjen e yftarit, sapo të ketë ardhur koha e tij. Në lidhje me këtë, Pejgamberi (s.a.v.s.) ka thënë:

"Njerëzit janë vazhdimisht në të mira perderisa nxitohen në të bërit yftar".¹

3. Të bërit dua në kohën e yftarit. Lutja e preferuar me rastin e yftarit është:

"O Zoti im, në emër Tënd kam agjëruar, në ty besoj, dhe yftar bëj me atë që Ti më dhurove, shkoi etja, u mbushën damarët dhe u arrit shpërblimi nëse Allahu do".

4. Falja e namazit të teravive.

5. Dhënia sa më shumë e sadakasë (lëmoshës).

6. Bërja sa më shumë e ibadetit, sidomos në dhjetë ditët e fundit të ramazanit.

7. Dhënia yftar atyre që janë duke agjëruar, qoftë një hurmë ose së paku ujë.

ADABET E AGJËRIMIT

1. Që agjëruar ta rikujtojë sa më shumë faktin se është duke agjëruar.

2. Që agjëruar të durojë gjatë agjëritit e të mos ankohet duke thënë që nuk po mundet të agjërojë. Po ashtu, duhet t'u shmanget përdorimit të shprehjeve, që thonë se agjërimi qenka i vështirë e gjëra të ngjashme me këto.

3. Të mos kryejë punë të vështira, të cilat nuk janë të domosdoshme të kryhen.

4. Të jetë sa ma bujar gjatë muajit të agjëritit.

PERSONAT TË CILËT LIROHEN NGAGJËRIMI

Këta persona janë:

1. I sëmuri. Që i sëmuri të jetë i lirë nga obligueshmëria e agjëritit, ai duhet të jetë i sëmuri në atë masë sa që të parashikohet se agjërimi do t'ia përkeqësonte gjendjen, që nga shkaku i agjëritit do mund t'i ngadalësohej procesi i shëritit, ose që do të mund të ndjente dhimbje të mëdha. Nëse ndodh që dikush është i prekur nga ndonjë sëmundje mbi të cilën agjërimi nuk ndikon negativisht, atëherë ky njeri duhet të agjërojë. Sa u takon ditëve në të cilat nuk ka agjëruar, i sëmuri mund t'i zëvendësojë në ditë të tjera (kaza).

2. Udhëtari. Allahu (xh.sh.) ka lejuar që udhëtari të mos agjërojë, si lehtësim ndaj tij. Udhëtarit i lejohet të mos agjërojë prej momentit kur ai konsiderohet se është udhëtar, mirëpo nëse ndodh që të udhëtojë brenda ditës duke qenë në agjërim, ai duhet të vazhdojë të agjërojë, sepse nuk ka të drejtë ta prishë agjërimin e asaj dite. Gjithsesi, për udhëtarin është më mirë të agjërojë nëse është i fuqishëm dhe nuk pëson ndonjë dëm, pavarësisht se ka të drejtë të mos agjërojë.

1. Buhariu dhe Muslimi.

Udhëtari duhet t'i kompensojë ditët e paagjëruar me ditë të tjera.

3. Shtatëzëna dhe gjidhënësja. Nëse gruaja shtatëzënë ka frikë se mund të pësojë dëm ajo vetë apo fëmija i saj, i lejohet të mos agjërojë. Po ashtu, nëse gjidhënësja frikësohet se për shkak të agjëritit nuk do të ketë më qumësht për të ushqyer fëmijën, i lejohet të mos agjërojë. Shtatëzëna dhe gjidhënësja duhet të kompensojë ditët e paagjëruara një ditë për një ditë.

4. Uria dhe etja e madhe. Një personi që ka uri apo etje aq të madhe, sa mund të sëmuret, i lejohet të mos agjërojë. Ai që e prish agjërimin për shkak të urisë së madhe apo etjes së madhe, duhet t'i kompensojë ditët në të cilat nuk ka agjëruar.

5. I detyruari me forcë për të prishur agjërimin. Ai, të cilit i bëhet presion për të mos agjëruar, duke e kërcënuar me rrahje, eliminim e gjëra të ngjashme, i lejohet të mos agjërojë. Megjithatë, një person që gjendet në rrethana të tilla, duhet t'i kompensojë ditët e paagjëruara.

6. Ushtari që është në betejë. Nëse ushtari mendon se do mund të ndjejë molisje fizike kur të përballlet me armikun, atij i lejohet të mos agjërojë, por duhet t'i zëvendësojë në ditë të tjera, ditët në të cilat nuk ka agjëruar.

7. I sëmuri që nuk ka shpresë për t'u shëruar. Njeriu që vuan nga ndonjë sëmundje e pashërueshme si. f.v. sëmundjet kanceroze etj. lejohet të mos agjërojë, ndërsa për ditët e paagjëruara duhet të paguajë fidje (ushqim ditor).

8. Plaku i moshuar, i cili është i dobët. Kur arrin në një moshë aq të shtyrë sa që agjërimi i bën dëm dhe ia përkeqëson gjendjen shëndetësore, plakut i lejohet të mos agjërojë. Kompensimi i ditëve të paagjëruara është pagimi i fidjes (ushqim ditor).

ÇFARË E PRISH AGJËRIMIN

Gjërat që e prishin agjërimin ndahen në dy grupe:

1. Gjëra që e prishin agjërimin e për të cilat duhet bërë *keffaret*² dhe *kaza*³.

2. Gjëra që e prishin agjërimin e për të cilat duhet bërë vetëm *kaza*.

GJËRAT QË E PRISHIN AGJËRIMIN E PËR TË CILAT DUHET BËRË KEFFARET DHE KAZA

Kur ndodh që agjëruar i plotëson të gjitha kushtet e të qenurit i obliguar me agjërim dhe e prish agjërimin, atëherë ai është i detyruar të bëjë *keffaret* dhe *kaza* në këto dy raste:

1. Të ngrënë, të pirë dhe të gëlltiturit me qëllim. Ai, i cili ha, pi apo gëlltit diçka me qëllim, është i detyruar që si kom-

2. Keffaret është të liruarit e një robi, por nëse kjo mundësi nuk ekziston, atëherë duhet të agjërohen dy muaj pa ndërprerje, jashtë Ramazanit, duke pasur kujdes që të mos agjërohen ato ditë në të cilat është e ndaluar të agjërohet, e nëse edhe këtë gjë nuk mund ta bëjë, atëherë duhet të ushqejë 60 të varfër.

3. Kaza është të kompensuarit e një dite me një ditë tjetër.

pensim të bëjë *keffaret* (të agjërojë dy muaj pandërprerje) dhe *kaza* (një ditë për një ditë) që domethënë dy muaj e një ditë.

2. **Të kryerit marrëdhënie seksuale.** Në një rast të tillë, për të kompensuar, personi e ka si obligim të bëjë *keffaret* dhe *kaza*.

GJËRAT QË PRISHIN AGJËRIMIN E PËR TË CILAT DUHET BËRË VETËM KAZA

Këto gjërat janë:

1. **Të gëlltiturit e ndonjë sendi që nuk është ushqim.** Si p.sh.: të gëlltiturit e ndonjë monedhe, gozhde a gjëra të ngjashme. Një ditë e tillë duhet të kompensohet veç me një ditë, domethënë të bëhet vetëm *kaza*.

2. **Të ngrënët apo të pirët për shkak të presionit.** Për një ditë të kështillë duhet bërë vetëm *kaza*.

3. **Të ngrënët apo të pirët pa dashje.** Fjala vjen, nëse duke marrë abdest njeriut i shkon uji në fyt, apo në rastin kur nëna duke ia përtypur fëmijës ushqimin i kalon pa dashje diçka në fyt etj., për një ditë të tillë duhet bërë *kaza*.

4. **Të ngrënët apo të pirët si diçka e domosdoshme.** Fjala vjen, nëse dikush është i sëmurë, apo është në udhëtim, arsye për të cilat nuk mund të qëndrojnë pa ngrënë dhe pa pirë, ditë të tilla duhen bërë *kaza*.

5. **Paraqitja e menstruacioneve brenda ditës.** Nëse femrës i vijnë menstruacionet brenda periudhës kur është duke agjëruar, ajo duhet ta prishë agjërimin, ndërsa ditët e paagjëruara i bën *kaza*.

6. **Ejakulimi me anë të masturbimit.**

7. **Të vjellët me qëllim.** Nëse dikush vjell qëllimisht, ai duhet ta kompensojë atë ditë duke e bërë *kaza*.

8. **Kur ndodh që agjëruesi bën ndonjë veprim, rast në të cilin ai mendon se e ka prishur agjërimin dhe ha ose pi.** Po qe se dikush vepron në këtë mënyrë, ai duhet të bëjë *kaza* atë ditë.

9. **Kush ha apo pi pasi ka hyrë koha e namazit të sabahut dhe është në dyshim nëse ka hyrë apo jo koha e namazit të sabahut.** Në këtë rast duhet bërë *kaza*.

10. **Kush ha apo pi duke menduar se ka përfunduar die-lli, por që në fakt nuk ka përfunduar ende sado që mund të jetë krejt afër.**

ÇFARË NUK E PRISH AGJËRIMIN

Gjërat që nuk e prishin agjërimin janë:

1. **Ngrënia, pirja dhe marrëdhëniet intime për shkak të harresës.** Ai që ha, pi, etj. për shkak të harresës, por që me t'iu kujtuar agjërimi i ndërpret këto veprime dhe vazhdon agjërimin. Në lidhje me këtë rast kemi si argument fjalën e Pejgamberit (s.a.v.s.):

“Kush ka harruar duke qenë agjërueshëm dhe ka ngrënë apo ka pirë, le ta vazhdojë agjërimin e tij, sepse është Allahu që ia ka

dhënë mundësinë të hajë e të pijë”.⁴

2. **Ejakulimi në gjumë.** Nëse agjëruesi ejakulohet teksa është duke fjetur, agjërimi i tij nuk konsiderohet i prishur.

3. **Të qëndruarit i papastër.** Nëse gjatë ditës njeriu është i papastër, agjërimi i tij quhet i vlefshëm, ngase pastrimi nga *xhenabeti* nuk është kusht i agjërimit.

4. **Të gëlltiturit e ballgamit apo të qurrave, a gjëra të ngjashme.**

5. **Të gëlltiturit e tymit, pluhurit etj.**

6. **Futja e ujit në vesh gjatë notimit, pastrimit, ushtrimeve apo fladitjes.**

7. **Të vjellurit pa dashje.**

8. **Të futurit në fyt të ndonjë mize, mushkonje apo gjërave të ngjashme me këto.**

9. **Marrja e injeksioneve muskulare-joushqyese.**

10. **Alivanosja.**

11. **Kontrolli gjinekologjik i femrës.** Edhe nëse gjatë kontrollit gjinekologjik të femrës përdoren mjete, agjërimi nuk prishet. Nëse i jepet ndonjë injeksion në brendësi të mitrës apo brenda në vaginë, agjërimi prishet dhe duhet të bëhet *kaza*.

ÇFARË ËSHTË MEKRUH GJATË AGJËRIMIT

1. **Të shijuarit e ushqimit duke mos pasur si qëllim shijimin e tij.** Nëse është e mundur që ushqimi të përgatitet pa u shijuar, atëherë është mirë të mos shijohet.

2. **Të mbajturit në gojë ndonjë gjë që nuk tretet.** Si p.sh.: copë druri, gozhde etj.

3. **Të mbledhurit e pështymës me qëllim gëlltitjen e tij para njerëzve.** Kur ndodh që agjëruesi e mbledh pështymën për të fashitur terjen në fyt, nuk është mekruh, por të mbledhurit e saj me qëllim gëlltitjen para njerëzve konsiderohet mekruh.

4. **Kryerja e ndonjë veprimi që e dobëson agjëruesin.** Si fjala vjen pjesëmarrja në ndonjë lojë të rëndë etj.

5. **Puthja apo përkledhja që mund të shpie deri në ejakulim.**

ÇFARË NUK ËSHTË MEKRUH GJATË AGJËRIMIT

1. **Notimi, pastrimi i trupit dhe të fladiturit me ujë.** Nëse ndodh që uji të hyn pa dashje në brendësi të stomakut, agjërimi nuk prishet, por mbetet i plotë edhe më tutje. Transmetohet se Pejgamberi (s.a.v.s.) e ka lagur kokën me ujë kur ishte agjërueshëm, për shkak të etjes së madhe dhe nxetësisë së lartë.

2. **Përdorimi i misvakut dhe i brushës për pastrimin e dhëmbëve.**

3. **Shpërlarja e gojës dhe e hundës kur nuk jemi duke marrë abdest.**

4. **Parfumosja me erëra të këndshme.**

4. Buhariu dhe Muslimi.

“Kush ka harruar duke qenë agjërueshëm dhe ka ngrënë apo ka pirë, le ta vazhdojë agjërimin e tij, sepse është Allahu që ia ka dhënë mundësinë të hajë e të pijë”.

5. Përtpypja e ushqimit apo shijimi i qumshtit për fëmijën e vogël, duke treguar kujdes për të mos gëlltitur asgjë.

6. Puthja dhe përkledhja e lehtë, me kusht që të mos arrihet deri në ejakulim. Transmetohet nga Aishja (r.a.), e cila ka thënë: “Vërtet Pejgamberi (s.a.v.s.) i ka puthur disa prej grave të tij kur ishte agjërueshëm”.⁵

7. Dhurimi i gjakut. Agjëruesit i lejohej të dhurojë gjak, por në rast se një veprim i tillë ndikon në dobësimin e tij fizik, atëherë është mekruh. Kjo vlen edhe në rastin kur jepet gjak për analiza laboratorike.

AGJËRIMI DHE LLOJET E TIJ

Agjërimi është disa llojesh:

1. Agjërim farz konsiderohet:

a. agjërimi i muajit të Ramazanit,

b. agjërimi për të kompensuar ditët e paagjëruara gjatë ramazanit.

c. për ta realizuar betimin e bërë me agjërim. Fjala vjen në rastin kur dikush betohet se, nëse arrin të kryejë ndonjë punë do të agjërojë. Në këtë rast ai e ka farz që t'i agjërojë ditët për të cilat është betuar.

ç. për t'i kryer *keffaretet*, të cilat janë të obliguara të kryhen me agjërim.

2. Të agjëruarit vaxhib është:

a. Nëse dikush ka filluar të bëjë agjërim vullnetar dhe atë ditë e prish agjërimin me shkak ose pa shkak. Ky person e ka vaxhib për ta bërë kaza atë ditë.

b. Po qe se dikush ka bërë nijet që të izolohet në xhami (itikaf) disa ditë. Për të bëhet vaxhib agjërimi gjatë ditëve në të cilat qëndron në xhami.

3. Agjërimi sunet. Të agjëruarit sunet është:

a. Agjërimi i gjashtë ditëve të muajit Shevval. Për këtë lloj agjërimi Pejgamberi (s.a.v.s.) ka thënë: “Kush agjëron

muajin e Ramazanit e pastaj agjëron edhe gjashtë ditët e muajit të Shevval, konsiderohet se ka agjëruar gjithë kohën.”⁶

b. Agjërimi i tri ditëve në çdo muaj. Është e preferuar që të agjërohet dita e trembëdhjetë, e katërbëdhjetë dhe e pesëmbëdhjetë e çdo muaji hënor. Në lidhje me këtë Pejgamberi (s.a.v.s.) ka thënë: “Agjërimi i tri ditëve në çdo muaj.”⁷

c. Agjërimi i ditëve të ashureve. Rekomandohet që të agjërohet dita e nëntë dhe e dhjetë e muajit Muharrem, ndër-
sa agjërimi vetëm i ditës së dhjetë konsiderohet mekruh.

ç. Agjërimi i ditës së hënë dhe të enjte. Transmetohet nga Ebu Hurjera (r.a.) se Pejgamberi (s.a.v.s.) ka agjëruar ditën e hënë dhe të enjte.

d. Agjërimi i pjesës më të madhe të muajit Sh'aban. Aishja (r.a.) transmeton se Pejgamberi (s.a.v.s.) agjëronte aq shumë sa që ne thonim se nuk ka për ta ndërprerë kurrë, por nganjëherë nuk agjëronte, aq sa ne thonim se nuk ka për të agjëruar kurrë. Nuk e kam parë asnjëherë të agjërojë një muaj të tërë përveç Ramazanit. Po ashtu, përveç Ramazanit nuk e kam parë të agjëronte më tepër në ndonjë muaj se sa në muajin Sh'aban”. (Buhariu dhe Muslimi).

e. Agjërimi i dhjetë ditëve të para të muajit Dhyl Hixh-xhe.

ë. Agjërimi i ditës së Arafatit për atë që nuk ndodhet në kryerjen e haxhit. Në lidhje me këtë Pejgamberi (s.a.v.s.) ka thënë: “Atij që agjëron në ditën e Arafatit, do t'i falën mëkatet.”

4. Agjërimi mekruh tahrimen (mekruh i rëndë) është:

a. Të agjëruarit e ditës së Fitër Bajramit e të ditës së Kurban Bajramit, si dhe të tri ditëve të tjera (ejjamu teshrik).

b. Çfarëdo lloj agjërimi që dëmton rëndë shëndetin e agjëruesit.

5. Mekruhi ternzihen (mekruh i lehtë) konsiderohet agjërimi:

a. Agjërimi i ditës së dyshimtë (jevmi shekk), që është dita e fundit e muajit Sh'aban, për të cilën dyshohet nëse është e tridhjeta e këtij muaji apo dita e parë e Ramazanit.

b. Agjërimi i dy ditëve pa ndërprerje, pa ngrënë asgjë.

c. Të veçuarit e agjërimin gjatë atyre ditëve që konsiderohen ditë feste në besimet e tjera, si fjala vjen të agjëruarit vetëm në ditën e shtunë etj.

ç. Të agjëruarit vetëm në ditën e xhuma.

d. Agjërimi i gruas pa pëlqimin e bashkëshortit të saj. Kjo vlen vetëm për agjërimet vullnetare (*nafile*) e jo edhe për agjërimet farze.

e. Agjërimi i udhëtarit, kur ai ndjen vështirësi e lodhje të madhe.

5. Muslimi.

6. Muslimi dhe të tjerët.

7. Buhariu dhe Muslimi.



Disiplina trup- shpirt në Ramazan

Ali Riça Temal

*M*eqë në shekullin tonë qytetërimi është shndërruar në fuqi dhe linja fizike, puna më e madhe e njeriut i kush-tohet mbajtjes në formë të trupit, veprimtaritë sportive të organizuara në sektor më vete, degët e ndryshme të sporteve, ministritë përgjegjëse për mbarëvajtjen e veprimtarive sportive dhe drejtoritë e përgjithshme që varen prej tyre, degët e mjekësisë të specializuara në kurimin e sëmundjeve fiziologjike, dietat e praktikuara për të ruajtur dhe zhvilluar formën fizike, të gjitha këto tregojnë se rëndësia e një fiziku të mirë ka dalë në plan të parë, duke lënë pas dore kujdesin për një shpirt të bukur.

Ndërsa shprehemi në këtë mënyrë nuk kemi aspak qëllim të nënvlerësojmë rëndësinë e një shëndeti të mirë dhe një fiziku të fuqishëm, sepse gjithsesi trupi është kafsha mbartëse e shpirtit.

Lidhjen që ekziston mes trupit dhe shpirtit, mendimtari Gazali e krahason me rastin e haxhiut që shkon në haxh së bashku me devenë e tij. Nëse ai do ta shpenzonte të gjithë kapitalin që ka për devenë e tij, atëherë ai do të mbetej trokë, por nga ana tjetër, nëse e nënvlerëson ushqimin dhe fizikun e devesë me të cilën po udhëton, atëherë ka për të mbetur në mes të rrugës. Zgjidhja me e logjikshme është t'u japë secilës prej tyre, hakun që meritojnë, duke

vendosur kështu një ekuilibër.

Kohët e fundit janë duke u rekomanduar dieta të ndryshme për të humbur kilet e tepërta e për t'u ruajtur nga sëmundjet që burojnë nga të ushqyerit e tepërt dhe lëvizjet e pakëta, arsye për të cilën janë duke u shpenzuar vlera të mëdha parash.

Ofrohen receta ushqimore për t'u praktikuar në periudha tre-ditore, javore, mujore apo gjashtëmujore. Pirja vetëm e ujit për periudha të caktuara, apo të ushqyerit vetëm me shalqi a pjepër, ngrënia e përzierje të caktuara të ushqimeve apo dhënia gjak, janë vetëm disa prej praktikave të kryera me këtë qëllim.

Si është e mundur që njerëzit, të cilët bëjnë shpenzime të mëdha dhe pehriza të rënda vetëm që të shpëtojnë nga sëmundjet fizike, nuk e marrin aspak në konsideratë dietën fizike e shpirtërore që përmban muaji i Ramazanit, një dietë nëpërmjet së cilë mund të ruhen nga sëmundjet shpirtërore që përbëjnë rrezikun e tyre të vërtetë?

Kur Profeti (a.s.) që shprehur "**Agjëroni që të jini të shëndetshëm**", ka pasur për qëllim shëndetin si në planin fizik, ashtu edhe në atë shpirtëror. Programi i agjërit dhe i muajit Ramazan, të cilin ua porosiste njerëzve (si edhe

e praktikonte vetë), kryente detyrën e “dietës” më të vlefshme në formimin e një personaliteti të përkryer.

Sëmundjet moralo-shpirtërore janë më të rënda se sëmundjet fizike për njeriun, ndërsa ndikimi negativ i llojit të parë të sëmundjeve ka efekt më shkatërrues për individin e për shoqërinë. Prandaj, për të shpëtuar nga sëmundjet shpirtërore duhet që Kuranin ta konsiderojmë si një kartë, agjërimin si një spital, ndërsa muajin e Ramazanit si një saunë që na pastron nga ndotjet shpirtërore.

Ka lloje të ndryshme sëmundjesh shpirtërore, si: injoranca, përtacia, kopracia, egoizmi etj. Me një dietë të rreptë të zbatuar gjatë muajit Ramazan është e mundur të shpëtojmë nga këto sëmundje.

Ilaçi i parë që duhet marrë për të shpëtuar nga injoranca, është të lexojmë tekstin dhe komentet e Kuranit, në të cilin urdhri i parë i zbritur që “Lexo”, ndërsa më pas duhet t’i zbatojmë ato që lexojmë e të nxjerrim mësim, të mësojmë prej tyre. Leximet pjesë-pjesë të Kuranit gjatë natës apo gjatë ditës, leximet individuale dhe përsiatjet mbi ajetet kuranore, duhet të na ndriçojnë me rrezet e Kuranit. Gjatë muajit Ramazan duhet ta bëjmë hatme Kuranin në kushtet që sapo treguam, të paktën një herë.

Për të shpëtuar nga përtacia duhet që namazet t’i falim në kohën e tyre, të falemi së bashku me xhemat. Në mënyrë të veçantë nuk duhet të na ikin namazet e teravisë, madje po të jetë e mundur t’i falim ato nëpër xhami të ndryshme e të ngrihemi për syfyr. Në mënyrë të veçantë janë namazet ato që formojnë një program të disiplinuar për jetën.

Për të shpëtuar nga sëmundja e koprracisë ka rrugë shërimi siç janë dhënia e zeqatit, e sadakai fitrit dhe e lëmoshave të tjera, si dhe shtruarja e sofrës së iftareve për agjëruarit e tjerë. Për të na treguar se sa mjet i mirë është zeqati për pastrimin shpirtëror, Zoti thotë në Kuran: **“Pranoje një pjesë të pasurisë së tyre si sadaka që do t’i pastrojë ata nga gjynahet dhe do t’i pastrojë shpirtërisht.”** (Tevbe, 103) Sa më shumë që të dhurojë njeriu, aq më shumë i shtohet fuqia e tij për të dhuruar, ndërsa kur nuk dhuron, kopracia i shndërrohet në shprehi të karakterit të tij.

Dieta kundër sëmundjes së përgojimit, veçanërisht kur je agjërueshëm, është ta zotërosh fjalën që thua, dhe kur të tjerët kërkojnë të hyjnë në konflikt me ty nëpërmjet fjalëve, atëherë duhet të largohesh nga rrethi i thashethemeve dhe i ngatërresave, duke u shprehur ashtu siç na ka mësuar Profeti (a.s.): **“Unë kam agjëruar sot”**. Agjërimi i personave që bëjnë thashetheme, që përgojnë dhe kërkojnë të grinden me fjalë, nuk është gjë tjetër përveç se të rrinë



me barkun bosh. Ilaçi më i mirë për parandalimin e përgojimit, është të lexosh sa më shumë Kuran dhe të bësh sa më shumë dhikr.

Që të shpëtosh nga sëmundja e mosmirënjohjes, duhet të pranosh përherë e më shumë begatitë kur përjeton ndjenjën e urisë, të meditosh se çfarë do të kishte ndodhur me ne po të mos ishin këto begati, si dhe ta falënderosh Zotin që na i ka dhuruar këto begati të pafundme. Ndodh shumë herë që njeriu të mos e kuptojë begatinë që zotëron, por vlerën e tyre e kupton vetëm atëherë kur i mohohen ato begati. Në këtë kuptim agjërimi është një mjet falënderimi.

Mënyra e duhur për kurimin e egoizmit dhe të mungesës së mëshirës është të mendosh për hallet e të uriturve dhe të të mjerëve, t’i vizitosh ata, të mund tua fitosh zemrat dhe të marrësh dua prej tyre. Uria dhe pamundësia që përjetojmë gjatë agjërit duhet të na shtyjë të mendojmë më shumë rreth jetës së përditshme të njerëzve të uritur dhe të varfër.

Siç vihet re, Kurani dhe muaji i agjërit, Ramazani, përbëjnë një dietë të vlefshme dhe një muaj të tërë kurimi, krejtësisht të lirë nga aspekti ekonomik dhe të lehtë për t’u përmbushur, por që të shëron nga një numër të madh sëmundjesh si shpirtërore, ashtu edhe fizike.

Lutem që edhe muaji i Ramazanit që po vjen të shndërrohet në një dietë të fortë dhe në një stinë kurimi për shpirtrat e sëmurë që kanë etje të kurohen. Për sa kohë që nuk pastrohemi nga mëkatet, të cilat janë burimi i vërtetë i sëmundjeve, nuk do të jetë e mundur të jetojmë të shëndetshëm në këtë botë, ashtu siç nuk do të jetë e mundur as të hyjmë në vendin e prehjes së përhershme që është parajsja.



Ai që përkëdhel kokën e një jetimi

Sadikë Dana

Allahu i Madhëruar urdhëron:

“Prandaj, mos e shtyp jetimin, lypësin mos e shty me ashpërsi.” (Ed-Duha, 9-10)

“A e ke parë atë që mohon Ditën e Llogarisë? Ky është ai që i dëbon ashpër jetimët dhe nuk nxit që t’i jepet ushqim të varfrit.” (El – Maun, 1-3)

“Dhe mos iu qasni pasurisë së jetimit, përveçse për ta rregulluar, derisa të mbërrijë pjekurinë!” (El-En’am, 152)

“Jepuni pasurinë jetimëve, mos ua ndërroni sendet e tyre të mira me tuaajat të këqija. Mos e harxhoni pasurinë e tyre duke e përzier me pasurinë tuaj. Se kjo, me të vërtetë, është gjynah i madh.” (En-Nisa, 2)

Ndërsa profeti ynë (a.s.) ka urdhëruar:

“Unë dhe ai që përkujdeset për jetimin, do të jemi bashkë në xhenet kështu” dhe bëri me shenjë duke treguar gishtin tregues dhe të mesit. (Buhari)

“Shtëpia më e dashur tek Allahu, është ajo shtëpi në të cilën bëhen mirësi ndaj një jetimi.” (Bejhaki)

Në një hadith kudsi, urdhërohet kështu:

“O biri i Ademit! Në xhenetin Tim nuk do të mund të hyjë askush përveç atyre që janë të përrulur ndaj Madhësisë Time, ato që e kalojnë ditën në adhurim, ato që ruhen nga epshet e egos, vëllezërve të të shkretëve, ndihmësve të të varfërve, ato që bëjnë mirësi ndaj jetimëve e u

bëhen prind atyre, si dhe ato që sillen si bashkëshortë të mëshirshëm duke u zgjatur dorën e ndihmës grave të veja. Të gjithë atyre që i zotërojnë cilësitë që u përmendën, do t’u përgjigjem kur të më thërrasin, do t’u them “po” dhe do t’u shkoj në ndihmë. Kur të dëshirojnë prej meje diçka, do t’ua jap dhe në zemrat e robërve të Mi do të vendos dashurinë Time.”

“O biri i Ademit ! Ata që mbrojnë jetimët dhe gratë e veja me qëllim që të fitojnë kënaqësinë Time, do t’i fus në hijen Time në ditën ku nuk do të ketë hije tjetër përveç hijes Time.”

“O biri i Ademit ! Aq sa mëshiron, do të mëshirohesh. Si mund të kërkosh prej Meje që të kem mëshirë për ty kur ti nuk i mëshiron robërit e Mi?”

Ai që është kujdestar i një jetimi, duhet ta edukojë atë ashtu siç edukon fëmijën e vet, sepse ai do të japë llogari për të në ditën e gjykimit. Ai duhet të mendohet me çdo kusht që të rregullojë gjendjen e jetimit.

Zemra e jetimëve është e thyer dhe e dëshpëruar, sepse ata ndodhen larg dashurisë prindërore, e ndjejnë veten të pafat dhe dëshpërimi i tyre nuk ka fund.

Të pasurit që e duan Allahun, do të bënin një punë të shkëlqyer nëse do të merrnin nga një apo dy jetimë nën mbrojtjen e vet, ose në rast mundësisë më të mëdha, të ndërtonin një jetimore.

Mirë se vjen muaji i Ramazanit

Mexhid Goxsi

Mirë se vjen o muaji i bekuar
Mirë se vjen për botën mbarë,
Zoti me Kuran t'ka madhëruar
Me gëzim të pret çdo besimtar!

Mirë se vjen o muaj i agjërimit,
Që shkëlqen nga rrezet e së vërtetës,
Mirë se vjen pranverë e njerëzimit
Stina më e bukur e jetës!

Mirë se vjen o muaji i adhurimit,
Xhamitë të presin mbushur plot,
Aty, po, shtrihet dora e pajtimit,
E lidhet besa me të Madhin Zot!

Mirë se vjen o muaji i pendimit,
Jemi mëkatarë, ishim të verbuar,
Dot nuk e gjenim rrugën e shpëtimit,
Zotin e Vërtetë e kishim harruar!

Mirë se na vjen o muaj i ngadhënjimit
Kurrë s'na ke gjetur kaq të hutuar,
Por me shpresë jemi nisur drejt qëlli-
mit
Siç ka urdhëruar Zot'i i Lartësuar!

Mirë se vjen në trojet arbnore,
Ku ende del tymi i temjanit,
Por fundi ynë është i lidhur me fitore
Si fundi yt me Ditën e Bajramit!

Bejtu'l Hikme

Mr. Artur Tagani

Bejtu'l-Hikme (Vatra e Urtësisë) është emri i një qendre kërkimore shkencore e nivelit të lartë, si dhe e përkthimeve, e historisë së kulturës dhe shkencës Islame në Mesjetë.

Nuk dihet saktësisht se kush mund ta ketë filluar ndërtimin e kësaj qendre, por shumica e burimeve tregojnë se Bejtu'l-Hikme e ka zanafillën që nga shekulli VIII me Kalifin e dytë abasit, Ebu Xhafer el-Mensurin. Për arsye se Kalifi Mensur pëson një sëmundje në stomak, ai fton në Bagdad mjekun kryesor të akademisë së Xhundishapurit (sot pjesë e Iranit), akademi e cila ishte qendër e rëndësishme mjekësore. Brenda shtatë viteve që mjeku qëndron pranë Kalifit, mendohet të ketë përkthyer në arabisht shumë vepra lidhur me mjekësinë. Ky rast, mendohet të ketë qenë kontakti i parë kulturor me Xhundishapurin dhe kontakti i parë me shkencën në mënyrë institucionale. Më pas, me largimin e mjekut nga pallati mbretëror i Kalifit, ftohen mjekë të tjerë nga Xhundishapuri, që të vazhdojnë veprimtarinë si mjekë të oborrit mbretëror dhe të vazhdojnë kërkimet në fushën teorike të mjekësisë.

Me sa duket, një lëvizje e tillë duhet të ketë ngjallur kurreshtjen e Ebu Xhafer el-Mensurit, sepse më pas ai mbledh nga shtete të ndryshme në sarajin e tij edhe ekspertë të matematikës, astronomisë e mjekësisë. Kështu, në kohën e tij, përkthehen vepra të fushave të ndryshme nga shumë gjuhë, si greqishtja, persishtja dhe sanskritishtja. Në këtë mënyrë hidhen hapat e parë dhe shumë seriozë për krijimin e qendrës shkencore të quajtur Bejtu'l-Hikme.

Në kohën kur Kalif bëhet Harun er-Rashidi, një nga veprimet e para që ai bën është fushata për mbledhjen e

shkencëtarëve dhe të veprave të ndryshme shkencore në territorin ku shtrihet pushteti i tij. Më pas, ai rigjallëron veprimtarinë e përkthimeve, e cila ishte dobësuar kohët e fundit, gjatë qeverisjes së babait të tij, Ebu Xhafer el-Mensurit. Është fakt historik që Harun er-Rashidi kishte shpallur se në këmbim të parave që duhej të paguanin ata që kishin për të dhënë xhizje, pranonte edhe libra.

Në kohën e Kalifit tjetër abasit, Me'munit, Bejtu'l-Hikme pëson shumë ndryshime. Ai e risistemon atë. I shton edhe një qendër observimi, si dhe hap një pjesë të bibliotekës për publikun, pra ndërton një sallë leximi. Një tjetër veçori ishte se në kohën e tij, në atë sallë filluan të organizoheshin tubime dhe diskutime shkencore, në shumicën e të cilave merrnin pjesë edhe vetë Kalifët.

TRANSFORMIMI KULTUROR

Librat që u sollën në Bejtu'l-Hikme

1. Nga bota e mendimit grek

Gjatë ekspeditave me Bizantin, Me'muni merr në qytetin e Ankarasë dhe Ammurijsë shumë dorëshkrime mbi matematikën, mjekësinë dhe shkencën e logjikës, të cilat i sjell në Bagdad për t' i vendosur në Bejtu'l-Hikme.

Mes librave që sjell Kalifi ishin edhe veprat e Platonit, Aristotelit, Hipokratit, Ptolemeut, si dhe mjaft vepra të tjera të mendimtarëve grekë.

2. Nga bota e mendimit pers

Mënyra e mbërritjes së veprave perse në Bejtu'l-Hikme

është realizuar më shumë nëpërmjet ardhjes në Bagdad të dijetarëve persë. Ata sollën me vete libra të fushave të ndryshme, si: astronomi, inxhinieri të ndryshme, gjeografi, letërsi, histori, politikë dhe tregime.

3. Nga kultura e shkruar në gjuhën sanskrite

Gjatë periudhës së sundimit të abasive, regjistrohen tre vizita të grupeve shkencëtarësh nga India, një në kohën e kalifit të parë abasit, Ebu'l-Abbasit, tjetra në kohën e Mensurit dhe një tjetër në vitin 774. Për aq kohë sa ata qëndrojnë në Bagdad, bëhen shumë tubime shkencore, në të cilat marrin pjesë edhe dijetarë bagdadas. Kontributi i tyre njihet më shumë në fushën e matematikës, astronomisë, mjekësisë dhe të etikës.

MËNYRA E FUNKSIONIMIT E BEJTU'L HIKMES DHE VEPRIMTARIA E SAJ

Sektori i bibliotekës:

Bejtu'l-Hikme mendohet të ketë patur afro një milion libra në fondin e tij. Një bibliotekë me një kapacitet të tillë, që për kohën ishte diçka e jashtëzakonshme, kërkonte një organizim të mirë për t'i ruajtur librat dhe për t'i hapur ndaj lexuesit. Prandaj, nuk është shumë e vështirë të mendohet se personeli i saj duhet të ketë qenë i madh.

Një prej detyrave të këtij sektori ishte përgatitja e katalogut të bibliotekës, me qëllim që të arrihej sa më shpejt tek libri i kërkuar.



Sektori i përkthimeve:

Sektori i përkthimeve në Bejtu'l-Hikme, nuk ishte i pavarur nga biblioteka. Përkthimet realizoheshin në ambientet e bibliotekës, por secili grup përkthyesish qëndronte në dhoma të veçanta. Përkthyesit e persishtes mbledheshin në një vend, të greqishtes në një dhomë tjetër, ata të surianishtes në një tjetër, e kështu me radhë. Në krye të secilit grup ishte edhe kryepërkthyesi, përgjegjësi i librave që përktheheshin nga grupi i tij.

Sektori i qendrës së observimit:

Në kohën e Kalifit Me'mun ishin ndërtuar dy qendra observimi: njëra në zonën e Shamit dhe tjetra në Bagdad, në Bejtu'l-Hikme. Me ndërtimin e qendrave të observimit, veprimtaria e Bejtu'l-Hikmes zgjerohet nga aspekti fizik dhe funksional. Kjo ishte një prej veçorive, e cila bënte që Bejtu'l-Hikmen të ishte edhe një qendër kërkimore. Pra, në Bejtu'l-Hikme nuk bëhej vetëm përkthim, por eksperimentet e kësaj qendre fillimisht bënë mbledhjen e të gjitha të dhënave shkencore lidhur me astronominë, duke filluar që prej kohës së sumerëve e gjer në atë kohë. Këto të dhëna përktheheshin nga sektori i përkthyesve, ndërsa më pas bëheshin hulumtimet e duhura.

STRUKTURA BUROKRATIKE NË BEJTU'L HIKME

1. Personeli akademik

a. Sahibu'l Bejtu'l-Hikme dhe Hazinët

Sahibu'l Bejtu'l-Hikme merrej më shumë me drejtimin e Bejtu'l-Hikmes. Ndërsa hazinët ishin përgjegjësit e sektorit që mbulonin, si dhe redaktorë të librave që përktheheshin. Po ashtu, hazinët merreshin me përcaktimin e librave që do përktheheshin, bënë klasifikimin e tyre dhe mbanin shënimet nëpër katalogë. Krahas këtyre, hazinët dërgoeshin edhe si ambasadorë kulturorë në shtete të tjera.

b. Përkthyesit

Pjesa më e madhe e personelit të Bejtu'l-Hikmes përbëhej nga përkthyesit. Këta përkthenin në mënyrë individuale ose në grup. Përgjithësisht, përkthimet bëheshin nga greqishtja, persishtja, sanskritishtja, surianishtja, ibanishtja, koptishtja, nebatishtja, sudanishtja dhe latinishtja.

c. Mustensih-ët

Mustensih-ët kishin për detyrë të shumëfishonin librat, duke i rishkruar ato. Ata dërgonin në vende të ndryshme disa kopje të librave që përktheheshin; po ashtu ata ishin përgjegjësit e ruajtjes së veprës origjinale dhe të tre kopjeve të tjera në Bejtu'l-Hikme.

Poeti osman me origjinë të vjetër shqiptare:

Jahja Bej Dukagjini

(?-1582)

Poeti me origjinë shqiptare, Jahja Bej Dukagjini është një ndër poetët më të shquar osmanë të letërsisë turke në zhanret divan, mesnevi (distik) dhe hamse. Poet i nivelit më të lartë artistik, ai konsiderohet i dyti pas Fuzuliut, në llojin e poezisë mesnevi. Si në veprën e tij Divan, ashtu edhe në veprën Hamse, herë pas here ai përmend faktin se është me origjinë nga Shqipëria “nga vendet ku lartësohen malet”. Duke filluar që nga vepra “Esami” e Muallim Naxhiut dhe deri më sot, ai njihet në literaturën turke me cilësinë Tashllëxhali, që do të thotë “me origjinë nga vendet gjithë gurë”.

Figura e Jahjasë lidhet me familjen e Dukagjinëve, më saktë me atë degë të kësaj familjeje që zgjodhi të vendosej brenda administratës osmane, në dallim nga krahu i Dukagjinëve, përfaqësuar nga Lekë Dukagjini, të cilët zgjodhën të mbështesnin përpjekjen e Gjergj Kastriot Skënderbeut, heroit kombëtar shqiptar. Nuk e dimë me saktësi se kur u pozicionua pro-osmanë, brenda administratës osmane kjo degë e Dukagjinëve, por kurdo që të ketë ngjarë, ajo ndoqi të njëjtën dhe të vetmen rrugë që mundësonte sistemi osman për fisnikët ballkanas në përgjithësi, ata shqiptarë e boshnjakë në veçanti: sistemin e devshirmesë për t’u bërë jeniçerë.

Familja e Dukagjinëve pro-osmanë del në pah nëpërmjet figurës së Ahmet pashë Dukagjinit, një prej sadrazamëve osmanë, pavarësisht kohës së shkurtër prej dy muajsh e gjysmë dhe një fundit tragjik që pësoi. Ai pati një jetë të pasur në karrierën ushtarake. Gjatë luftërave

osmano-memlukes ai fitoi gradën e sanxhakbeut të Ankarasë, si dhe u caktua të thyente ushtrinë e shehzadesë Ahmet gjatë luftës për fron të bijve të sulltan Bajezidit II. Madje ishte pikërisht ky njeri ai që zuri rob shehzaden Ahmet dhe ia shpuri sulltanit të ardhshëm, Selimit. Mori pjesë në betejën kundër shah Ismailit, ndërsa pas fitores u dërgua në Tebriz për të ruajtur thesarin e shahut e për të mbajtur popullin nën kontroll. U akuzua për cytje të jeniçerëve në organizimin e kryengritjeve, arsye për të cilën u ekzekutua. Gjatë sundimit të sulltan Sulejmanit, djali i tij Mehmet Dukagjini pati arritur gradën e bejlerbeut të Egjiptit e të Halepit, ndërsa biri i tij Osman Dukagjini, i cili njëkohësisht ishte edhe nipi i Ahmet Dukagjinit bëri emër në fushën e myderrizit, duke ushtruar detyrën e kadiut të Egjiptit e të Stambollit. Mjaft burime pohojnë se ai pati shkruar edhe libra.

Një tjetër pinjoll i Dukagjinëve në Turqinë Osmane shfaqet në shek e XIX-të dhe emri i tij është Basri Dukagjini. Familja i humbi gjurmët gjatë regjistrimit të ri të emrave në dekadat e para të Turqisë Republikane, kohë gjatë të cilës u kërkua që të ndryshoheshin mbiemrat, që midis të tjerash tregonin edhe përkatësi etnike.

Jahja Dukagjini krenohej me përkatësinë e tij kombëtare dhe e nxirrte në pah në poezitë e tij identitetin e tij prej jeniçeri, duke shkruar vargje plot emocion. Si të gjithë të rinjtë e tjerë që përfshiheshin në sistemin e jeniçerëve, edhe Jahja Dukagjini u regjistrua në oxhakun e djelmoshave fillestarë, ku ra në sy edhe aftësia e tij për

shkencën dhe artin poetik. Në jetën e tij prej jeniçeri ai arriti të fitojë deri gradën "Jajabashë", nën të cilën mori pjesë në shumë beteja. Nga poezitë e tij kuptohet se ka marrë pjesë në betejën Çalldëran dhe në fushatën kundër Egjiptit, të ndërmarrë nga sulltan Selimi i Rreptë. Përfshirja e tij në rrethet e poetëve dhe në tubimet e të urtëve, gjë e cila i dha famë të gjerë, ndodhi gjatë kohës kur në fronin perandorak kishte ardhur tashmë sulltan Sulejman Ligjvënës. Vetë sulltani shkruante në poezitë e tij se kishte marrë mësimë prej dijetarit dhe historianit të famshëm turk Kemal Pashazade dhe se kishte përfutur nga njohuritë e Muhidin efendi Fënarizadesë.

Një pjesë të jetës e kaloi duke rendur nga njëra betejë në tjetrën, herë në Anadoll e herë në Rumeli. Ai mori pjesë në fushatat e sulltan Sulejmanit kundër Vjenës dhe Gjermanisë, si dhe në fushatën e parë kundër Irakut, koha kur ai shkroi një poezi të llojit kaside me të cilën i kërkonte sekretarit të thesarit, Çelebiut që t'u siguronte ushqime të bollshme dhe para, duke i portretizuar në vargje vështirësitë dhe urinë që kishin përjetuar gjatë asaj fushate. Pas kësaj fushate ai ngrihet në shkallën e spahiut.

Poeti Jahja Dukagjini nuk ishte si poetët e tjerë të oborrit, të cilët i mbushnin poemat e tyre me lajka për zotërinjtë e tyre. Çdo lloj dhurate që merrte prej epurve, Jahja Dukagjini e konsideronte shpërblim të natyrshëm të trimërisë së treguar në beteja. Por vendi i tij brenda sarajit të sulltanit u lëkund në kohën kur ai shkroi vargje elegjiake kushtuar vrasjes së princit trashëgimtar për fronin e sulltanit, Mustafait, birit të sulltan Sulejmanit, i cili u vra me urdhrin e këtij të fundit afër Konjës, gjatë fushatës së Nahxhevanit. Duke qenë se sipas traditës osmane Mustafai ishte pretendent për fronin perandorak, njëra nga bashkëshortet e Sulejmanit, mbretëresha Hyreme, me origjinë ukrainase, vendosi që së bashku me sadrazamin e kohës, Rustem pashën, ta eliminonte fizikisht Mustafain, që kështu t'i hapte udhë për të hipur në fron birit të saj që e kishte lindur me sulltan Sulejmanin, princin Bajezid. Për t'ia arritur këtij qëllimi, ajo thuri një intrigë, duke e bindur sulltanin se shehzadeja Mustafa po komplotonte kundër tij me shahun e Iranit, me qëllim që ta vriste dhe të vinte vetë në pushtet. Duke përfutur nga disa shpifje,

Hyremja dhe sadrazami arritën ta lëkundin besimin e sulltanit dhe të merrnin një gjysmë miratimi, të cilin ata e vunë përnjëherë në zbatim. Ata e thirrën princin trashëgimtar, Mustafanë, sikur gjoja sulltani dëshironte ta takonte dhe e vranë në një çadër të thjeshtë ushtarësh jeniçerë. Kështu, Mustafai vdiq në mënyrë tragjike, në moshën 38 vjeçare.

Vdekja e tij u prit me indinjatë, pikëllim dhe zemërim të fshehtë si në ushtri, ashtu edhe në popull, sepse shehzadeja Mustafa ishte një personalitet i lartë dhe i dashur për të gjithë. Me këtë rast, poeti Jahja Dukagjini shkroi një elegji, e cila u shndërrua në një nga kompozimet e rralla të poezisë turke.

Më pas, më 1555, ku Rustem pasha, inskenuesi i vrasjes së princit trashëgimtar erdhi për herë të dytë në postin e sadrazemit, Jahja Dukagjini u detyrua të shkante Zvornik, me një rrogë prej 30 mijë akçesh.

Ai shkroi një poezi (kaside), çdo varg i së cilës përloqaritet me një datë të caktuar në lidhje me ndërtimin e xhamisë Sulejmanije. Edhe vdekja e sadrazamit, armikut të tij të përjetshëm, nuk ndryshoi asgjë në gjendjen ekonomike të poetit Jahja Dukagjini. Poezinë e tij të fundit, në të cilën ai rrëfen hallet ekonomike dhe nevojën që kishte për t'ia emëruar fëmijët e tij në një vend të sigurt, ia dërgoi sulltan Sulejmanit gjatë fushatës së Zigetvarit. Vitet e fundit të jetës ai u afrua me misticizmin islam dhe u bashkua me tarikatin Gylsheni. Në lidhje me vdekjen e tij jepen data të ndryshme, por data më e pranuar është viti 1582. U varros në Zvornik.

Megjithatë një poet i aftë në zhanrin Divan të letërsisë osmane, Jahja Dukagjini zuri vend në letërsinë turke si një mjeshtër i rrallë në zhanrin mesnevi. Jo vetëm në poezitë e llojit mesnevi, por edhe në ato të llojeve kaside dhe gazel. Ai përdorte një gjuhë të thjeshtë dhe të pastër.

Jahja Dukagjini arriti të shkruajë një poezi të llojit hamse, e cila përmban 5 distikë, një nga ideat më të dashura të shkrimtarëve klasikë lindorë që nga koha e poetit të njohur pers Nizami. Ana më e veçantë e poetit Jahja në fushën e poezive mesnevi që origjinaliteti dhe frymëzimi i tij poetik.



Më dhemb shpirti nënë...

Kam ftohtë nënë... e kërkoj aq shumë ngrohtësinë tënde... Tani ti nuk vjen më as në ëndrrat e mia.

Një shoqe më pati thënë: “Nëse bën dua dhe bëhesh e urtë, do të mund ta shohësh nënën tënde”... të jetë gënjeshtrë vallë?!

Nuk e di sa kohë u bë pa të parë, por tashmë edhe ëndrra jote u fshi! Di vetëm që edhe unë e kam një nënë.

A e di nënë se tashmë u largova edhe nga konvikti? Rri në “Shtëpinë e Fëmijës”, së cilës i thonë ndryshe “Shtëpia e Dashurisë”. Kam edhe pesë shoqe me të cilat shkojmë së bashku në të njëjtën shkollë. Shtëpia jonë e re është shumë e bukur. Nga larg duket deti.

Në kopshtin tonë ka pishinë, kështu që mësova edhe të notoj. Nganjëherë shkojmë në det, nganjëherë bëjmë gara në pishinë. Shpeshherë shkojmë për vizitë në shtëpitë e shoqeve të tjera. Çdo gjë është mirë nënë, sikur të ishe edhe ti!...Asgjë tjetër s’do të doja. Do të haja ç’të më gatua je ti, do të vishja ç’të më jepje ti, madje edhe do të të kisha ndihmuar.

Tashmë jam rritur, por është gjithmonë një pjesë që më mungon, nënë...

Shpeshherë hedh vështrimin nga ballkoni dhe mendoj: “A mos vallë është nëna ime kjo grua që po kalon?! E ecura e saj ngjason shumë me timen!...”

Përse, nënë?!

Përse nuk je afër meje?

Nëse do të ma thoje përsenë, dije që tashmë jam rritur, tashmë mund të të kuptoj! Në kokën time ka aq pyetje sa..., por nuk arrij t'ua gjej përgjigjen.

Përse unë nuk jam në shtëpinë time ashtu si çdo fëmijë tjetër?

Përse jam braktisur në mëshirën e të tjerëve?

Vallë, cili ishte shkaku i mosgjetjes së një rrugëdaljeje?!

Varfëria..., po ka aq shumë njerëz të varfër... ?!!!

Le të mos kishte sobë, do ishim strukur nën batanije. Në vend të ëmbëlsirës do të kishim ngrënë bukë të thekur...

Isha 4 vjeçe. Një ditë në konviktin tonë erdhën disa zonja që kishin sjellë dhurata për fëmijët. Edhe unë, si fëmijët e tjerë, doja të shkoja t'i përqafoja, të dëgjoja emrin e nënës, por gjendja ime ishte aq e keqe sa s'mund të ngrihesha. Pa bërë zë mbështeta kokën në anën e kolltukut. Njëra nga zonjat e vuri re dhe më tha:

- Eja edhe ti bijë. Si quhesh?

Isha aq e pafuqishme sa nuk munda as t'i jepja përgjigje. Zonja vuri dorën në ballin tim dhe tha:

- Bija ime, paske temperaturë.

Nuk e dija ç'do të thoshte të kishe temperaturë. Më pas më dhanë ilaç. Në atë kohë të kërkova shumë, nënë... Ah sikur ndonjëra nga ato zonjat të ishte nëna ime, të më puthte me dashuri dhe unë të përmirësohesha!

Tani po hapin shtëpinë e fëmijëve nënë, tashmë çdokush do mund të qëndrojë në shtëpi. Po na mësojnë gjëra të bukura, larjen e dhëmbëve, zbukurimin e tavolinave, madje po na mësojnë edhe të gatujmë.

Kur isha e vogël, nuk flisja fare. Isha 6 vjeçe, shkoja në shkollën fillore. Atë kohë u shpërngulëm në "Shtëpinë e Fëmijës". Bashkë me mua ishte edhe një shoqe e klasës sime. Një ditë pashë në çantën e saj një lodër që ishte njëllor si e imja.

- Kjo duhet të jetë e imja! – thashë dhe e mora me vete në shkollë.

Një fëmijë në shkollë, e pëlqeu atë shumë dhe unë ia dhurova. Kur shkova në shtëpi shoqja ime më quajti hajdute. Ç'do të thotë "hajdute"? Kësaj fjalë nuk ia di as kuptimin. Nga kjo ngjarje më dërguan në konvikt. Aty kalova dy vite shumë të vështira. Kjo ngjarje më bëri shumë të heshtur. Thonë që *Xheneti është nën këmbët e nënave*. Nën këmbët e cilave nëna, vallë?!

"Dashuri... vetëflijim..." thonë.

S'ndjeje asnjë grimcë dashuri?

Pse nuk arrite të vetëflijoheshe për mua?

Po ditën e nënës, çfarë të shkruaj në letrën e detyrave që na jep mësuesja për atë ditë?

Mendo ditën e nënave... dhe mësuesja na jep detyra. Ç'të shkruaj në atë letër?! Kjo pyetje është më e vështira në provim nënë... Çfarë nuk përjetova në botën time të vogël... Shqetësime që tek fëmijët e tjerë nuk ekzistojnë. S'pata asnjëherë luksin që të bëja naze e të llastohesha. Sikur të bënim edhe një ditë për fëmijët e braktisur!

Ç'do të ndodhte sikur tashmë, në netët e errëta të vendosja kokën time të vogël në jastek të mos ndjeja makth! Akoma jetoj me ëndrrën dhe shpresën e të takuarit me ty. Mos lejo të qëndroj më në mëshirën e të tjerëve... Kam ftohtë nga mungesa e dashurisë, nënë... Vetëm në krahët e tu mund të gjej qetësi... Pavarësisht çdo gjëje, mos më braktis! Ndoshta edhe ti je pa rrugëzgjdhje, por le t'i gjejmë një rrugëzgjdhje së bashku mungesës tënde të rrugëzgjdhjes.

Si mundem e vetme, t'u gjej zgjidhje problemeve të mia në këtë botën time të vogël?!

Si mund të rrih pa më parë teksa rritem?!

Vallë, a të vjen ndërmend fytyra ime kur shikon moshataret e mia?!

Sikur ta dije sa dëshirë kam që kur të tjerët më urojnë për arritjet e mia, të mund ta shihje edhe ti suksesin tim... Kam ftohtë nga mungesa jote! Më merr në krahët e tu! Shtëpia jonë ka kalorifer dhe trupi im nuk ka ftohtë. Shpirti im ka ftohtë nënë, shpirti im!... Dhe... përveç teje, askush s'mund ta ngrohë.

Përktheu: Arsida Velija

Përdoruesit e celularëve, numri shkon në 5 miliardë



Ka arritur në 5 miliardë numri i përdoruesve të telefonave celularë, njoftoi kompania suedeze e telefonisë, Ericsson. Sipas saj, çdo ditë regjistrohen rreth 2 milionë abonentë të rinj në mbarë botën.

Ekspertët e kompanisë në fjalë llogarisin që deri në vitin 2020, bota do të ketë 50 miliardë shfrytëzues të telefonave celularë dhe të pajisjeve të tjera që lidhen me rrjetet mobile.

Në shtator motori i ri elektrik me emetime zero

Kompania japoneze “Yamaha Motor”, numri dy i prodhimit të motoçikletave në botë, ka prezantuar modelin e ri të motorit elektrik “EC-03”, me emetime zero dhe i rikarikueshëm me një prizë të zakonshme elektrike shtëpiake.

Skuteri i ri, që ka të njëjtën fuqi sa një motor 50cc, arrin shpejtësinë maksimale të 30 kilometrave në orë dhe mund të udhëtojë për 43 kilometra me një cikël të plotë baterie.

Bateria, me jone litiumi, është prodhuar nga kompania japoneze “Sanyo” dhe për t’u karikuar plotësisht i duhen gjashtë orë pa ndërprerje.

Motori i ri, mjaft i lehtë për shkak të skeletit të alumintë, është i aftë të kryejë pesë herë më shumë të njëjtën distancë që do të kryente një mjet analog që furnizohet me benzinë, kjo në bazë të kostonë së udhëtimit.



USB-ja më rezistuese në botë

Kompania LaCie ka vendosur të paraqesë një shkop të memories USB për përdoruesit më të ngathët dhe kushtet më të papërshtatshme, duke e emëruar atë në mënyrë të natyrshme XtremKey.

LaCie XtremKey është rezistues ndaj ujit deri në 100 metra thellësi, mund të durojë temperaturat prej -50 deri në +200 gradë celsius, dhe rëniet nga pesë metra lartësi.

Si ia kanë arritur kësaj pune? Shumë thjesht, e kanë futur një memorie USB në gyp metali prej dy milimetrash trashësi, që do të thotë se mund ta shkelni edhe me kamion prej dhjetë tonësh peshë pa pasur frikë se do t'i humbni të dhënat.



LaCie XtremKey mund të blihet në kapacitete prej 8 deri në 64 gigabajt.

Celulari do të mbushet për më pak se 10 minuta

Një teknologji e re e zhvilluar nga Departamenti i Energjisë dhe Materialeve Vorbeck, pritet që t'iu mundësojë celularëve të mbushen brenda minutave.

Ata kanë demonstruar këtë teknologji duke shtuar sasi të grafenit që mund të përmirësojnë në mënyrë dramatike energjinë dhe stabilitetin e ciklit të baterive litium-hekur, gjersa në anën tjetër duke mirëmbajtur në kapacitet të lartë të magazinimit.

Tradicionalisht për të mbushur një celular me bateri të kapacitetit të lartë është dashur kohë mjaft e madhe. Por tani me materialin e ri të njohur si Vor-x, që është zhvilluar në Universitetin Princeton duket se koha rimbushëse e celularit do të shkurtohet nga më shumë se katër apo pesë orë në më pak se dhjetë minuta.





Gratë kanë kujtesë më të fortë se burrat

Një studim i Universitetit të Cambridge në Londër vërteton se gratë kanë kujtesë më të fortë se burrat. Lajmi bëhet publik nga Daily Telegraph. Sipas studimit, janë testuar deri tani rreth 4500 persona, ndërsa pritet që numri i tyre të shkojë në 10 mijë. Studimi është kryer me gra dhe burra të moshës 48 deri në 90 vjeç dhe sipas rezultateve të para, pavarësisht nga mosha, gratë kanë pasur rezultate më të mira. Gratë kanë dhënë deri në 4,5 përgjigje të gabuara

më pak se meshkujt e së njëjtës moshë.

“Edhe pse studime të tilla mbi sekset janë bërë edhe më parë, është hera e parë që bëhet kaq masiv, ku përfshihen rreth 10 mijë persona”, - shpjegon Andrew Blackwell, një nga studiuesit. Sipas tij me anë të këtij studimi do arrihet të zbulohet nëse kujtesa e një personi në një moshë të caktuar është normale, apo vjen si pasojë e ndonjë sëmundje të kaluar.


Lamtumirë karrocë, njerëzit e paralizuar do ecin në këmbë

Një kompani në Zelandën e Re ka shpikur Rex, Skeletin e Jashtëm Robotik, (Robotic Exoskeleton). Janë një palë këmbë robot që mbështesin dhe ndihmojnë një person, që jeton në një karrige me rrota, të ecë me këmbët e veta.

Roboti të lejon të qëndrosh në këmbë, të ecësh, të shkosh poshtë e lart dhe tatëpjetë. Roboti Rex është një karrige në të cilën ulesh dhe më pas duke përdorur panelin e kontrollit dhe levën, personi i paralizuar ngrihet në këmbë dhe kontrollon lëvizjet po me panelin e kontrollit. Pajisja peshon 38 kg dhe është individuale për çdo përdorues.

Rex punon me bateri, karikimi i të cilave zgjat deri në një ditë, në një përdorim normal të robotit.

Pajisja pritet të kushtojë 150 000 dollarë. Një nga drejtuesit e kompanisë thotë se shpreson se testimi i aparatit të bëhet në një kohë shumë të shkurtër dhe më pas do të nxirret në shitje në fillim në Auckland të Zelandës së Re,




për të lejuar kompaninë të verifikojë se çfarë do të ndodhë kur njerëzit do të marrin aparatit në shtëpi.

Shitja e robotit pritet të nisë në Zelandën e Re në fund të 2010 ndërsa në të gjithë botën në mes të 2011.

Pajisja e re për skanimin e trurit nga BrainScope

Në raste të lëndimeve në kokë, njeriu ka vetëm një alternativë, që është vizita në spital për të përcaktuar shkallën e dëmit. Por tani, me zhvillimin e një pajisjeje portative

për skanimin e trurit, kjo praktikë mund të ndryshojë, dhe madje në shumë raste mund të parandalojë edhe vdekje.



Aparate për skanimin e trurit sot mund të gjenden vetëm nëpër spitale. Ato janë të kushtueshme dhe kërkojnë teknikë të specializuar për përdorim. Por Singer thotë se pajisja e firmës BrainScope, e cila është ende në zhvillim e sipër, do të jetë portative, do të punojë me bateri dhe është shumë e thjeshtë për t'u përdorur.

Qendra për kontrollin dhe parandalimin e sëmundjeve

përllëgarit se 1,4 milionë njerëz pësojnë çdo vit lëndime traumatike në tru, por ky numër mund të jetë më i lartë sepse shumë lëndime në tru kalojnë pa u diktuar dhe pa diagnostikuar.

Doktor Kohen, ish mjek në Pentagon, tani punon si këshilltar shëndeti. Ai thotë se diagnostikimi sa më i shpejtë i goditjeve në tru ka shumë rëndësi, sepse tronditje sado e vogël mund të bëhet shkak për dëmtim afatgjatë të trurit.

Doktor Kohen thotë se është ende herët të flitet mbi vlerat e pajisjes së re që po zhvillon firma BrainSkop, por kërkimet duken shpresëdhënëse. Ai e krahason pajisjen e re portative të skanimit të trurit me ato që përdoren nga ekipet mjekësore të ndihmës së shpejtë, që cilat vendosen në gjoks të pacientit për të përcaktuar shkallën e rrezikut të ndonjë goditjeje të mundshme në zemër.

Ndërkohë, ekspertët pranë firmës BrainSkop vazhdojnë provat. Pajisja e tyre do t'i paraqitet për shqyrtim administratës së ushqimeve dhe barnave brenda një viti.

Kohët e fundit, shkencëtarët pranë universitetit Djuke kanë filluar provat për një vaksinë, e cila mund të ndihmojë sistemin imunitar të trupit të godasë qelizat e kancerit në tru. Provat e deri tanishme klinike kanë treguar se pacientët po mbijetojnë dy herë më gjatë sesa parashikohej.

Kondicioneri: Si të freskohemi pa dëmtuar shëndetin tonë

Përdorimi i kondicionerit duhet të bëhet me kujdesin më të madh dhe zgjuarsin mbi të gjitha duhet pasur parasysh mirëmbajtja optimale e filtrave dhe kontrolli konstant i ujit për të parandaluar zhvillimin dhe përhapjen e bakterit legionela.

Infeksionet e frymëmarrjes, dhimbja e fytit, ftohja, por edhe dhimbjet në muskuj: Këto janë shqetësimet më të shpeshta të shkaktuara nga ekspozimi, në një distancë më pak se dy metra me ajrin e kondicionuar.

Ndaj, distanca nga kondicioneri nuk duhet të jetë më pak se dy metra, si dhe temperatura nga mjedisi i jashtëm nuk duhet të kalojë më shumë se tre gradë.

Një përdorim i zgjuar i kondicionerit mund të realizojë dëshirën për freskim, pa shkaktuar asnjë shqetësim për shëndetin.



Ekspedita Shqiptaro-Amerikane zbulon një anije mesjetare në detin Jon

Ekspedita shqiptaro-amerikane e kërkimeve arkeologjike nënujore njoftoi dje se nëpërmjet robotit të anijes amerikane “Herkules” zbuloi reliktin e një anije mesjetare të mbytur në brigjet e Himarës, e cila mendohet të jetë anija e vetme deri tani e zbuluar në Shqipëri që i përket shek. XVI-XVII.

Roboti i ekspeditës, i cili ka filmuar gjithë zonën ku shtrihet anija e mbytur, ka sjellë pamjet e para mbi këtë zbulim i cili konfirmon se anija ka qenë e pajisur me topa të vendosur në të dyja anët e kuvertës së saj. Bie në sy qartë një spirancë.

Arkeologët shqiptarë dhe amerikanë mendojnë se ka të ngjarë që t’i përkasë një anijeje, ndoshta pjesë e një flote ushtarake veneciane, otomane por nuk përjashtohet edhe mundësia e një flote spanjolle. Topat e zbuluar janë të mbuluar nga bimësia e madhe dhe është e pamundur që të japin të dhëna shtesë mbi origjinën e anijes apo edhe vendin e prodhimit të këtij arsenali ushtarak.

Zbulimi konsiderohet me rëndësi për studimin e mëtejshëm të këtij relikti dhe faktet që mund të sjellë



mbi llojet e anijeve që frekuentonin brigjet shqiptare në Mesjetë, por edhe mbi ekspeditat ushtarake që janë ndërmarrë në brigjet e Himarës Mesjetare.

BE ndëshkon Slloveninë dhe Bullgarinë për defiçitin buxhetor

Bashkimi Europian ka ndëshkuar Slloveninë për keqpërdorim të fondeve të parapara për zhvillimin rural. Në buxhetin e BE-së, Sllovenia duhet të kthejë 2.28 milionë euro, edhe pse autoritetet sllovene pohojnë se bëhet fjalë për një “gabim”. Ato thonë se shumata e përmendur tashmë është paguar. Precedentët e tjerë të rëndë janë ata të Spanjës dhe të Bullgarisë.

Shumën më të mëdhe të parave për shkak të keqpërdorimeve duhet ta kthejë Britania e Madhe (223,765 milionë euro), ndërsa pasojnë Hungaria, Gjermania, Spanja, Danimarka, Sllovenia, Austria, Finlanda, Luksemburgu dhe Sllovakia. Komisioni Europian është i obliguar të vërtetojë se shumatat e paguara, shpenzohen në mënyrë të drejtë.

Shqipëria, 375 mijë persona jetojnë nën minimumin jetik

Në vendin tonë janë 375 mijë persona, të cilët jetojnë nën minimumin jetik, pikërisht me më pak se dy dollarë në ditë. Të dhënat janë bërë publike nga Ministri i Punës, Spiro Ksera gjatë interpelancës në parlament. Ky i fundit ka deklaruar se gjatë viteve të fundit numri i këtyre personave është ulur ndjeshëm. Nëse në vitin 2002 kanë qenë 800 mijë persona që jetonin në skajet e varfërisë, kurse sot këto shifra kanë ndryshuar.

Sipas Ministrit Spiro Ksera gjatë këtyre viteve ka ndryshuar edhe pagesa e ndihmës ekonomike e cila nga 2 mijë lekë ka shkuar në 4.8 mijë lekë. Për sa i përket skemës së Ndihmës Ekonomike rezulton se ajo është reduktuar ndjeshëm duke larguar familjet që e përfitonin padrejtësisht atë. Buxheti për ndihmën ekonomike në vitin 2005 ishte 3,2 miliardë, kurse për vitin 2010 është 5,2 miliardë lekë.



Gazsjellësit rus Sofje-Moskë, firmosin marrëveshje

Rusia dhe Bullgaria nënshkruan një marrëveshje për përsheptimin e ndërtimit të gazsjellësit rus Rryma Jugore, në territorin e bullgarisë, me një kosto prej rreth 835 milionë dollarë. Anëtarja e Bashkimit Europian ra dakord për të vazhduar me projektin e ndërtimit të gazsjellësit, i cili ka për qëllim të dërgojë 63 miliard metra kub gaz në vit nën Detin e Zi, për në Evropën Qendrore dhe Jugore, pasi Moska u angazhua për të ulur çmimin e gazit rus për Bullgarinë.

Nënshkrimi i kësaj marrëveshje vjen 1 vit pasi qeveria e Qendrës së Djathtë bullgare vendosi të lërë në pritje projektin rus të energjisë, për të kontrolluar më parë nëse ai përputhej me interesat kombëtare dhe

agjendën e BE-së. Gazsjellësi “Rryma Jugore” ishte projektuar të kalonte përmes Ukrainës për të transportuar gazin rus në Europë dhe pritet të bëhet operacional në vitin 2015. Ai është një rival i gazsjellësit Nabuko, të mbështetur nga BE, që sjell gazin nga Azia Qendrore dhe Lindja e Mesme për në Europë. Dy palët ranë gjithashtu dakord të nënshkruajnë një kontratë të drejtpërdrejtë të furnizimit me gaz për Bullgarinë brenda fundit të gjysmës së parë të vitit 2011, e cila nuk do të përfshijë ndërmjetës në marrëveshje. Kryeministri bullgar Bojko Borisov tha se kjo marrëveshje është e rëndësishme për qytetarët e Bullgarisë. Kjo e fundit siguron rreth 70 % të nevojave të saj energjetike përmes importeve dhe nga Gazprom.